



Kosova Women's Network
Serving, Protecting and Promoting the Rights of Women and Girls

më shumë se vetëm
**“Fjalë
në LETËR” ?**

**PËRGJIGJA E ORGANEVE TË DREJTËSISË
NDAJ DHUNËS NË FAMILJE NË KOSOVË**

Tetor 2009
Prishtinë, Kosovë



Kosova Women's Network
Serving, Protecting and Promoting the Rights of Women and Girls

më shumë se vetëm
**“Fjalë
në LETËR”?**

**PËRGJIGJA E ORGANEVE TË DREJTËSISË
NDAJ DHUNËS NË FAMILJE NË KOSOVË**

Hartuar për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës
nga Ariana Qosaj-Mustafa dhe Nicole Farnsworth

Tetor 2009
Prishtinë, Kosovë

Punuar nga Ariana Qosaj-Mustafa dhe Nicole Farnsworth për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

© Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, 2009. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky hulumtim është mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), projekti Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas (IMSG). Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdo ato të UNDP-së.

ISBN 978-9951-498-07-4

Produksioni: Rrota: www.rrota.com

Layout: Ardian Veliu

Ballina: Kushtrim Balaj

Shtypi: Grafika Reznici

Përktheu: DAS Group Professional Translation Agency

FALËNDERIM

Ekipi hulumtues dëshiron të shpreh falënderimet e tij Drejtoreshës Ekzekutive të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Igballe Rogova për mbështetjen e vazhdueshme dhe këmbënguljen e saj. Falënderojmë ekipin e Iniciativës për Mbrojtje dhe Siguri të Gruas në Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), të cilët jo vetëm që kanë financuar këtë hulumtim të rëndësishëm, por po ashtu edhe kanë qenë të gatshëm të na ndihmojnë kurdo ka qenë e mundur. Veçanërisht falënderojmë Agjencinë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit për mbështetjen e këtij hulumtimi dhe për ofrimin e informatave për politikatat të cilat janë në hartim e sipër.

Hulumtimi nuk do të ishte i mundur pa bashkëpunimin e plotë të institucioneve dhe organizatave, përfaqësuesit e të cilave kanë ofruar kohën dhe mendimet e tyre: Policia e Kosovës, Qendrat për Punë Sociale, Divizioni për Ndihmë dhe Këshillim të Viktimave, Zyrat e Ndihmës Juridike, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, EULEX-i, Qendra e Mirëqenies së Gruas, Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Gruas, Liria (Gjilan), Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren, Shtëpia e Sigurt në Gjakovë, Hope and Homes for Children, Medica Kosova dhe Shoqata e Juristëve Norma.

Falënderojmë 96 gratë dhe burrat nga e tërë Kosova të cilët kanë paraqitur përvojat e tyre personale me sistemin e drejtësisë, shpesh duke shpresuar që tregimet e tyre, zakonisht përplot me dhimbje, frustrim dhe zhgënjim, do të mund të ofronin detajet e nevojshme për përmirësimin e përgjithshëm të sistemit, në këtë mënyrë duke parandaluar vuajtjet e tyre dhe të tjerëve në të ardhmen.

Autorët falënderojnë anëtarët tjerë të ekipit të cilët i kanë përkushtuar shumë kohë dhe energji këtij projekti: Mimoza Gashi, Adem Gashi, Nderime Sahatqija, Zejnete Dylatahu, Ganimete Juniku, Valbona Salihu, Adelina Berisha, dhe Alba Loxha.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
HYRJE.....	9
Metoda e hulumtimit	11
Rreth këtij raporti	13
KAPITULLI 1. KORNIZA LIGJORE E KOSOVËS MBI DHUNËN NË FAMILJE NË KOSOVË	17
Korniza ligjore e Kosovës për mbrojtjen dhe ndjekjen penale të dhunës në familje	18
KAPITULLI 2. MBROJTJA KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE:	
URDHRAT PËR MBROJTJE DHE PËRGJIGJA E GJYQTARËVE	23
Vonesat në lëshimin e Urdhrave për mbrojtje	24
Dënime të buta për kryerësit recidivist dhe shkelësit e urdhrave për mbrojtje	25
Shqiptim i kufizuar i masave të parapara sipas rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje	26
Arsyetim i varfër i aktgjyqimeve me të cilat shqiptohen masat mbrojtëse	30
Vëmendje e kufizuar në sigurimin e zbatimit të urdhrave për mbrojtje	31
Struktura e prokuroriale	35
KAPITULLI 3. NDJEKJA E VEPRAVE PENALE TË DHUNËS NË FAMILJE	35
Ndjekja e krimeve të lëndimeve të lehta trupore	36
Përfundimi i ndjekjes	38
Dënime të lehta për kryesit e veprave penale të dhunës në familje	40
KAPITULLI 4. POLICIA E KOSOVËS: HETIMET, ARRESTIMET, MONITORIMI	45
Informimi i viktimave për të drejtat e siguruarat me ligjin e zbatueshëm	46
Lëshimi i urdhrave për mbrojtje dhe përcjellja e rasteve nga policia	47
Arrestim, paraburgim dhe lirim të të dyshuarve për dhunë në familje	48
Mbledhja e dëshmive në hetimin e rasteve të dhunës në familje	51
Divizioni për këshillim dhe ndihmë viktimave	57
KAPITULLI 5. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE DHE QASJA NË DREJTËSI	57
Përfaqësimi ligjor i viktimave: Sistemi i ndihmës juridike në Kosovë	60
Mangësitë e Sistemit të Ndihmës Juridike në Kosovë	61
Mbrojtja e të drejtave të fëmijës dhe ndihmimi i viktimave: Qendrat për Punë Sociale	63
Siguria dhe mbështetja gjatë qasjes në drejtësi: vendstrehimet dhe organizatat tjera	65
KAPITULLI 6. PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI QASJEN NË DREJTËSI	71
REKOMANDIME	77
PUNIMET E CITUARA	84

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KEFDG	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
QMGF	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve
KDE	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
QPS	Qendra për Punë Sociale
DMS	Departamenti i Mirëqenies Sociale
RrMKDhF	Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje
NjDhF	Njësia kundër Dhunës në Familje
AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim
KE	Komisioni Evropian
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
GJEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
UME	Urdhëresa për mbrojtje emergjente
EULEX	Misioni Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
UMPE	Urdhëresa për mbrojtje të përkohshme emergjente
OPS	Objekti i Përkohshëm për Siguri
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KP	Policia e Kosovës
RrGGK	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës
ZNJ	Zyrtar për Ndihmë Juridike
SNJ	Sistemi i Ndihmës Juridike
LDhF	Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje
SMSL	Seksioni për Monitorimin e Sistemit Ligjor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MMK	Monitorim, mentorim dhe këshillim
SNPL-DhF	Strategjia Nationale dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje
OJQ	Organizatë Joqeveritare
ZK	Zyra e Kryeministrit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UM	Urdhëresa për Mbrojtje
ESK	Enti i Statistikës i Kosovës
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNIFEM	Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara për Gruan
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
MV	Mbrojtës i viktimës
DNKV	Divizioni për Ndihmë dhe Këshillim të Viktimave
IMSG	Iniciativa për Mbrojtje dhe Siguri të Gruas

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sigurimi i qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në familje mbetet sfidë në tërë botën. Përderisa shumë qytetarë e ndjejnë dhunën në familje si çështje shumë “e turpshme” për t’u raportuar, përfaqësuesit e institucioneve publike shpesh e konsiderojnë atë si çështje private e cila më së miri zgjidhet brenda familjes. Megjithatë, dhuna në familje bart një kosto për shoqërinë, duke kontribuar kështu në koston e ndërlidhur me parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen, sikurse dhe nivelin e ulët të arsimimit, papunësinë, e madje edhe me BPV-në. Duke adresuar çështjen e dhunës në familje, shteti mund të dërgoj një mesazh të qartë se nuk do të toleroj këto akte dhe se do të ofroj siguri për të gjithë qytetarët. Më tej, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, parimet e së drejtave të njeriut dhe kornizën ekzistuese ligjore në Kosovë, institucionet janë të obliguara për të hetuar, ndjekur dhe dënuar kryesit e veprave të dhunës në familje, në të njëjtën kohë duke ofruar zgjidhe efektive për viktimat.

Fatkeqësisht, një numër pengesash ende parandalojnë viktimat e dhunës në familje të kenë qasje në drejtësi në Kosovës. Identifikimi i sfidave në zbatimin e legjislacionit ekzistues mund t’i kontribuoj procesit të hartimit të politikave dhe mundësisht në këtë mënyrë të ndryshoj mangësitë aktuale. Prandaj, për të mbështetur Qeverinë e Kosovës dhe palët tjera të interesuara në hartimin e Ligjit mbi mbrojtje kundër dhunës në familje edhe Strategjisë nacionale dhe Planit nacional të veprimit kundër dhunës në familje, nga qershori deri në shtator 2009 Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RrGGK) ka intervistuar, institucione të ndryshme dhe viktime të dhunës në familje.

Në lidhje me mbrojtjen kundër dhunës në familje, RrGGK-ja ka identifikuar shumë çështje në përgjigjet e gjyqtarëve, përfshirë: vonesat në lëshimin e urdhëresave për mbrojtje (UM); kufizimet në llojet e masave të lëshuara nga gjyqtarët; arsyetim të dobët të aktgjykimeve; përcjellje e pamjaftueshme e zbatimit të UM-ve; dënime të buta në rastet kur UM-të janë shkelur; dhe burgosje të rralla të personave përgjegjës për shkelje të UM-ve, edhe në rastet e përsëritjes së veprës.

Ndjekja e veprave penale të dhunës në familje është po ashtu shqetësuese. Gjykatat shpesh kanë dështuar në ndjekjen e krimeve siç janë lëndimet e lehta ose të rënda trupore të cilat kanë ndodhur në marrëdhëniet familjare ose kur kanë bërë këtë, kanë shqiptuar dënime të lehta. Procedurat civile në gjykata dhe lëshimi i UM-ve është parë shpesh si zëvendësim për ndjekjen penale. Pushimi i ndjekjes penale ka qenë i shpeshtë, veçanërisht në rastet e “pajtimit” në mes të palëve ose “tërheqjes” të akuzës së viktimës. Sidoqoftë, në pajtim me legjislacionin penal, veprat e dëmtimeve trupore të kryera në lidhje familjare duhet të ndiqen ex officio (sipas detyrës zyrtare). Edhe kur ka pasur gjykime, për krimet e kryera, kryesit kanë marrë dënime jashtëzakonisht të buta. Hetime të papërfunduara, zbatim i pamjaftueshëm i UM-ve, bashkëpunim i dobët në mes të policisë dhe prokurorëve dhe dështimi për të arrestuar kryesit, kanë ngritur ndjeshmërinë e viktimeve ndaj recidivizmit, duke lejuar kryesit të mbesin të pa dënuar.

Performanca e individëve brenda institucioneve të cilat ofrojnë ndihmë për viktimat e dhunës në familje ka qenë e ndryshme. Shumë prej tyre kanë mungesë njohurish lidhur me kornizën ligjore të dhunës në familje, gjë që ka ndikuar në cilësinë e përfaqësimit ligjor që u ofrohet viktimave. Buxheti i pamjaftueshëm dhe mungesa e personelit profesional të specializuar në sferën e mbrojtjes ndaj dhunës në familje, kanë qenë disa prej sfidave tjera. Vendstrehimet joqeveritare kanë ofruar shërbim të rëndësishëm për mbrojtjen e viktimave/dëshmitarëve, por ende kanë vështirësi në sigurimin e financimit adekuat për reintegrimin e viktimave.

Tradita, dënimi social, frika nga reperkusioni, vartësia financiare nga kryesi dhe shqetësimi nga humbja e kujdestarisë për fëmijët, kanë kontribuar në ngurrimin e viktimave për të kërkuar drejtësi. Performanca e dobët e institucioneve ka bërë gati një të tretën e viktimave të intervistuar që të thonë se ato nuk do të shfrytëzojnë përsëri sistemin e drejtësisë.

Raporti përfundon me rekomandime për të përmirësuar kornizën ligjore kundër dhunës në familje dhe për institucionet individuale të ngarkuara me ofrimin e mbrojtjes për viktimat, ndjekje të kryesve dhe parandalim të dhunës në të ardhmen.

'Fjalë në LETËR'?

më shumë se vetëm



HYRJE

Dhuna në familje zakonisht përkufizohet si dhunë e cila shfaqet në vendbanime private në mes të bashkëshortëve. Përderisa shumica e akteve të dhunës në familje kryhen kundër grave ose fëmijëve, kjo dhunë mund të drejtohet edhe kundër bashkëbanuesve tjerë, sikurse janë burrat dhe të moshuarit.¹ Dhuna në familje është një mënyrë e sjelljes, e cila zbatohet dhe tolerohet nga shumë shoqëri. Dëshmitë kanë treguar se dhuna në familje është çështje e zgjedhjes dhe nuk rezulton vetëm nga keqpërdorimi i alkoolit apo substancave narkotike, sëmundjes fizike apo mendore, sjelljes së pakontrolluar apo problemeve në lidhje.”²

Sjelljet e zakonshme të kryesve të dhunës në familje përfshijnë përpjekjet për të kontrolluar viktimat e tyre, nënvleftësuar efektet e dhunës, fajësimin e viktimave të tyre për dhunë dhe mohimin e veprimeve të tyre. Kryesit mund të sillen në mënyrë të qetë në sferën publike dhe në gjykatë, por privatisht vazhdojnë ushtrimin e dhunës dhe shpesh besojnë se kanë të drejtë të përdorin dhunën. Sipas Regjistrimit gjyqësor të Shqipërisë mbi urdhëresat për mbrojtje, “viktimat zakonisht e konsiderojnë dhunën në familje si diçka unike që u ndodh atyre dhe fajësojnë veten për dhunën e ushtruar, duke racionalizuar abuzimin.”³ Siç ka komentuar një grua, “Nëse nuk e dëgjoj burrin tim ose kam sjellje të këqija, është normale që ai të më rrah.”⁴ Dhuna në familje mund të shpie drejt vetëbesimit të ulët, stresit, ndjenjës së frikës dhe mohimit, izolimit nga familja dhe shoqëria, pagjumësisë, ndjenjës së fajit, paaftësisë për t’u kujdesur për vete, pamundësisë për të punuar, depresionit, shkurorëzimit, ndërprerjes së arsimit, shëndetit të dobët, dështimit të shtatzënisë, vetëvrasje e madje edhe vdekjes.⁵

Prandaj dhuna në familje bart një kosto të lartë për shoqërinë, përfshirë shpenzimet për kujdes shëndetësor, polici, ndjekje penale, gjykim, nivel të arsimit dhe të punësimit, humbjes së ditëve të punës (që ndikojnë në BPV), produktivitet dhe ndihmë sociale për viktimat.⁶ Krijimi i një kulture pa dhunë siguron një zhvillim të lirë dhe të sigurt për çdo anëtar të shoqërisë. Për më tepër, në një fazë afatgjate mungesa e dhunës është më pak e kushtueshme për shtetin, i cili duhet të investoj në parandalim, mbrojtje dhe ndjekje të akteve të dhunës në familje. Duke reaguar ndaj dhunës e cila manifestohet në shtëpitë tona, shteti mund të dërgojë një mesazh të qartë se nuk do të tolerojë akte të tilla dhe do të ofrojë një mirëqenie për çdo qytetar të tij.

¹ Rrjeti i grupi të grave të Kosovës (RrGGK) ka diskutuar dhe dokumentuar dhunën kundër fëmijëve, pleqve, personave me nevoja të veçanta, pakicat seksuale, dhe meshkujt. Shih, Nicole Farnsworth, dhe Ariana Qosaj-Mustafa për RrGGK, *Siguria nis në shtëpi: Hulimtim informativ për Strategjinë e parë Nacionale dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje në Kosovë*. Prishtinë: RrGGK, 2008.

² Shih regjistrin gjyqësor shqiptar mbi urdhëresat për mbrojtje, pjesa mbi “Praktikat e mira për të ndaluar dhunën në familje,” Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe USAID, Tiranë, 2008, p. 33.

³ Ibid.

⁴ RrGGK, *Siguria nis në shtëpi*, f. 16.

⁵ “Regjistri gjyqësor shqiptar mbi urdhëresat për mbrojtje, pjesa mbi “Praktikat e mira për të ndaluar dhunën në familje,” RrGGK, *Siguria nis në shtëpi* dhe RrGGK, *Hulumtim shpjegues mbi nivelin e dhunës në familje të bazuar në gjini në Kosovë dhe ndikimi i saj në shëndetin reproduktiv të grave*, Prishtinë: RrGGK, 2008.

⁶ Ky paragraf është marrë nga RrGGK, *Siguria nis në shtëpi*.

Sidoqoftë, sigurimi i qasjes në drejtësi për personat të cilët kanë përjetuar dhunë në familje mbetet një sfidë gjithandej botës. Në shumë shoqëri traditat patriarkale u japin burrave “të drejtën për të kontrolluar gratë e tyre” nëse e nevojshme edhe përmes dhunës; gratë rrezikojnë izolim social duke raportuar faktin e “turpshëm” se ato kanë përjetuar dhunë. Shumë përfaqësues të institucioneve publike refuzojnë të konsiderojnë aktet “private” të dhunës në familje si çështje e sferës publike. Për shkak të botëkuptimeve sociale, dhuna në familje shpesh mbetet e pa raportuar. Prandaj, për gratë (e nganjëherë burrat) të cilët marrin përsipër rrezikun social për të raportuar dhunën, përgjigja institucionale duhet të jetë mbështetëse, e ndjeshme dhe e shpejtë. Dështimi për të reaguar me kohë dhe me kujdes të madh mundet dhe ka rezultuar me përsëritje të dhunës e madje edhe vdekje,⁷ si dhe hezitim për të raportuar përsëritjen e dhunës.⁸

Në Kosovë, institucionet e ndryshme janë ngarkuar me përgjegjësinë për të mbrojtur të drejtat e personave që kanë përjetuar dhunë në familje. Nga momenti kur dhuna në familje raportohet në polici, në vendstrehime, Qendra për Punë Sociale ose Këshillimore për viktimat, ekzistojnë sisteme dhe procedura për të siguruar se çdo person pranon ndihmën e duhur pas paraqitjes së rastit, nëse është e nevojshme kontroll mjekësor, këshillim, strehim dhe mbështetje në procedurat gjyqësore. Sistemi i drejtësisë ka përgjegjësi për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje nga kryesit, përmes ofrimit të udhëzimeve për mbrojtje (rastet civile), si dhe ndjekje penale sipas detyrës zyrtare (“ex officio”) të personave që kanë kryer ato krime.⁹

Fatkeqësisht, nuk është sekret se një numër pengesash i parandalojnë viktimat e dhunës në familje për qasje në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Një hulumtim i kryer shumë kohë më parë ka nxjerrë në pah se ekzistojnë probleme në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, e në veçanti sa i përket dhunës në familje.¹⁰ Sidoqoftë, asnjë hulumtim nuk ka ekzaminuar nga afër problemet e gjithë procesit të qasjes në drejtësi dhe nuk ka përfshirë të dhëna nga përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të përfshira, si dhe nga gratë dhe burrat të cilët kanë kaluar nëpër këto procese. Për të identifikuar si problemet ashtu edhe zgjidhjet,

⁷ Sipas Policisë së Kosovës, 17 njerëz kanë vdekur nga incidentet e ndërlidhura me dhunën në familje që nga fillimi i vitit 2005 deri në qershor të vitit 2009.

⁸ Intervistat e RrGGK, 2009. Shih kapitullin 6.

⁹ RrGGK preferon terma siç janë “klient,” “mbijetues të dhunës në familje,” ose “persona të cilët kanë përjetuar dhunë në familje” kundrejt termit “viktimitë.” Termet e para fuqizojnë, duke u përqendruar në persona si subjekte të afta që të marrin kontrollin mbi jetët dhe të ardhmen e tyre. Anasjelltas, termi “viktimitë” është shfuqizues dhe objektiv. Megjithatë, edhe institucionet kosovare dhe korniza ligjore e tanishme përdorin termin “viktimitë.” Për konsistencë dhe me qëllim të shmangies së ndonjë paqartësie, ky raport përdor termin “viktimitë.”

¹⁰ Raportet e RrGGK *Siguria nis në shtëpi dhe hulumtimi shpjegues*, kanë paraqitur dobësitë brenda sistemit të drejtësisë, e veçanërisht në lidhje me dhunën në familje. Të dyja, (Raporti i OSBE-së për “rastet e dhunës familjare në Kosovë,” korrik 2007, dhe “Rishikimi i parë i sistemit civil të drejtësisë,” qershor 2006) dhe Institucioni i Ombudspersonit (“Raport i Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë lidhur me zbatimin e pjesës 7 dhe 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje, *Ex Officio*” Regjistrimi Nr. 1/06, nëntor 2006 dhe “Raporti vjetor i ud/ Ombudspersonit për Kuvendin e Kosovës, (2006-2007)”) raportet kanë ofruar shembuj të mungesës së qasjes në drejtësi. Komisioni Evropian ka shprehur shqetësime për qasjen në drejtësi në raportin e vet vjetor (Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, 2007 dhe 2008). Pas një monitorimi njëvjeçar, Rrjeti ballkanik i gazetarisë hulumtues (BIRN) në “Raport: Monitorimi i gjykatave” (2009) ka paraqitur probleme të shumta me sistemin e drejtësisë, përfshirë, “zgjatje të paarsyeshme në hapje, dhe më pas mbyllje të rasteve; dështime për të përmbushur standardet e pritura gjatë gjyqimeve, dhe në disa raste dyshime për korrupsion të gjyqtarëve dhe prokurorëve” (Fatmire Tërdevci dhe Tom Fuller, “BIRN tregon për dobësi të mëdha në gjykatat e Kosovës” 4 qershor 2009). Rubotham, G.N., et al. në “Sistemi gjyqësor i Kosovës: Vlerësim dhe opsione të propozuara 2003-2004” ka shtjelluar zgjanimisht funksionet operative, mangësitë, dhe mënyrat për të ecur para për të çuar para të gjithë sistemin (2004).

është i domosdoshëm realizimi i një hulumtimi i cili përfshinë konsultime me të gjitha institucionet e përfshira dhe përfituesit e shërbimeve nga këto institucione.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka marrë përsipër këtë detyrë të madhe nga qershori deri në shtator të vitit 2009, me mbështetje financiare nga Iniciativa për Mbrojtje dhe Siguri të Grave (IMSG) të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe me mbështetje të Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ABGJ). Hulumtimi ka pasur për qëllim “mbështetjen e Qeverisë së Kosovës dhe hartuesve të politikave në përgatitjen dhe zbatimin e Strategjisë dhe Planit nacional të veprimit kundër dhunës në familje (PNV-DhF) dhe Ligjit për mbrojtje kundër dhunës në familje (LDhF),” ku të dyja kanë qenë në proces të hartimit.¹¹ Qëllimi i hulumtimit ka qenë të krijoj “një kuptim gjithëpërfshirës të sistemit të drejtësisë në Kosovë lidhur me zbatimin e legjislacionit mbi dhunën në familje.” Ky raport përmbledh të gjeturat e hulumtimit si dhe jep rekomandime institucioneve të përfshira në sigurimin e qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në familje.

Metoda e hulumtimit

Për shkak të statistikave të pasakta¹², sistemeve të papërshtatshme ekzistuese për mbledhjen e të dhënave¹³ dhe hulumtimeve të pakta mbi këtë temë¹⁴, RrGGK ka përdorur një metodologji të kombinuar. Metoda e hulumtimit ka përfshirë:

- Analizën e kornizës ekzistuese ligjore dhe institucionale në lidhje me dhunën në familje nga ana e ekspertit ligjor dhe një avokati me përvojë të mëparshme si gjyqtarë, që ka pasur për qëllim identifikimin e zbrazëtirave në kornizën e tanishme lidhur me dhunën në familje;
- Intervista gjysmë të strukturuar me 96 gra dhe burra të cilët kanë përjetuar dhunë në familje lidhur me përvojat e tyre në qasjen në gjyqësi. Përderisa janë përfaqësuar grupe të ndryshme demografike (p.sh. mosha, përkatësia etnike, zona gjeografike, gjendja ekonomike, aftësitë)¹⁵, mirëqenia psikologjike dhe siguria fizike e të intervistuarve ka qenë

¹¹ UNDP, kërkesa për aplikime, 2009.

¹² Informata shpesh janë në dispozicion në kapitullin në vijim.

¹³ Asnjë statistikë nuk është e “saktë” në Kosovë për shkak të faktit se regjistrimi i popullsisë nuk është bërë që nga viti 1981.

¹⁴ Sfidat në sigurimin e statistikave të sakta (të përshkruara më poshtë) kanë çuar në zhvillimin e një metodologjie të përzier nga ekipi hulumtues për të mbledhur sa më shumë informata relevante që është e mundur lidhur me qasjen në drejtësi për viktimat e dhunës në familje. Ekipi ka përdorur trekëndëshin për të testuar saktësinë e të gjeturave.

¹⁵ Të intervistuarit janë identifikuar përmes organizatave të RrGGK. T96 të intervistuarit kanë përfshirë: 93 për qind femra dhe 7 për qind meshkuj; mosha 18-25 (16 për qind), 26-35 (34 për qind), 36-45 (28 për qind), 46-55 (15 për qind), 56-65 (2 për qind), dhe mbi 66 vjeç (5 për qind); rurale (52 për qind) dhe qytetarë në zona urbane (48 për qind); nga Prishtina (16 për qind), Gjakova (13 për qind), Prizreni (8 për qind), Ferizaj (5 për qind), Dragashi (4 për qind), Peja (4 për qind), Rahoveci (4 për qind), dhe mbi 20 komuna tjera (49 për qind); shqiptarë (84 për qind), romë, ashkali ose egjiptas (6 për qind), boshnjak (2 për qind), persona shumetnik (2 për qind), serb (2 për qind), turq (2 për qind), dhe goranë (1 për qind); të punësuar (18 për qind) dhe të papunësuar (82 për qind); të martuar (35 për qind), të ndarë (24 për qind), të vejë (21 për qind), beqar (10 për qind), shkurorëzuar (8 për qind), të martuar jo zyrtarisht (1 për qind); dhe 83 për qind me fëmijë dhe 17 për qind pa fëmijë (numri mesatar i fëmijëve në mesin e atyre që kanë pasur fëmijë ka qenë 2.56 dhe, mesatarisht fëmijët kanë qenë 14.63 vjeç). Të dhënat e mirëmbajtura nga Policia e Kosovës tregojnë se përafërsisht 790 për qind e viktimave të dhunës në familje janë gra, dhe 21 për qind janë burra, gjë që tregon se pse gratë janë të mbi përfaqësuar në këtë studim; ka qenë shumë e vështirë gjetja e viktimave meshkuj të cilët dëshirojnë të flasin.

prioriteti më i lartë në përcaktimin se kush intervistohet.¹⁶ Në këtë drejtim, tre këshilltarë të trajnuar nga Medica Kosova kanë siguruar qasje të ndjeshme ndaj intervistave, të cilat kanë pasur për qëllim të mbrojnë mirëqenien emocionale e të anketuarve dhe të evitojnë traumatizmin e sërishëm të tyre.¹⁷ Intervistat janë mbajtur në dhoma private pa praninë e anëtarëve të familjes, duke u mundësuar të anketuarve të flasin më hapur për përvojat e tyre;

- Intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave joqeveritare për sigurim të qasjes në drejtësi: zyrtarë e Policisë së Kosovës (PK) nga njësitë kundër dhunës në familje, punëtorët social në Qendrat për Punë Sociale (QPS), Avokatët e viktimave nga divizioni për këshillim dhe ndihmë në Ministrinë e Drejtësisë (DNKV), prokurorë, avokatë, gjyqtarë, kryetarë të gjykatave, zyrtarë për ndihmë juridike, vendstrehime dhe organizata të grave.¹⁸ RrGGK po ashtu është konsultuar edhe me palë tjera të interesuara përmes intervistave ose pyetësorëve, përfshirë EULEX-in, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë (OSBE) dhe UNIFEM-in;
- Mbledhja e të dhënave ekzistuese relevante për qasjen në drejtësi lidhur me dhunën në familje nga PK, DNKV, QPS-të, vendstrehimet, gjykatat, EULEX-i, OSBE-ja dhe Ombudspersoni; dhe
- Të dhënat nga hulumtimi i ekonomive familjare në të tërë Kosovën i cili ka rezultuar me regjistrimin e perceptimeve të njerëzve për qasjen në drejtësi në raportin Siguria nis në shtëpi.

Informatat kuantitative të mbledhura gjatë intervistave janë analizuar duke përdorur bazën e të dhënave në programin kompjuterik Excel dhe të dhënat kualitative janë koduar ndaras nga tre hulumtues dhe më pas janë analizuar për trendët. Pas kësaj, udhëheqësi i ekipit dhe eksperti ligjor kanë hartuar një draft raport i cili me 22 shtator 2009 i është prezantuar grupit të ekspertëve, i cili përfshin të gjitha palët e interesuara si dhe shumë të intervistuar. Rekomandimet e tyre janë përfshirë në raportin përfundimtar.

Sfidë e madhe për ekipin hulumtues ka qenë fakti se institucionet kosovare janë akoma në mes të krijimit të procedurave për mbledhje të statistikave të detajuara. Pjesa më e madhe e institucioneve mbledhin informata themelore, por ato nuk ruhen në atë formë që mund të ndahen lehtësisht në pjesë, ndërsa pjesa më e madhe e institucioneve nuk mbledhin të dhëna të rëndësishme demografike. Mbledhja e informatave nga sistemi i drejtësisë është treguar sfidë e veçantë. Përderisa institucionet gjyqësore kanë të punësuar nëpunës gjyqësor për regjistrimin e lëndëve, vetëm disa prej tyre kanë të punësuar

¹⁶ Për të gjitha intervistat, RrGGK është munduar t'i përmbahet standardeve etike për hulumtim me subjekte njerëzore, përfshirë: informimin e të intervistuarve lidhur me hulumtimin, të drejtat e tyre për të marrë pjesë ose jo, deh se si do të përdoren informatat nga ky hulumtim; mbrojtja e të intervistuarve nga dëmtimet e mundshme, siguri i konfidencialitetit, ndarja e identifikuesve nga të gjeturat e hulumtimit për të siguruar konfidencialitetin, dhe rritja e përfitimeve pozitive nga hulumtimi (p.sh., biseda ,e këshilltarë të trajnuar mbi përvojat e tyre personale, marrja e informatave mbi shërbimet që ata i kanë në dispozicion).

¹⁷ Intervistat kanë qenë joformale, në një stile bisedimi, dhe kanë pasur për qëllim të rrisin ndjenjën e komoditetit për të intervistuarit. Të gjithë të intervistuarve u janë dhënë numrat kontaktues të këshilltarëve të Medica Kosova ashtu që ata të mund të pranojnë këshillim ose ndihmë të mëvonshme, po se kjo iu duhet.

¹⁸ Të 61 intervistat, me gjatësi prej mesatarisht një orë, janë bërë në gjithë Kosovën, me nëntë prokurorë komunal, pesë prokurorë të qarkut, një prokuror publik në Prishtinë, katër gjyqtarë të lëmisë civile komunal, dy gjyqtarë të lëmisë civile të qarkut, katër gjyqtarë të lëmisë penale të qarkut, pesë avokatë, gjashtë zyrtarë për ndihmë juridike, pesë zyrtarë të policisë së Kosovës, katër kryetarë të gjykatave, pesë punëtorë social, pesë avokat të viktimave, dhe katër drejtorë të vendstrehimeve.

zyrtar për statistika. Rastet i kemi regjistruar në formë manuale duke i plotësuar formularët të cilët përmbajnë informata të pamjaftueshme. Nëpunësit gjyqësor për regjistrimin e lëndëve kanë mundur të ndihmojnë në gjenerimin e statistikave vetëm për disa lloje informatash. Mbledhja e të dhënave të ndara sipas elementeve kyçe demografike sikurse janë; përkatësia etnike, gjinia, mosha, gjendja socio-ekonomike dhe lokacioni ka qenë shumë e vështirë. Sigurimi i të dhënave kuantitative për llojet e ndryshme të gjykimeve, akuzave, vendimeve, dënimeve, kohëzgjatjen e gjykimeve dhe përsëritjen e veprave penale ka qenë pothuajse e pamundur.

Mungesa e bazës elektronike për të dhëna u pamundëson gjykatave komunale dhe atyre të qarkut gjenerimin me kohë e statistikave të sakta për dhunën në familje. Nëpunësit gjyqësor për regjistrimin e lëndëve në gjykatat e qarkut i regjistrojnë rastet civile bazuar në akuza (p.sh., “Prishje e martesës”), por nuk mund të ofrojnë informata se a janë këto raste të dhunës në familje. Siç i kas thënë RrGGK-së një nëpunës i gjykatës rajonale, vetëm gjyqtarët të cilët janë marrë me rastin i dinë këto informata. As gjykatat komunale nuk i kanë mirëmbajtur shënimet elektronike, kështu që identifikimi i rasteve të dhunës në familje do të kërkonte burime të mëdha njerëzore për të kontrolluar me kujdes dosjet e rasteve individuale. Për shembull, pasi që gjykata komunale në Prishtinë ka qenë duke ndihmuar një ekip tjetër hulumtues për të mbledhur statistika mbi pakicat, gjykata nuk ka pasur personel të mjaftueshëm në dispozicion për të identifikuar në të njëjtën kohë edhe rastet e dhunës në familje. Instalimi i një baze të dhënash të bazuar në rrjet në të cilën rregullisht do të regjistroheshin informatat demografike dhe rastet do të kursente shumë në burime njerëzore, si dhe do të ofronte informata themelore në formë më të shpejtë dhe të saktë.

Në vitin 2007, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka marrë fonde nga Agjencia Evropiane për Rindërtim për të instaluar Sistemin informativ për menaxhimin e lëndëve (SMIL) për të automatizuar gjyqësorin e Kosovës.¹⁹ Sistemi do të lidh në rrjet të gjitha gjykatat dhe do të sigurojë mbledhjen e të dhënave standarde përmes softuerit të njëjtë.²⁰ KGJK-ja shpreson se i tërë personeli i cili përdor këtë sistem do të trajnohet dhe problemet në lidhje me softuerin do të zgjidhen deri në fund të tetorit të vitit 2009, kur edhe është paraparë që sistemi të hyj në funksion. Është e qartë se ka nevojë urgjente që gjyqësori të përdorë këtë bazë të dhënash, e cila ka mundësi t’u mundësoj atyre gjenerimin e shpejtë dhe të saktë të statistikave për dhunën në familje dhe çështjet tjera.

Rreth këtij raporti

“Kosova ka disa nga ligjet më të shkëlqyeshme në botë ... po qe se ato do të zbatoheshin.” Këto mendime janë bërë një gjë e zakonshme në mesin e aktivisteve për të drejtat e grave dhe përfaqësuesit e institucioneve, duke ilustruar kështu vështirësitë e ballafaquara

¹⁹ Shih faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në adresën <http://www.kgjk-ks.org/?cid=2,44&tpl=section.php>

²⁰ Intervistë telefonike e RrGGK-së me Besnik Ramosaj, Departamenti i Statistikave, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, shtator 2009. Pajisjet janë instaluar, por ka pasur vonesa sa i përket softuerit

*“Ne kemi ligje shumë të mira në letër,
por ato nuk po zbatohen
– Grua shqiptare, moshë 36-45*

aktuale. Duke u nisur nga intervistat me më shumë se 60 përfaqësues institucionesh, 96 viktima të dhunës në familje, dhe hulumtimet e mëparshme, kapitujt në vijim do të tentojnë të nxjerrin në pah problemet që kanë të bëjnë me legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e tij, kështu që ato të mund të trajtohen përmes Ligjit të ri për mbrojtje kundër dhunës në familje, Strategjisë nacionale dhe Planit të veprimit kundër dhunës në familje dhe legjislacionit tjetër përkatës i cili udhëheq procedurat për ndjekjen e krimeve të kryera në lidhje familjare, procedurat operative dhe punën e institucioneve të ngarkuara me sigurimin e qasjes në drejtësi.

Hulumtimi është përqendruar në atë se si është përgjigjur sistemi gjyqësor në ballafaqimin me dhunën në familje në Kosovë. Universiteti Princeton ka përkufizuar “gjyqësorin” si një sistem ligjor ku gjykatat administrojnë drejtësinë dhe përbëjnë degën gjyqësore të pushtetit.²² Sidoqoftë, ky hulumtim mbledhë një rrjet më të gjerë, duke ekzaminuar institucione shtesë të cilat luajnë një rol direkt ose indirekt në sigurimin e qasjes në gjyqësi për viktimat e dhunës në familje: gjyqtarë, prokurorë, policë dhe përfaqësues të autorizuar siç janë mbrojtësit e viktimës, zyrtarët për ndihmë juridike, avokatët, Qendrat për Punë Sociale dhe vendstrehimet joqeveritare.

Kapitulli i parë shpjegon kornizën ekzistues ligjore. Kapitujt vijues vlerësojnë performancën e institucioneve përgjegjëse për sigurimin e qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në familje. Kapitulli i dytë shqyrton performancën e gjyqtarëve në ofrimin e mbrojtjes kundër dhunës përsëritëse (recidiviste) përmes mekanizmave sikurse është urdhëresa për mbrojtje. Kapitulli i tretë shtjellon ndjekjen penale të akteve të dhunës në familje. Kapitulli i katërt shqyrton punën e Policisë së Kosovës në hetimin e akteve të dhunës në familje si dhe mbrojtjen e viktimave nga dhuna e mëtutjeshme. Kapitulli i pestë vlerëson punën e institucioneve dhe organizatave të ndryshme përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të viktimave gjatë qasjes në drejtësi. Kapitulli i gjashtë i shqyrton perceptimet e qytetarëve për sistemin gjyqësor, i cili mund të ketë ndikim në vendimet e tyre se a t’i drejtohen drejtësisë ose të heshtin për dhunën në familje. Kapitulli i fundit u jep rekomandime hartuesve të politikave dhe institucioneve individuale për përmirësimin e qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në familje.

²¹ Intervistat e RrGGK me përfaqësues të institucioneve, korrik – gusht 2009.

²² Shih Universiteti i Princeton, WordNet, në adresën wordnetweb.princeton.edu/perl/webwn.

më shumë se vetëm
**'Fjalë
në LETËR'?**

KAPITULLI 1. KORNIZA LIGJORE E KOSOVËS MBI DHUNËN NË FAMILJE NË KOSOVË

KAPITULLI 1. KORNIZA LIGJORE E KOSOVËS MBI DHUNËN NË FAMILJE NË KOSOVË

Dhuna kundër grave dhe fëmijëve në format e saj të ndryshme nuk duhet të durohet në heshtje, dhe gjithnjë e më shumë është duke u bërë pjesë e debateve publike.¹ Përgjigja institucionale ndaj dhunës në familje nuk mbështetet vetëm në dëshirën e lirë të shteteve; dhe sipas të drejtës ndërkombëtare dhe në pajtim me parimet e të drejtave të njeriut shteti ka obligim të drejtpërdrejtë për të hetuar, ndjekur dhe dënuar kryesit e dhunës në familje, ndërsa në anën tjetër t’u ofrojnë mjete efikase viktimave të dhunës në familje.² Janë miratuar konventa të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare për të ngarkuar detyra shteteve për të “respektuar dhe siguruar” të drejtat e të gjithë qytetarëve duke miratuar masa legislative dhe të tjera. Obligimi për të respektuar nuk ndalet vetëm tek kufizimi i veprimeve qeveritare, por po ashtu kërkon veprim për të tejkaluar këtë dhunë.³

Konventat ndërkombëtare të cilat adresojnë të drejtat e grave dhe fëmijëve gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë kur kemi të bëjmë me çështje të dhunës në familje, pasi që shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra dhe fëmijë. Së pari, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas (CEDAW) së bashku me Rekomandimin e Përgjithshëm 19 për dhunën ndaj Grave, përcakton udhëzime specifike për intervenim nga ana e shtetit. Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF) është po ashtu është e rëndësishme kur fëmijët janë të përfshirë në raste të tilla.⁴ Rekomandimi i Përgjithshëm 19 i CEDAW-it përcakton parimet e përgjegjësive së shtetit për veprimet e agjentëve shtetërorë dhe qytetarëve të saj.⁵ Këto dy konventa janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në legjislacionin e Kosovës, të përsëritura përmes Kushtetutës së re të Kosovës, të miratuar me 15 qershor 2008.⁶ Së

¹ Pillay, Navanethem. *Dhuna kundër grave: Dhuna e sponsorizuar shtetërore* në Sjelljen e të drejtave ndërkombëtare të njeriut në shtëpi – kollokium gjyqësor mbi zbatimin vendor të Konventës për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe Konventa për të drejtat e fëmijës. Komet e Bashkuara, 2000, f. 62.

² Rekomandimi i përgjithshëm 19 i Komitetit për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, miratuar në vitin 1992 për zbatimin e Konventës së KB-ve për eliminim e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW). Komiteti ka rekomanduar që duhet të ndërmerren masat vijuese për ofruar mbrojtje efikase për gratë viktimave të dhunës: “masa ligjore [e]fikase, përfshirë dënimet penale, mjete juridike civile dhe ofrim i kompensimit për të mbrojtur gratë kundër çfarëdo lloj dhune” dhe “masa [m]brojtëse, përfshirë strehim, këshillim, veprime rehabilituese dhe shërbime mbështetëse për gratë të cilat janë viktimave të dhunës dhe të cilat janë në rrezik nga dhuna” (neni 24(t), (i), dhe (iii)). Shih po ashtu, mendimet e Komitetit lidhur me rastin *A.T. kundër. Hungarisë, Komunikata Nr. 2/2003*, miratuar me 26 janar 2005, ku Komiteti ka vendosur se për shkak të mungesës së masave efikase ligjore dhe të tjera, Hungaria ka dështuar të ofroj mbrojtje efikase kundër dhunës në familje dhe me këtë ka shkelur të drejtat e parapara me CEDAW.

³ Shih Rebecca Cook, *Përgjegjësia shtetërore sipas CEDAW në ligjin mbi të drejtat e njeriut*, 237 (1994).

⁴ Në Rekomandimin e përgjithshëm 19 kundër dhunës ndaj grave, Komiteti i CEDAW kërkon që shtetet “të me të gjitha mjetet e duhura dhe pa shtyrje të gjurmojnë një politikë për eliminimin e dhunës kundër grave” dhe po ashtu “të [u] shtrojnë kujdes për të parandaluar, hetuar dhe në pajtim me ligjin nacional, të dënojnë aktet e dhunës kundër grave, pa marrë parasysh se a janë kryer këto vepra nga shteti ose personat privat” (neni 9). Komiteti i CEDAW në interpretimin e konventës, ka thënë se “[sh]tetet mund të jenë përgjegjëse për veprimet private, nëse ato kanë dështuar së vepruari me kujdes për të parandaluar shkeljen e të drejtave ose të hetojnë dhe dënojnë aktet e dhunës, dhe të ofrojnë kompensim.” Tutje, Konventa për të drejtat e fëmijës thekson se është e ndaluar dhuna ndaj fëmijëve, dhe kërkon që shtetet të miratojnë “legjislacion të përshtatshëm... për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, dëmtim ose abuzim, neglizhencë ose trajtim neglizhent, keqtrajtim ose shfrytëzim, përfshirë abuzim seksual, deri sa janë nën kujdesin e prindit(ve), kujdestarit(ve) ligjor, ose ndonjë personi tjetër i cili ka kujdesin e fëmijës (neni 19).

⁵ Navanethem, f. 62.

⁶ Ngjashëm, Korniza Kushtetuese e Kosovës në pjesët 3(2) (c), (e), (f) dhe 3(3) paraqet disa instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (d.m.th. CEDAW, KDF) si konventa të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë, të shpallura përmes Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 mbi Institucionet e Përkohshme të Vet-Qeverisjes në Kosovë, miratuar me 15 maj 2001, e disponueshme në <http://www.unmikonline.org> dhe <http://www.assembly-kosova.org>.

dyti, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e cila po ashtu është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë, kërkon që shtetet të ndërmarrin masa adekuate për të luftuar dhunën në familje.⁷

Së treti, përmes instrumenteve ndërkombëtare janë përcaktuar standarde siç janë Deklarata e OKB-së mbi Parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit (Deklarata e OKB-së për viktimat e krimit), e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me 29 nëntor 1985, dhe Deklarata e OKB-së mbi eliminimin e dhunës ndaj gruas (Deklarata e OKB-ve mbi Dhunën), e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me 1993.

Deklarata e OKB-së për viktimat e krimit përcakton disa standarde specifike për të adresuar parandalimin e krimit dhe mbrojtjen e viktimave.⁸ Masat përfshijnë përfaqësimin gjyqësor, informatat mbi proceset gjyqësore, kompensim gjyqësor nga aktet e vuajtura, mbështetje psikologjike dhe mjekësore, strehim dhe ndihmë. Edhe pse këto nuk janë dokumente të detyrueshme ligjore, ato vendosin bazat për intervenim dhe krijojnë standarde të përgjigjes nga ana e autoriteteve në rastet e dhunës në familje. Përfundimisht, Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës ka adresuar çështjet e dhunës në familje duke miratuar rezoluta dhe rekomandime të ndryshme, duke kërkuar përgjigje të menjëhershme nga autoritet shtetërore për dhunën në familje, si në aspektin institucional ashtu edhe në atë ligjor.⁹

Korniza ligjore e Kosovës për mbrojtjen dhe ndjekjen penale të dhunës në familje

Pasi që dhuna mund të shfaqet në forma të ndryshme, varësisht nga shteti, konteksti, kultura dhe lidhjet ndër-familjare, çdo shtet është përgjegjës për krijimin e mekanizmave të duhur ligjorë dhe institucional për t’u përgjigjur ndaj akteve të dhunës në familje brenda kornizës së ligjeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Për të përmbushur obligimin e tyre, autoritetet e Kosovës kanë miratuar disa ligje për të adresuar çështjen e dhunës në familje. Në vitin 2003, UNMIK-u ka shpallur Rregulloren për ndryshimin e ligjit në fuqi

⁷ Neni 3 i Konventës thekson në mënyrë të veçantë se “askush nuk mund të jetë subjekt i torturës ose trajtimit poshtëruës ose dënimi.” Lexo në kombinim me nenin 1, i cili i obligon shtetet të “të sigurojnë çdokujt nën juridiksionin e tyre gëzimin e të drejtave dhe lirive të definuara në KEDNJ,” kërkon që shtetet si obligim pozitiv, të parandalojnë torturën ose sjelljen degraduese në kontekstin vendor. E drejta zakonore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), neni 3, kërkon që autoritetet publike të ndërmarrin masa të duhura për të siguruar që individët nuk janë subjekt i trajtimit poshtëruës (përfshirë dhunën në familje) nga persona privat. Korniza ligjore duhet të mbrojë viktimat në situata të tilla. Shih rastin *A. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të GjEDNJ, aktgjykimi, 23 shtator 1998, para. 22 dhe *Z. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNJ, aktgjykimi, 10 maj 2001, para. 73.

⁸ Sipas kësaj deklarate, person mund të konsiderohet një viktimë “pavarësisht asaj nëse kryesi i veprës është identifikuar, kapur, ndjekur penalisht apo dënuar dhe pavarësisht lidhjes familjare në mes të kryesit të veprës dhe viktimës. Më tej, “viktimë” do të thotë personat “të cilët në mënyrë individuale apo kolektive janë lënduar, përfshirë dhunën fizike apo lëndimin mendor, vuajtje emocionale, humbjen ekonomike apo shkeljen e të drejtave të tyre themelore, përmes veprimeve apo gabimeve të cilat janë në shkelje të ligjeve penale në funksion brenda ... shteteve.”

⁹ Shih në veçanti rekomandimin 1582 (2002), kundër dhunës në familje ndaj grave, ku Asambleja u kërkon shteteve anëtare që të njohin obligimin e tyre për të parandaluar, hetuar, dhe dënuar të gjitha aktet e dhunës në familje dhe të mbrojnë viktimat e dhunës familjare. E disponueshme në <http://assembly.coe.int/Main.asp?link=/Documents/AdoptedText/ta02/EREC1582.htm>.

lidhur me veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën seksuale, duke i konsideruar vepra penale aktet e dhunimeve martesore.¹⁰ Më pas në maj të vitit 2003, UNMIK-u ka shpallur Rregulloren për mbrojtjen kundër dhunës në familje 2003/12, duke i dhënë gjykatave rolin kryesor në dhënien e urdhrave për mbrojtje si mjet juridik civil. Më tej, Kodi Penal i Kosovës (KPK) dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) përcaktojnë disa vepra penale të kryera në lidhje familjare të cilat në procedurën penale mund të konsiderohen si dhunë në familje.¹¹

Edhe pse KPK-ja vetvetiu nuk i kriminalizon aktet e dhunës në familje, sidoqoftë ajo përcakton disa vepra penale të cilat mund të konsiderohen si akte të dhunës në familje ose gabime kur ato kryhen në lidhje familjare:

- Lëndimi i lehtë dhe i rëndë trupor (neni 153 dhe 154 i KPK-së);
- Shtërngimi (neni 160);
- Kanosja (neni 161);
- Privimi i kundërligjshëm nga liria (neni 162);
- Dhunimi, përfshirë dhunimin martesor dhe sulmin seksual (neni 193, 195);
- Degradimi i integritetit seksual (neni 196);
- Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore a emocionale ose me paaftësi mendore (neni 197);
- Rrëmbimi i kundërligjshëm i fëmijës (neni 210);
- Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës (neni 211);
- Shkelja e detyrimeve familjare (nenet 212, 213);
- Vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe e punës së detyruar (neni 137); dhe
- Veprat penale kundër pasurisë kur kryhen në lidhje familjare, përfshirë veprat penale të vjedhjes, shpërdorimi ose marrja e posedimit të pasurisë së luajtshme të viktimës, përfshirë mashtrimin, sikurse dhe dëmet e shkaktuara në të drejtat pronësore (nenet 252, 253, 257, 258, 260, 261).¹²

Për të ofruar mjete juridike civile dhe penale për viktimat e dhunës në familje, ligji i zbatueshëm i Kosovës përfshinë një përkufizim të gjerë të marrëdhënieve familjare për të adresuar format e ndryshme të lidhjeve ndër-familjare që mbizotërojnë në Kosovë.¹³ Prandaj, aktet e dhunës në familje në Kosovë mund të shfaqen në mes të partnerëve intim jashtëmartesor që banojnë së bashku, dajës dhe mbesës, vjehrrit dhe nuses, dhe/

¹⁰ Rregullorja e UNMIK 2003/01 mbi ndryshimin e ligjit në fuqi lidhur me veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën seksuale.

¹¹ Shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25 dhe 2003/26 dhe ndryshuar me ligjet e Kuvendit të Kosovës, p.sh., Ligji mbi ndryshimin e kodit të përkohshëm penal të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-02 dhe Ligji mbi ndryshimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-03 (6 nëntor 2008). Ligje të tjera po ashtu rregullojnë forma të ndryshme të dhunës në familje të cilat ndodhin në publik ose në procedura lidhur me kontestet familjare, sikurse është ligji mbi rendin dhe qetësinë publike (Gazeta Zyrtare e KSAK. Nr. 13/81.), Ligji i Kuvendit të Kosovës mbi Familjen, Nr. 2004/32, etj.

¹² Këto nene janë të parapara në Kodin Penal të Kosovës në Kapitujt mbi: veprat penale kundër jetës dhe trupit; kundër lirisë dhe të drejtave të personave; integritetit seksual; martesës dhe familjes; pasurisë; dhe të drejtës ndërkombëtare.

¹³ Shih definicionin e "lidhjes familjare" në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/12, neni 1.1, dhe nenin 107(24) të Kodit Penal të Kosovës.

ose prindërve të fëmijës të përbashkët që nuk jetojnë në objekt të njëjtë, në mesin e marrëdhënieve tjera.¹⁴ Rregullorja mbi Dhunën në Familje e adreson problemin e dhunës në familje në mes të personave në lidhje familjare të cilët ndajnë një banesë të përbashkët ose janë prindër të fëmijës. Përkundër perceptimeve ekzistuese në mesin e disa qytetarëve,¹⁵ një çift nuk ka nevojë të ketë certifikatë zyrtare të kurorëzimit për të jetuar në një “lidhje familjare” dhe të jenë të dyshuar për dhunë në familje.¹⁶

Rregullorja për mbrojtjen kundër dhunës në familje i përkufizon aktet e dhunës në familje dhe gabimet si baza për lëshimin e urdhrave për mbrojtje në procedurën e përshpejtuar civile.¹⁷ Disa nga aktet e përkufizuara në Rregullore krahasohen me veprat penale të shënuara në KPK që kanë për qëllim lëshimin e urdhrave për mbrojtje. Aktet e tjera të shënuar në Rregullore e zgjerojnë përkufizimin e dhunës në familje për të rregulluar shfaqje të ndryshme të akteve të dhunës në familje dhe ofrojnë mbrojtje kundër këtyre akteve. Sepse disa akte të cilat ekzistojnë në Rregullore, por nuk gjinden në legjislacionin penal të Kosovës, është kritikuar si një zbrazëti në ofrimin e mjete efikase juridike për viktimat e dhunës në familje.¹⁸ Rregullorja i konsideron aktet e mëposhtme si “akte të dhunës në familje”:

- Shkaktimi i lëndimit trupor;
- Marrëdhënia seksuale ose keqtrajtimi seksual pa pëlqim;
- Qitja e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen e tij apo të saj fizike, emocionale dhe ekonomike;
- Rrëmbimi;
- Shkaktimi i dëmeve pasurore;
- Kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;
- Hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër;
- Largimi me dhunë i personit tjetër nga banesa e përbashkët;
- Ndalimi i personit tjetër për të hyrë ose për të dalë nga banesa e përbashkët ose
- Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përlules së personit tjetër.¹⁹

Veçanërisht, Rregullorja kërkon ndjekje sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) për shkak të shkëljes së urdhrat për mbrojtje dhe lëndimit të lehtë trupor.²⁰ Kodi i mëparshëm penal

¹⁴ Shih RrGGK, *Siguria nis në shtëpi*.

¹⁵ Intervistat e RrGGK me viktimat e dhunës në familje. Shih kapitullin 6.

¹⁶ Shih pjesën 1.1, paragrafi b i Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje dhe nenin 107, paragrafi 1 (24) i Kodit Penal të Kosovës.

¹⁷ Shih paragrafët (6.3); (7.3); (8.4); (8.6); (9.4); (10.4); (10.6); (13.4); dhe (13.6) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje, ku veçohet se duhet ndjekur Ligji mbi Procedurën Kontestimore gjatë lëshimit të urdhërësave për mbrojtje dhe thirrjen e palëve. Për më tepër, në nenin 18.2 përcakton se “dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore do të zbatohen kur kjo nuk është e specifikuar në Rregullore si procedurë e veçantë kontestimore.”

¹⁸ Intervista me gjyqtarë të RrGGK, korrik - gusht 2009.

¹⁹ Neni 1.2 e Rregullores së UNMIK-ut 2003/12.

²⁰ Neni 16.2 dhe 16.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/12. Siç shihet, Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje kërkon po ashtu ndjekje *ex officio* në rastet e dëmtimit të pasurisë. Sidoqoftë, Kodi i ri i të Kosovës ka futur përsëri në funksion se dëmtimi i pasurisë së paluajtshme duhet të ndiqet penalisht mbi baza të një kërkesë nga pala e dëmtuar, duke zëvendësuar dispozitat e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje (shih nenin 260 dhe 275 të KPK). Po ashtu, Misioni i OSBE-së në Kosovë, raporti “Rastet e dhunës në familje në Kosovë,” f. 18 (2007).

i Kosovës ka kërkuar që pala e dëmtuar të ngritë padi private për ndjekjen e rasteve të lëndimit të lehtë trupor.²¹ Sidoqoftë, kjo më nuk është e nevojshme. Rregullorja kërkon ndjekje sipas detyrës zyrtare për veprat e lëndimit të lehtë trupor duke ndryshuar ligjin e mëparshëm.²² Kjo kërkesë nuk është zëvendësuar me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) (2003/26) që ka hyrë në fuqi pas Rregullores për mbrojtjen kundër dhunës në familje. Kodi i ri i procedurës penale të Kosovës ka larguar pjesën sipas së cilës është kërkuar që pala e dëmtuar të paraqes një shkresë në rastet e lëndimit të lehtë trupor (shih nenin 153 të KPK-së). Prandaj Prokuroria është e detyruar që të ndjekë sipas detyrës zyrtare veprat penale të lëndimit të lehtë trupor.

Rregullorja për mbrojtjen kundër dhunës në familje e adreson nevojën për mbrojtje të drejtave të viktimave të dhunës në familje i mundësuar një gjyqtari që në procedurë civile të lëshojë disa masa mbrojtëse kundër kryesve të pretenduar. Masat përfshijnë: ndalimin që kryesi t’i afrohet viktimës brenda një distance të caktuar; t’i ndalojë kryesit vizitimin e vendit të punës së viktimës; ndalimin e bezdisjes; të urdhërojë kthimin e fëmijës nën kujdesin e viktimës; konfiskimin e armëve; të urdhërojë kthimin e viktimës në banesën e përbashkët; dhe/ose të kërkojë nga kryesi të paguaj qiranë për viktimën në rastet e kërcënimit të drejtpërdrejtë për sigurinë e viktimës dhe mirëqenien e saj.²³ Këto masa janë në dispozicion përmes lëshimit të tre llojeve të urdhrave për mbrojtje: Urdhëresat për Mbrojtje Emergjente të Përkohshme (UMEP), Urdhëresat për Mbrojtje Emergjente (UME) dhe Urdhëresat për Mbrojtje (UM).

²¹ Kodi Penal i KSAK dhe Kodi i Procedurës Penale të ish Republikës Jugosllave. Shih raportin e Misionit të OSBE në Kosovë, pjesa 6, “Të drejtat e viktimave: Rishikim i sistemit të drejtësisë penale 2000-2001,” e disponueshme në http://www.osce.org/documents/mik/2001/07/969_en.pdf.

²² Pjesa 16.2 e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje.

²³ Pjesa 2 e Rregullores së UNMIK-ut 2003/12.

më shumë se vetëm ‘Fjalë’ në LETËR’?

KAPITULLI 2. MBROJTJA KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE: URDHRAT PËR MBROJTJE DHE PËRGJIGJA E GJYQTARËVE

KAPITULLI 2. MBROJTJA KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE: URDHRA TË MBROJTJE DHE PËRGJIGJA E GJYQTARËVE

Sipas Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje, përgjegjësia primare në ofrimin e mbrojtjes viktimave të dhunës në familje bie mbi gjykata.¹ Gjykata mund të lëshoj dy lloje të urdhrave për mbrojtje: Urdhrat për Mbrojtje Emergjente (UME) dhe Urdhrat për Mbrojtje (UM).² Dallimet në mes të urdhrave janë kohëzgjatja për të cilën ato zbatohen, afatet e gjykatave për të lëshuar urdhrat për mbrojtje dhe masat të cilat mund të aplikohen kundër kryesve. Urdhrat për mbrojtje e plotësojnë njëri tjetrin me UME-në të lëshuar në procedurë të shpejtë në rastet kur siguria dhe mirëqenia e viktimës konsiderohet të jenë në rrezik. Nëse gjykata lëshon në mënyrë të shpejtë një UME, kjo nuk e ndalon atë që së pari të lëshojë UM në rast se viktimja ose personi i autorizuar kërkon një urdhër të tillë.

UME-ja duhet të lëshohet brenda 24 orëve dhe duhet të konfirmohet brenda 48 orëve nga lëshimi në seancë të rregullt gjyqësore të thirrur nga një gjyqtarë i vetëm në prani të viktimës dhe kryesit të pretenduar. UM-ja lëshohet për një kohëzgjatje maksimale prej 12 muaj dhe mund të përfshijë masa shtesë kundër kryerësit (shih më poshtë).³ Afati për lëshimin e UM-së është 15 ditë në seancë të rregullt gjyqësore dhe më së shumti mund të lëshohet për 12 muaj. Agjencia për zbatimin e ligjit, Policia e Kosovës,⁴ është e obliguar të mbikëqyrë zbatimin adekuat të UM-së, që përfshin ndërmarrjen e masave në rast të shkeljes së UM-së. Rregullorja po ashtu parasheh që policia mund të lëshoj një lloj të tretë të UM-së, Urdhrin për mbrojtje emergjente të përkohshme (UMEP) për një periudhë prej 48 orëve kur gjyqtarët nuk janë në dispozicion, siç është rasti gjatë natës ose fundjavës.⁵

Tabela e mëposhtme ilustron numrin e UM-ve të lëshuara nga gjykatat (460) dhe policia (103) brenda vitit dhe në përgjithësi. Është vërejtur se në shënimet e Policisë së Kosovës, nuk duket se ata bëjnë ndonjë dallim në mes të UM-ve të ndryshëm që janë në dispozicion.

Urdhrat për mbrojtje të lëshuara në Kosovë

Urdhrat për mbrojtje të lëshuara nga:	2005	2006	2007	2008	2009 (qershor)	TOTALI
Gjykata	108	183	59	54	56	460
Policia e Kosovës	3	1	4	95		103
TOTALI	111	184	63	149	56	563

Burimi: Policia e Kosovës, sektori kundër dhunës në familje, drejtorja e krimeve të rënda

¹ Pjesa 5 e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje specifikon se është gjykata komunale ajo e cila ka juridiksionin për të lëshuar urdhëresat për mbrojtje për kërkuesit të cilët banojnë në territorin e gjykatës përkohësisht ose në mënyrë të përhershme. Përbërja e gjykatës në vendosjen lidhur me urdhëresat për mbrojtje është një gjyqtar i vetëm. Në rastet kur kërkesat sipas ligjit mbi familjen janë në vijim. Gjykata kompetente për të vendosur në këto raste janë po ashtu kompetente për të lëshuar urdhëresat për mbrojtje, p.sh., Gjykata e Qarkut

² Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje po ashtu parasheh lëshimin e Urdhëresave për Mbrojtje Emergjente të Përkohshme (UMEP) (shih më poshtë) UMEP është shumë i rëndësishëm për rastet e dhunës në familje të raportuara gjatë fundjavave pasi që gjykatat nuk i kanë në dispozicion të gjithë gjyqtarët. UMEP duhet të konfirmohet nga një gjyqtarë në ditën vijuese të punës në gjykatë. (Neni 13).

³ Shih nenin 2 të Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje për listën e plotë të masave.

⁴ Neni 1.7 e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje e definon “Agjencinë e zbatimit të ligjit” si “Policia civile e UNMIK-ut, po ashtu e njohur si Policia ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara ose Policia e UNMIK-ut, dhe Shërbimi Policor i Kosovës.”

⁵ Për më shumë informata shih kapitullin 4.

Në pajtim me Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje, UM-të kanë për qëllim mbrojtjen e viktimës nga dhuna e mëtutjeshme, veçanërisht gjatë periudhës kur ka ndodhë krimi i pretenduar dhe kohës kur mbahet gjykimi. Gjyqtarët e lëmisë civile kanë një rol të rëndësishëm në garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së viktimave të dhunës në familje përmes vendimeve të tyre sa i përket UM-ve. Sidoqoftë, janë identifikuar një numër çështjesh që kanë të bëjnë me përgjigjet nga gjyqtarët dhe vendime të tyre mbi UM-të, siç edhe ilustrohen në këtë kapitull, përfshirë: vonesat në lëshimin e UM-ve; dënime të lehta për recidivistët dhe shkelësit e UM-ve; lëshim i kufizuar i masave të parapara sipas Rregullores; arsyetim i dobët i aktgjykimeve me të cilat shqiptohen UM-të; dhe vëmendje e kufizuar në sigurimin e zbatimit të UM-ve.

Vonesat në lëshimin e Urdhrave për mbrojtje

Mangësi të ndryshme janë gjetur në performancën e gjykatave në sigurimin e mbrojtjes efikase dhe efektive për viktimat. Raportet vazhdimisht kanë bërë me dije dështimin e gjyqtarëve në lëshimin e UM-ve brenda afateve të përcaktuara me Rregullore.⁶ Janë vërejtur raste kur gjyqtarëve u është dashur më shumë se një vit për të lëshuar UM, përderisa për UM u janë dashur disa ditë ose edhe muaj.⁷ Intervistat e RrGGK-së me disa institucione dhe viktimat në qershor dhe korrik 2009, kanë konfirmuar se vonesat ende vazhdojnë.⁸ Dy viktimat të dhunës në familje i kanë thënë RrGGK-së se gjykatat kanë lëshuar UME pas 24 orëve të parashikuara me ligj. Një të intervistuari i është dashur të pres më shumë se 16 ditë derisa gjykata ka lëshuar një UM, dhe mbrojtësit e viktimave (MV) i kanë thënë RrGGK-së se në disa raste gjykatave u është dashur deri në tre muaj për të lëshuar një UM.⁹

Në monitorimin e tyre të kryer së voni, për lëshimin e UM-ve në disa lëndë civile, Sektori i Monitorimit të Sistemit Ligjor (SMSL) në kuadër të Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka ngritur të njëjtin shqetësim duke vërejtur vetëm përmirësime të vogla: disa UM janë duke u vonuar deri në nëntë javë, në vend të tre muajve që ishte më parë.¹⁰ Është e qartë se gjykatat akoma dështojnë të veprojnë në pajtim me Rregullore, e cila kërkon lëshimin e UM-së brenda 15 ditëve nga kërkimi i tij për të mbrojtur sigurinë dhe mirëqenien e viktimës. Mohimi i një procedure të shpejtë dhe mbrojtje të shpejtë rrezikon sigurinë e viktimës. Vonesat në lëshimin e UM-ve mund të rezultojnë në përsëritjen e dhunës apo madje edhe rritjen e saj.

⁶ Shih RrGGK, *Siguria nis në shtëpi*; Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Raport mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë* (2007); dhe raportin e lartpërmendur të Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë

⁷ Ibid.

⁸ Seksioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor (SMSL) i Misionit të OSBE-së në Kosovë, vazhdon me monitorimin e rasteve civile ku kërkohen urdhëresa për mbrojtje (raporti i fundit mbi dhunën në familje në Kosovë, është publikuar në korrik 2007. Në vitin 2009 SMSL ka vërejtur se në raste civile gjyqtarët kanë vazhduar të vonojnë lëshimin e UM-ve më shumë se kufiri i lejuar me Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje (intervistë e RrGGK me personelin e SMSL-së, shtator 2009).

⁹ Intervista të RrGGK me avokatët e viktimave, qershor-gusht 2009.

¹⁰ Intervista të SMSL, shtator 2009.

Gjyqtarët i atribuojnë këto vonesa mungesës së kuadrit dhe shmangies së seancave gjyqësore nga ana e kryesve,¹¹ viktimave që nuk i përgjigjen ftesave të gjykatës, ndryshimeve të adresave të banimit, çështjeve procedurale, mungesës së gjykatave funksionale në rajonin e Mitrovicës¹² hetimeve të dobëta nga policia, tërheqjes së paraqitjes fillestare dhe në lidhje me këtë, pajtimin në mes të anëtarëve të familjes para dëgjimit.¹³ Një avokat ka thënë, “Këto raste fillimisht duken urgjente, por ato bëhen raste ‘normale’ ... sepse institucionet tjera mundohen të ndërmjetësojnë një marrëveshje në mes të kryerësit dhe viktimës.” Sidoqoftë, gjykatat kanë detyrë për të siguruar një procedurë të shpejtë, në mënyrë që mungesa e veprimit të mos kontribuojë në dhunën e ardhshme. Në masë të konsiderueshme, në disa raste, viktimat më vonë kanë ripërtërirë kërkesat e tyre për shkak të recidivizmit.¹⁴

Disa gjykata kanë tejkaluar vonesat duke emëruar një gjyqtarë për t’u marrë me rastet e dhunës në familje dhe lëshimin e UM-ve, sikurse është rasti me gjykatën komunale në Pejë dhe Gjilan. Nevoja për trajnime të specializuara kundër dhunës në familje dhe caktimi i gjyqtarëve të veçantë për të punuar vetëm me rastet e dhunës në familje, është ngritur si çështje dhe kërkuar vazhdimisht gjatë intervistave.¹⁵

Dënime të buta për kryerësit recidivist dhe shkelësit e urdhrave për mbrojtje

Në rastet civile, disa gjyqtarë e kanë vërejtur problemin e recidivizmit, pasi që Rregullorja nuk parasheh se çfarë lloje të dënimeve duhet të shqiptohen në rast të recidivizmit. Për momentin, kur kryerësit shkelin masat e lëshuara përmes UM-ve, gjyqtarët duket se i dënojnë ato me dënime të lehta.¹⁶ Më pas nuk duket e çuditshme që rastet paraqiten sërish para gjykatës.

Rregullorja parasheh që shkeljet e UM-ve duhet të rezultojnë në shqiptimin e gjobave për shkelësit në vlerë prej 200 deri 2000 euro, ose deri gjashtë muaj burgim.¹⁷ Për momentin, në rastet e shkeljes së UM-ve, gjyqtarët zakonisht po i gjobisin kryerësit në vlerë prej 200 euro.¹⁸ RrGGK-ja ka identifikuar vetëm disa raste të burgimit pas shkeljes së UM-së¹⁹ e nganjëherë nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Për shembull, një grua ka thënë:

¹¹ Viktimat e dhunës në familje kanë thënë se kryesit nuk marrin pjesë në seanca gjyqësore dhe/ose kanë thënë se nuk kanë pranuar ftesë nga gjykata (intervistë e RrGGK, gusht 2009)

¹² Meqë gjykatat për rajonin e Mitrovicës ndodhen në veri dhe ato nuk funksionojnë sipas legjisllacionit Kosovar, kosovarët pjesëtar të komunitetit shqiptar veçanërisht kanë mungesë të qasjes në drejtësi. Viktimet e dhunës në familje pjesëtarë të komunitetit serb vazhdimisht kërkojnë drejtësi nga gjykatat të cilat ndodhen në Beograd (intervistë e RrGGK-së me përfaqësuesit e institucioneve në rajonin e Mitrovicës, korrik – gusht 2009)

¹³ Intervistë e RrGGK me gjyqtarë komunal, korrik-gusht 2009.

¹⁴ Intervistë e RrGGK, gusht 2009.

¹⁵ Intervista të RrGGK me përfaqësuesit e të gjitha institucioneve, korrik-gusht 2009.

¹⁶ Intervista të RrGGK KWN me përfaqësues të institucioneve, korrik-gusht 2009. Më tej, përfaqësues ata thanë se policia rrallë i monitoron UM-të ose heton siç duhet shkeljet e UM-ve (shih Kapitullin 4)

¹⁷ Neni 15 i Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje.

¹⁸ Intervista të RrGGK me mbrojtës të viktimave dhe prokurorë, respektivisht korrik dhe gusht 2009

¹⁹ Vetëm një prokuror ka raportuar dënimin me burg pas shkeljes së UM-së (Intervistë e RrGGK, gusht 2009).

Gati çdo ditë ai ka ardhur në vendin tim të punës dhe më ka kërcënuar, gjë që ka qenë në kundërshtim me urdhrin për mbrojtje... Nganjëherë, ata [policia] më kanë përcjellë në pajtim me urdhrin për mbrojtje, por policia nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim serioz kur kryesi nuk ka respektuar urdhrin për mbrojtje.”²⁰

Duhet kuptuar me seriozitetin më të madh se si ndikojnë shkeljet e UM-ve tek viktimat, si në aspektin fizik ashtu edhe në atë moral. Dëshmitë tregojnë se nëse gjyqtarët vazhdojnë të shqiptojnë masa të buta, viktimat më rrallë do të kërkojnë drejtësi dhe do të vazhdojnë në heshtje me vuajtjen e dhunës në familje.²¹

Prandaj gjyqtarët duhet të marrin parasysh shqiptimin e dënimeve më të ashpra për kryerësit të cilët shkelin UM-të. Në raste të recidivizmit, duhet zbatuar masën e burgimit, e cila korrespondon me seriozitetin e veprës së kryer dhe me atë se çfarë kërkohet me ligjin e zbatueshëm.²² Në këtë drejtim, përfaqësues të institucioneve të ndryshme kanë rekomanduar rritje të gjobave.²³ “Kjo [kufiri më i ulët tani] gjobë në lartësi prej 200 eurove duhet të jetë më e lartë,” ka thënë një gjyqtarë i lëmisë civile. “Nuk është zgjidhje sepse ai e din se nëse shkel urdhrin për mbrojtje, është e mundur të dënohet përsëri me një shumë të njëjtë [shumë e vogël]. Duhet dënuar me dyfishin e shumës në rast të recidivizmit.”²⁴ Ngritja e kufirit minimal po ashtu do të zvogëlonte hapësirën kur mendimi personal i gjyqtarit mund të nënvleftësoj dënimin për shkak të seriozitetit të veprës penale të kryer.²⁵

Shqiptim i kufizuar i masave të parapara sipas rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje

Rregullorja parasheh një numër të masave të cilat kanë potencial për të krijuar një bazë për mirëqenien afatgjatë të viktimës, përfshirë: t’i urdhëroj kryesit të paguajë qiranë e banesës së viktimës ose fëmijëve të saj kur siguria dhe mirëqenia e viktimës nuk lejon kthimin në banesën e përbashkët; pagesën e alimentacionit për kohëzgjatjen e UM-së; të urdhëroj kthimin e fëmijëve të viktimës duke vendosur për masën e kujdesit të përkohshëm; ndalimin e shitjes së pasurisë nga ana e viktimës ose kryesi derisa UM-ja është në fuqi; dhe urdhërimin e konfiskimit të armëve, në mesin e masave tjera.

Gjyqtari i gjykatës së qarkut ka ofruar një shembull se si aplikimi i përshtatshëm i këtyre masave i përcjellë me zbatim të duhur të vendimit të gjykatës, mund të ketë ndikim pozitiv:

[N]e kemi urdhëruar kthim të detyrueshëm të viktimës aty ku ka jetuar sepse vjehri i saj e ka larguar atë me forcë nga shtëpia. Edhe pse vjehri i saj ka provuar të shes

²⁰ Intervistë e RrGGK me një grua shqiptare të moshës 26-35, gusht 2009.

²¹ Shih Kpitullin 6.

²² Neni 15 i Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje.

²³ Intervistë e RrGGK me gjyqtarë, punëtorë social, dhe një kryetar të gjykatës, korrik-gusht 2009.

²⁴ Intervistë e RrGGK me gjyqtarë të lëmisë civile, gusht 2009.

²⁵ Çështja e mendimeve personale ose ndërhyrjes së traditës në vendime është ngritur si çështje nga shumë të intervistuar (Shih po ashtu Kpitullin 3).

shtëpinë për të larguar viktimën nga aty dhe gjykata komunale ka mohuar të drejtën e viktimës për t’u kthyer në shtëpi, ne kemi anuluar këtë vendim në dobi të saj dhe kemi urdhëruar kthimin dhe qëndrimin e saj në shtëpi. [Kjo] ka pamundësuar vjehrrin e saj të vazhdojë me shitjen e shtëpisë.²⁶

E drejta e viktimës për të mbetur në banesë të përbashkët është respektuar gjatë tërë kohëzgjatjes së UM-së, e cila masë i ka ofruar asaj kohë shtesë për të kërkuar të drejtat e saj pronësore dhe/ose të gjejë një zgjidhje afatgjate.

Sidoqoftë, masat më së shpeshti të shqiptuara nga gjyqtarët janë shumë pak në krahasim me llojet e shumta të masave të përcaktuara në Rregullore.²⁷ Aktgjykimet e gjykatave kanë tendencë vetëm për të konkluduar se është manifestuar dhuna në familje dhe të lëshojnë një urdhër për mbrojtje i cila zakonisht përmban dy lloje masash: 1) kufizimin e distancës deri në të cilën kryesi i afrohet viktimës, dhe 2) urdhërimin e kthimit të viktimës në banesën e përbashkët. Nuk është vërejtur ndonjë masë e shqiptuar për të urdhëruar kryesin të largohet nga banesa e përbashkët. Po ashtu, nuk është vërejtur ndonjë masë e shqiptuar e cila ka përcaktuar se viktima nuk duhet të kthehet në banesë të përbashkët për shkak të sigurisë dhe shëndetit të saj, por që në vend të kësaj kryesi duhet të paguaj qiranë për banesën ku ajo do të qëndrojë përderisa urdhri për mbrojtje është i vlefshëm.

Urdhëresa e zakonshme për kthim të viktimës në banesë, pa vlerësuar sigurinë dhe mirëqenien e saj, sugjeron se pajtimi shpesh konsiderohet si rezultat i preferuar përfundimtar në rastet civile ku përfshihet dhuna në familje. Një shembull i ofruar nga një avokat shërben për ilustrim:

Ka pasur një rast të dhunës në familje. Burri ka rrahur gruan e tij... Rasti ka shkuar në gjykatë dhe Qendra për Punë Sociale ka rekomanduar që babait t’i takojnë të drejtat e kujdesit prindëror. Ka pasur një ndërmjetësim prej gjashtë muajsh për të inkurajuar çiftin të arrijnë një marrëveshje. Burri është hidhëruar që gruaja e tij ka raportuar dhunën dhe ka vendosur të kërkoj shkurorezim. Ai ka kërkuar nga unë që të vazhdoj me rastin [për shkurorezim], por unë nuk e bëra këtë. E kam gënjyer, “Gjyqtari nuk është aty.” ... sepse kam besuar se lidhja e tyre mund të përmirësohet. Pas gjashtë muajsh ndërmjetësimi dhe konsultimi i të afërmve me të, ata janë pajtuar.²⁸

Mungesa e kujdesit nga ana e avokatit për mirëqenien e viktimës duket se është harruar në orvatjet për të “përmirësuar” lidhjen e çiftit. Më tej, siç edhe ilustron ky rast, procedurat gjyqësore lidhur me kujdesin mbi fëmijën, shkurorezimin ose kërkesën për urdhër për mbrojtje shpesh kanë hedh hije mbi veprën(at) penale të kryesit (një çështje kjo e shtjelluar më tej në Kapitullin 3).²⁹ Pas veprave penale që ndodhin në lidhjet familjare,

²⁶ Intervistë e RrGGK me gjyqtarë të lëmisë civile, gusht 2009.

²⁷ Shih RrGGK, *Siguria nis në shtëpi*. Po ashtu Intervistat e RrGGK-së me institucione dhe vendimet për masat mbrojtëse të paraqitura RrGGK-së nga Gjykata Komunale në Pejë, 2009.

²⁸ Intervistë e RrGGK me avokat, gusht 2009.

²⁹ Intervista të RrGGK me viktima të dhunës në familje dhe përfaqësues të institucioneve, korrik-gusht 2009.

të cilat kërkojnë ndjekje penale në mënyrë automatike, shumë viktime asnjëherë nuk janë njoftuar se urdhrat për mbrojtje kanë qenë një mundësi, e mos të flasim për masat mbrojtëse që kanë mund t’iu ofrohen atyre.³⁰ Dështimi për të marrë shqyrtuar masa tjera të cilat mund të kontribuojnë në mirëqenien e viktimës, u mohon atyre qasjen efikase në drejtësi, duke i lënë ata me predispozita për t’iu nënshtruar dhunës së përsëritur.

Disa gjyqtarë të lëmisë civile janë përqendruar në pajtim, siç ilustron shembullin e urdhërimit të viktimës për kthim në banesën e përbashkët, me zgjidhje të qëndrueshme të kufizuara për viktimën. Shumë gjyqtarë dhe prokurorë kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me pak opsione që janë në dispozicion të grave pas raportimit të dhunës, varësia ekonomike e grave nga kryesi, mungesa e objekteve alternative të banimit për viktime dhe pasojat e raportimit të dhunës në ruajtjen e martesës dhe familjes.³¹ Si pasojë e kësaj, disa gjyqtarë kanë shqyrtuar masa duke u bazuar në atë çfarë ata konsiderojnë se është në interesin më të mirë të familjes dhe kështu duke mos vënë re ose duke arsyetuar pa dashje aktet e dhunës në familje. Për shembull, kryetari i një gjykate komunale ka thënë:

[N]e kemi pasur një rast të dhunës fizike. Kryesit i është urdhëruar paraburgimi. Të nesërmen kur ka ardhur tek gjyqtari, ai ka deklaruar se martesë do të merr fund këtu sepse gruaja e ka raportuar atë. Kështu që policia nuk është dashur ta arrestoj atë; ata nuk kanë menduar se çfarë do të ndodhte me çiftin. [T]ani ajo është e shkurorëzuar. Duhet të respektojmë se këtu ka një shoqëri patriarkale. Policia nuk është dashur ta arrestoj atë edhe pse gruaja e ka akuzuar. Të dytë duhet mbajtur së bashku në stacionin e policisë dhe jo të arrestohet burri ose të bëhet diç e ngjashme që mund të ketë ndikim në martesën e tyre dhe mund të shpie drejt shkurorëzimit...³²

Ngjashëm ka komentuar edhe një gjyqtarë i lëmisë civile:

[Q]ëllimi i intervenimit ligjor duhet të jetë mbrojtja e familjes. Dhënia e urdhëresave për mbrojtje sipas rregullores ka qenë kundër produktive dhe nuk kanë mbrojtur familjen. Për më tepër, ato kanë ndikuar në shkatërrimin e saj. ... Ka një rast kur masat jo efikase të rregullores kanë shkatërruar familjen dhe ka pasur shkurorëzim. Rasti i dhunës në familje i është raportuar policisë [nga fqinjët] dhe për shkak të traditës, burri ka vendosur të shkurorëzohet. Duhet të ketë një qendër këshillimore për të raportuar dhe këshilluar rastet të cilat nuk ballafaqohen me dhunë familjare afatgjate, kur akoma ka mundësi për të shmangur shkurorëzimin.³³

Shumë të intervistuar nga institucionet e Kosovës kanë shprehur preferencë të ngjashme për konsultim në vend të procedurave gjyqësore.³⁴ Sidoqoftë, përkundër qëllimeve më të mira të gjyqtarëve, pajtimi i detyrueshëm dhe kthimi i viktimës në vendbanimet e

³⁰ Pesë viktime kanë thënë se policia nuk i ka njoftuar ato për UM-të kur kanë raportuar dhunën (Intervista të RrGGK, gusht 2009).

³¹ Intervista të RrGGK me gjyqtarë, qershor-gusht 2009.

³² Intervista të RrGGK me kryetar të gjykatës komunale, gusht 2009.

³³ Intervista të RrGGK me gjyqtarë të lëmisë civile, gusht 2009.

³⁴ Intervista të RrGGK me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, korrik-gusht 2009.

mëparshme është dëshmuar jo efikase.³⁵ Tre gra të cilat janë “pajtuar” me burrat e tyre, të intervistuar nga RrGGK-ja, kanë raportuar se pas “pajtimit” kanë vazhduar të përjetojnë dhunë fizike dhe psikike. Më tej, 15 viktimat të cilat kanë pranuar shërbime pajtimi nga institucionet, kanë thënë se nuk u ka pëlqyer të jenë të shtyra për t’u pajtuar. Gjatë “zgjdhjes” së këtyre rasteve, gjyqtarët duhet të zbatojnë ligjin dhe të marrin për bazë interesin më të mirë të viktimës, së pari dhe më e rëndësishmja të kujdesen për mirëqenien fizike dhe emocionale të saj ose tij. Për më tepër, çfarë është në “interesin më të mirë” të viktimës duhet të përcaktohet në konsultim me viktimën dhe jo bazuar vetëm në perspektivën e gjykatës ose institucionit tjetër.

“Gjatë tërë kohës ata provuan të minimizojnë veprimet e kryesit.” – Një grua shqiptare, moshë 26-35

“[Këto] probleme duhet të eliminohen përmes ligjit, ”ka komentuar një përfaqësues i vendstrehimit. “Ligji duhet të zbatohet që mos të ketë hapësirë për përfundime paragjyquese gjatë gjykimit; të mos detyrohen viktimat të kthehen në kushte të dhunshme.” Përkundër perceptimit me sa duket të ngjashëm në mesin e gjyqtarëve civil, roli i tyre nuk është të ndërmjetësojnë rastet, por të zbatojnë ligjin. Mendimi i tyre lidhur me interesat më të mira të klientit ose familjes nuk duhet të jenë të rëndësishme në procesin e vendimmarrjes. Përndryshe, perceptimet patriarkale të ngulitura në shoqëri, bartin rrezikun e ndikimit të opinionit gjyqësor përgjatë procedurës, siç edhe ilustron me rastin e mësipërm.³⁶

Për shembull, ndikimi i traditës patriarkale në vendimet e gjykatave civile është evident në rastet e kujdestarisë së fëmijëve, rast që shpesh ndërlidhet me dhunën në familje. Të intervistuarit kanë përshkruar rastet ku gjyqtarët padrejtësisht u kanë dhënë kujdestarinë kryesve të dhunës në familje.³⁷ Arsye e zakonshme dhënien e kujdestarisë kryesve (meshkuj) ka qenë gjendja e rëndë financiare (femrës) dhe/ose mungesa e pronës.³⁸ Në disa raste, gjendja ekonomike e kryesit ka pasur prioritet ndaj mirëqenies fizike dhe psikike të fëmijës. Një zyrtar i policisë ka përshkruar një rast të tillë: “Kryesi ka përdorur dhunë edhe kundër fëmijëve të tij, [por] ata kanë jetuar me të për shkak se e ëma nuk ka mund t’i merr [me veti] tek vëllai i saj për shkak të kushteve të rënda ekonomike atje.”³⁹ Një përfaqësues i vendstrehimit ka treguar për raste tjera ku gratë kanë humbur kujdestarinë mbi fëmijët e tyre sepse të drejtat e tyre në pronën e përbashkët nuk u janë njohur në vlerësimet financiare lidhur me kujdestarinë dhe/ose ato nuk kanë mundur të kenë avokat për të luftuar për të drejtat e tyre pronësore dhe trashëgimore.⁴⁰

*“[Gjyqtari] më ka thënë gjatë gjithë kohës se sa e vështirë është për një prind të vetëm rritja e fëmijëve të saj.”
 - Një grua, moshë 36-45*

³⁵ Intervista të RrGGK me viktimat të dhunës në familje dhe institucione, korrik-gusht 2009.

³⁶ Përpjekjet e gjyqtarëve për të gjetur zgjidhjen më të mirë për çdo familje mund të ndikojnë në shtyrje dhe mos përfundim të rasteve, ka thënë një gjyqtarë i lëmisë civile, “Mungesa e një zgjidhje efikase e cila do ta parandalonte përsëritjen e dhunës, ndikon në rast, ashtu që rasti mbetet i hapur.” Viktimat e dhunës në familje të intervistuar nga RrGGK-ja po ashtu thanë se korrupsioni dhe nepotizmi në mesin e gjyqtarëve kanë ndikuar në vonesën e procedurave gjyqësore dhe gjykimet e padrejta të lëndëve civile dhe penale

³⁷ Intervista të RrGGK me policë, përfaqësues të vendstrehimeve, avokatë, dhe prokurorë, korrik-gusht 2009.

³⁸ Ibid.

³⁹ Intervista të RrGGK me zyrtarë të policisë së Kosovës, gusht 2009.

⁴⁰ Intervistë e RrGGK, gusht 2009.

Pjesa më e madhe e viktimave të dhunës në familje të cilët kanë pasur fëmijë (87 për qind), të intervistuar nga RrGGK-ja, kanë treguar se fëmijët e tyre kanë mbetur me kryesit kur ato janë dërguar në strehimore. Disa nga to kanë shpjeguar dhunën që kryesit në atë kohë kishin ushtruar kundër fëmijëve. Në pajtim me Konventën për të drejtat e fëmijës, fëmijëve të cilët jetojnë në familjet ku ka ndodhur dhuna në familje duhet t’u kushtohet kujdes më i afërt.

Zbatimi i duhur i masave të parapara me Rregulloren për mbrojtjen kundër dhunës në familje, u lejon gjyqtarëve dhënien e kujdestarisë së përkohshme të fëmijëve viktimës (neni 2), që mundet po ashtu të siguroj mbrojtje të fëmijëve nga dhuna e mundshme nga kryesi. Dhënia e kujdestarisë kryesve të dhunës në familje, mund të vendos në rrezik të madh fëmijën dhe në të njëjtën kohë t’ia ndryshoj mendjen grave për të raportuar dhunën në familje në të ardhmen.⁴¹ Një zyrtar policie ka vërejtur se vendimet e kujdestarisë e kanë bërë më të vështirë qasjen në drejtësi të grave me fëmijë: “Ato mund të frikësohen se nuk do të fitojnë të drejtat prindërore, posaçërisht kur nuk janë të punësuar ose nuk kanë banim të tyre për të jetuar me fëmijët.” Kërkohet një përgjigje më e kujdesshme nga ana e gjyqtarëve, që merr parasysh të gjitha faktet në betejat për kujdestari mbi fëmijët. Lidhur me dhunën në familje, një vëmendje më e madhe për masat e ndryshme të parapara në Rregullore do t’u mundësonte gjyqtarëve që të ofrojnë zgjidhje më të sigurta, të paktën në baza të përkohshme, për viktimat dhe fëmijët e tyre.

Rasti i lartpërmendur tregon se avokatët dhe gjyqtarët ose kanë njohuri të kufizuara për masat e parapara në Rregullore, ose hezitojnë të përdorin këto masa. Meqë gjyqtarët janë të kufizuar nga masat e kërkuara nga viktimat, avokatët mbrojtësit e viktimave, mund të luajnë rol të rëndësishëm në këshillimin e viktimave për masat të cilat i mundëson Rregullorja. Zbatimi i plotë i këtyre masave ka potencialin të mbështes mirëqenien afatgjatë socio-ekonomike të viktimave dhe fëmijëve të tyre dhe të siguroj mbrojtje të përshtatshme për të drejtat e viktimave në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut. Nëse zbatohen siç duhet, banesat e subvencionuara nga qeveria dhe mbështetja institucionale në sigurimin e punësimit për viktimat, të përcjella me gjopa të rritura, zbatim të alimentacionit, dhe /ose pagesë të qirasë nga kryesit, do të mund të adresojnë shqetësimet mbi vartësinë ekonomike të grave dhe mungesën e alternativave të qëndrueshme për strehim. Përdorimi i plotë i masave të parapara me urdhrin për mbrojtje, do të mbështeste viktimat vetëm përkohësisht, por së paku u ofron atyre një mundësi për të zgjeruar fushën e opsioneve dhe të vendosin më lirshëm për ardhmërinë e tyre.

Arsyetim i varfër i aktgjykimeve me të cilat shqiptohen masat mbrojtëse

Një praktikë tjetër shqetësuese në rastet civile në gjykatat e hulumtuara nga RrGGK-ja, është arsyetimi në përgjithësi i dobët i aktgjykimeve kur shqiptohen urdhrat mbrojtës.⁴² Misioni i OSBE-së në Kosovë ka raportuar më parë se aktgjykimet e gjykatave në kontestet civile

⁴¹ Kryetari i një gjykate dhe tre prokurorë i kanë thënë RrGGK se viktimat janë tërhequr nga rasti nga frika e humbjes së fëmijëve të tyre (Intervista të RrGGK me, korrik-gusht 2009).

⁴² Aktgjykime të rasteve për lëshimin e urdhërësive për mbrojtje, të paraqitura tek RrGGK nga Gjykata Komunale në Pejë.

shpesh nuk përmbajnë arsytim të mjaftueshëm, gjë që shkel ligjin procedural dhe mund të shërbej si bazë për ankesë.⁴³ Është shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtës për gjykim të drejtë në pajtim me nenin 6 të KEDNj dhe praktikën e GjEDNj.⁴⁴ Vendimet e arsyetuara po ashtu kërkohen me Ligjin mbi Procedurën Kontestimore,⁴⁵ i cili parasheh që vendimi përfundimtar duhet të përmbajë një shpjegim të fakteve dhe dëshmimeve mbi të cilat bazohet vendimi.

Edhe pse kanë ekzistuar dëshmi të mjaftueshme, me raportet mjekësore të përmendura në aktgjykimet e gjykatave, në disa raste është dëgjuar vetëm kryesi, viktimi ose mbrojtësi i viktimës.⁴⁶ Vendimet e arsyetuara janë posaçërisht të rëndësishme pasi që mungesa e tyre shkel të drejtën e çdo pale për gjykim të drejtë dhe po ashtu shërben si bazë për anulim të aktgjykimeve nga instanca më e lartë. Kjo situatë mund të lerë palët në një gjendje paqartësie dhe të mohoj mjetet juridike për viktimat pasi që rasti i tyre mund të sfidohet lehtë para gjykatës së instancës më të lartë. Po ashtu e prek të drejtën kryesit për gjykim të drejtë. Këto raste lënë hapësirë për anulim të aktgjykimeve, që mund të ndikojë në mirëqenien dhe sigurinë e viktimës.⁴⁷ Edhe pse Rregullorja thotë se ankesa kundër një vendimi ose kërkesë për urdhër për mbrojtje nuk e shtyn ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje, në praktikë kjo ka shtyrë ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje.⁴⁸ Prandaj, është e rëndësishme të veprohet në pajtim me kërkesat e ligjit të zbatueshëm dhe të shikohen dispozitat e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje. Rregullorja shpreh qartë se gjykata lëshon një urdhër për mbrojtje nëse “ekzistojnë bazat për të besuar se kryesi ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje” (neni 8.1 i Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje), në këtë mënyrë duke kërkuar që bazat e mjaftueshme të janë të arsyetuara mirë dhe të detajuara në mënyrë të qartë.

Vëmendje e kufizuar në sigurimin e zbatimit të urdhrave për mbrojtje

Siç është përmendur, mirëqenia socio-ekonomike e viktimave gjatë dhe pas dhunës është ngritur vazhdimisht si çështje nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme që punojnë me viktimat, si dhe nga vetë viktimat.⁴⁹ Përfaqësues të shumtë të institucioneve kanë komentuar Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje se ajo nuk është në pajtim me ekonominë aktuale.⁵⁰ Dhuna në familje shpesh paraqitet në familje me gjendje

⁴³ Misioni i OSBE-së në Kosovë, Departamenti për të Drejta të Njeriut, Decentralizim, dhe Komunitete: Raporti mujor i SMSL, maj 2007 dhe mars 2008 (“Arsyetimi jo adekuat i aktgjykimeve në kontestet civile bën shkelje të ligjit vendor dhe mund të ndikojë në të drejtën e palës për një gjykim të drejtë”).

⁴⁴ Shih po ashtu raportin e OSBE-së; *Dhuna në Familje në Kosovë*, f.15 (korrik 2007).

⁴⁵ Shih nenin 141 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kuvendit të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në nëntor 2008, i disponueshëm në <http://www.assembly-kosova.org>.

⁴⁶ Misioni i OSBE-së ka raportuar raste të ngjashme në gjykatat komunale në Pejë dhe Gjiilan.

⁴⁷ Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje thotë se “[g]jykata duhet të lëshoj urdhëresë për mbrojtje ...nëse përcakton se ekzistojnë bazat për të besuar se krysi ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje dhe; Lëshimi i urdhrit për mbrojtje është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur” (neni 8 (1) (a) (b)). Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje përcakton se një urdhër për mbrojtje duhet të përmbajë, të drejtën për ankesë edhe pse ajo nuk shtyn ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje (neni 8.3).

⁴⁸ Institucioni i Ombudspersonit, Raport, 2006

⁴⁹ Intervistë e RrGGK, korrik-gusht 2009.

⁵⁰ Intervistë e RrGGK me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, korrik-gusht 2009.

të vështirë financiare,⁵¹ gjë që mund të ndikojë në zbatimin e urdhrave për mbrojtje. Përfaqësuesit e institucioneve kanë përshkruar raste të shumta si ky: “Ne kemi pasur një arrest shtëpiak ku kryesi është urdhëruar të qëndroj 300 metra larg nga viktimat. Në këtë gjendje ekonomike ku viktimat duhet të ri në shtëpi të njëjtë me të, nganjëherë kjo nuk është e mundur të zbatohet [Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje].”⁵²

Në përgjithësi, gjyqtarët dhe policët duket se hezitojnë të ndjekin procedurën e përmbarimit në rastet ku përfshihen konteste familjare (shih Kapitullin 4). Nga 563 urdhra për mbrojtje sa janë shqiptuar, sipas Policisë së Kosovës, janë raportuar 32 shkelje të urdhrave mbrojtës që nga viti 2003.⁵³ Intervistat me viktimat e dhunës në familje dhe institucione sugjerojnë se këto nuk janë të vetmet shkelje që kanë ndodhur.⁵⁴ Monitoruesit e EULEX-it dhe një zyrtar i Policisë së Kosovës u kanë thënë RrGGK-së se monitorimi i pamjaftueshëm i urdhrave për mbrojtje kryesisht i atribuohet gjykatave; ato shpesh kanë dështuar në informimin e policisë për shqiptimin e urdhrave mbrojtës, pavarësisht obligimit për ta bërë një gjë të tillë sipas Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje. Derisa policia duhet të përcjellë këto raste, mungesa e informatave të tilla themelore e bën këtë detyrë të vështirë. Përfaqësuesit e institucioneve tjera po ashtu kanë thënë se gjyqtarët kanë dështuar për t’i informuar ata menjëherë për vendimet e marra, që ka ndikuar në aftësinë e tyre për të ndihmuar viktimat.⁵⁵

Është përmendur nga shumë të intervistuar nevoja për të krijuar një sektor të posaçëm monitorimi për familjet ku urdhrat për mbrojtje janë aktive.⁵⁶ Sidoqoftë, problemi është më i madh se rastet e dhunës në familje. Mungesa e sundimit të ligjit në Kosovë përbën një problem sistematik. Vonesa në përmbarimin e aktgjykimave janë vërejtur nga një numër agjencish të cilat e monitorojnë sistemin gjyqësor.⁵⁷ Shumica e vendimeve të gjykatave civile kërkojnë vite për t’u zbatuar, nëse ndonjëherë zbatohen. Nevojitet një strategji gjithëpërfshirëse për të siguruar zbatimin e të gjitha vendimeve të gjykatave civile. Një strategji e tillë do të priorizonte rastet e dhunës në familje duke marrë parasysh çështjet e ndjeshme të mirëqenies së fëmijës si dhe rëndësinë domethënëse që këto raste kanë për shoqërinë sa i përket arsimit, ekonomisë dhe BPV-së.⁵⁸

Për më tepër⁵⁹, gjykatat rrallë kanë intervenuar kur janë shkelur urdhrat për mbrojtje ose kur nuk është paguar alimentacioni.⁶⁰ Zyrtarët për ndihmë juridike kanë raportuar vonesa në

⁵¹ Hulumtimi i RrGGK në mbarë Kosovën në vitin 2008ka gjetur lidhje në mes të personave të cilët kanë përjetuar dhunë dhe të ardhura të ulëta (*Siguria nis në shtëpi*, f. 36). Në të njëjtën kohë, duhet theksuar se dhuna në familje po ashtu ekziston në familjes me gjendje të mirë dhe se ajo ishte një çështje e cila ndikon familjet me gjendje të ndryshme socio-ekonomike, etnike, moshë, gjini, aftësi, etj.

⁵² Intervistë e RrGGK me një prokurorë, gusht 2009.

⁵³ Nga Policia e Kosovës, Sektori kundër dhunës në familje dhe Drejtoria për krime të rënda, 31 gusht 2009.

⁵⁴ Të intervistuar të shumtë kanë thënë se institucionet po dështojnë në monitorimin e zbatimit të UM-ve (Intervista të RrGGK, korrik-gusht 2009).

⁵⁵ Seminari për qasje në drejtësi për viktimat e dhunës në familje, Grupi punues për ruajtjen e të drejtave të viktimave dhe qasje në drejtësi, 22 shtator 2009, Prishtinë

⁵⁶ Intervista të RrGGK me avokat, gjyqtarë dhe prokurorë, korrik-gusht 2009.

⁵⁷ Shih Raportin e Progresit për Kosovën të Komisionit Evropian (2007 dhe 2008) mbi shtyrjet në zbatimin e vendimeve të gjykatave.

⁵⁸ Shih hyrjen.

⁵⁹ Intervistë e RrGGK me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, korrik-gusht 2009

⁶⁰ Ibid.

rishikimin e rasteve të alimentacionit, përkundër faktit se këto raporte duhet adresuar me urgjencë⁶¹ (Ligji mbi Procedurën Përmbartimore, Kapitulli 23).⁶² Në një rast, kanë kaluar tre vite prej kur gjykata ka urdhëruar pagesën e alimentacionit dhe vendimi akoma nuk është zbatuar. “As policia e askush nga institucionet nuk kanë ndërmarrë hapa për të ndihmuar viktimat që të marrin alimentacionin,”⁶³ ka komentuar një përfaqësues i vendstrehimit.

Përderisa dështimi për të paguar nganjëherë mund t’i atribuohet mungesës së mjeteve financiare⁶⁴ nga ana e kryesit, shmangja nga obligimet ligjore po ashtu ka qenë e shpeshtë. Një përfaqësues i vendstrehimit ka thënë se disa të pandehur kanë gënjyer për kontratat e tyre të punësimit ose i kanë mbajtur kontratat jozyrtare për të penguar pagesën e alimentacionit. Të intervistuar tjerë kanë raportuar se kryesit kanë ndryshuar vazhdimisht llogaritë bankare dhe/ose bankat kanë dështuar të ofrojnë informata nëse kryesit kanë fonde të mjaftueshme për të bërë pagesat. “Ata [krysit] kanë mjaftë hapësirë ligjore për të transferuar pagat e tyre nga një llogari [bankare] tek një tjetër,” ka komentuar një gjyqtarë. Sidoqoftë, kjo ilustron njohjen e dobët të ligjit. Ligji mbi Procedurën Përmbartimore të Kosovës përcakton se urdhrat për mbrojtje të shqiptuara nga gjyqtarët i obligojnë bankat të dërgojnë një njoftim mbi të gjitha ndryshimet në llogarinë personale siç parashihet me vendimin e ekzekutueshëm.⁶⁵ Njoftimi duhet të përfshijë informata për 30 ditë para dorëzimit të vendimit për ekzekutim dhe informata për çdo transaksion në llogarinë personale, përfshirë tërheqje të parave të gatshme ose transfertë parash brenda bankës ose ndërmjet bankave.⁶⁶ Hetimi i pamjaftueshëm i gjendjes financiare të kryesit nga ana e gjyqtarëve, u lejon atyre të shmangin përgjegjësitë e tyre.⁶⁷

“Krysi është i punësuar dhe ka paraqitur dokumente false në gjykatë për të mos marrë përsipër përgjegjësinë për alimentacion. Prokuratorët kanë pranuar këto dokumente false si relevante për rastin.” – Grua shqiptare, moshë 26-36

Në përfundim, pengesat kryesore në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në pajtim me ligjin e zbatueshëm, domethënë Rregulloren për mbrojtjen kundër dhunës në familje, përfshijnë: vonesat në shqiptimin e urdhrave për mbrojtje; kufizimet në llojet e masave të shqiptuara nga gjyqtarët; arsyetimin e varfër të aktgjykimeve, përcjelljen e pamjaftueshme nga policia dhe gjyqtarët të zbatimit të urdhrave për mbrojtje; dënime të buta kur shkelen urdhrat për mbrojtje; dhe burgosje të rralla të kryesve për shkelje të urdhrave për mbrojtje, edhe në rastet e recidivizmit. Këto të gjetura konfirmojnë observimet e bëra nga organizata të ndryshme që monitorojnë dhe raportojnë për sistemin gjyqësor në Kosovë; sistemi gjyqësor rrallë ofron mbrojtje efektive për viktimat e dhunës së bazuar në aspektin gjinor për shkak se dështon të përmbushë më mënyrë ekspeditive garancitë themelore procedurale të përcaktuara me ligjin e zbatueshëm.⁶⁸

⁶¹ Intervistë e RrGGK, korrik 2009.

⁶² Ligji mbi Procedurën Përmbartimore i Kuvendit të Kosovës, Nr. 03/L-008, miratuar me 2 qershor 2008

⁶³ Intervistë e RrGGK me përfaqësues të vendstrehimit, korrik 2009.

⁶⁴ Intervistë e RrGGK me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, korrik-gusht 2009

⁶⁵ Ligji mbi Procedurën Përmbartimore i Kuvendit të Kosovës Nr. 03/L-008, miratuar me 2 qershor 2008.

⁶⁶ Neni 145.1 i Ligjit mbi Procedurën Përmbartimore.

⁶⁷ Intervista të RrGGK me gjyqtarë, përfaqësues të vendstrehimit, deh avokat, korrik-gusht 2009.

⁶⁸ RrGGK, *Siguria nis në shtëpi*. Shih po ashtu, Misioni i OSBE në Kosovë, “Raport vlerësues mbi krijimin e mekanizmeve referues për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore,” 2007; Misioni i OSBE në Kosovë “Raport mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë,” 2007; dhe raporti i lartpërmendur i Institucionit të Ombudspersonit.

më shumë se vetëm
**'Fjalë
në LETËR'?**

KAPITULLI 3. NDJEKJA E VEPRAVE PENALE TË DHUNËS NË FAMILJE

KAPITULLI 3. NDJEKJA E VEPRAVE PENALE TË DHUNËS NË FAMILJE

Është raportuar më parë se viktimat e dhunës gjinore, dhe veçanërisht viktimat e dhunës familjare në Kosovë ballafaqohen me shumë sfida lidhur me ndjekjen efikase dhe dënimin e përshtatshëm për krysit në pajtim me ligjin e zbatueshëm.¹ Raportet e mëparshme nga agjenci të ndryshme kanë evidencuar dënime të buta të të pandehurve nga sistemi i drejtësisë sikurse dhe mungesë të kuptimit të ndjeshmërisë dhe nevojave të viktimave.² Për më tepër, gjatë trajtimit të viktimave të dhunës seksuale, trafikimit me qenie njerëzore, dhe dhunës në familje, prokurorët kanë trajtuar në mënyrë jo të përshtatshme dhe kanë treguar një mungesë të përgjithshme të ndjeshmërisë.³ Mënyrat se si strukturat gjyqësore kanë trajtuar viktimat, ka dekurajuar disa viktima nga kërkimi i drejtësisë.⁴ Ky kapitull shtjellon disa çështje aktuale brenda sistemit të drejtësisë që mund të parandalojnë qasje në drejtësi, e në veçanti në lidhje me veprat penale.

Struktura e prokuroriale

Ka 91 prokurorë në 13 zyra të prokurorisë në të gjithë Kosovën.⁵ Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës është e vendosur në Prishtinë, me zyra shtesë rajonale në pesë rajonet e Kosovës dhe shtatë zyra të prokurorive komunale.⁶ Pas një reforme përmbajtësore të legjislacionit penal me miratimin e Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) në prill në vitin 2003, prokurorët vendorë dhe ndërkombëtarë kanë punuar për së afërmi. Në vitin 2007, OSBE-ja ka vrojtuar se funksionet e reja kanë rënduar strukturën prokuroriale në kohën kur ajo ka qenë edhe ashtu e rënduar me personel dhe kapacitete të kufizuara si pasojë e angazhimit të rritje në hetime sikurse dhe mbikëqyrjen e punës së policisë gjatë fazës hetimore dhe procedurave para gjykimit.⁷

Pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008, është vendosur Misioni i ri i Sundimit të Ligjit i Bashkimit Evropian (EULEX), duke i transferuar disa kompetenca të mbetura nga gjyqtarët dhe prokurorët e UNMIK-ut tek personeli EULEX-it. Është miratuar ligji i ri mbi juridiksionin, zgjedhjen e rasteve, dhe caktimin e rasteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it (Ligji Nr. 03/L-053) i cili vendosë rregullat e angazhimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it. Ligji i ri parasheh se gjyqtarët e EULEX-it mund të intervenojnë në një rast të ri ose të pazgjidhur pronësor, përfshirë procedurat përmbarimore, veç funksionit të

¹ Shih Misioni i OSBE në Kosovë, “Raport vlerësues mbi krijimin e mekanizmave referues për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore,” kapitulli. 3. Po ashtu RrGGK, *Siguria nis në shtëpi*, 2008.

² Ibid.

³ Ibid.

⁴ Intervista të RrGGK me viktima, gusht 2009.

⁵ Halide Sadiku, për KIJAC. *Pjesëmarrja e ulët e grave në sistemin e drejtësisë së Kosovës*. Mars 2009, i disponueshëm në: <http://www.kijacnews.net/vnews/display.v/ART/2009/03/19/49c11b3027ee0>, i qasur në shtator 2009.

⁶ Misioni i OSBE në Kosovë, “Raport vlerësues mbi krijimin e mekanizmave referues për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore,”

⁷ Ibid.

tyre kryesor për monitorim, mentorim, dhe këshillim. Për më tepër, gjyqtarët e EULEX-it kanë autoritetin të kërkojnë me shkrim informata mbi statusin e çdo rasti civil aktual ose të kryer i cili bie mbi juridiksionin ose kompetencën e ndonjë gjykate në Kosovë. Kjo strukturë është vendosur për të rritur efikasitetin e gjykatave të Kosovës për të ndjekur dhe vendosur në veprat penale më të rënda duke ngritur kapacitetet e gjyqësisë kosovare për të reaguar ndaj veprave të tilla penale në një formë të pavarur, paanshme dhe efikase.⁸

Gjinia nuk përmendet, dhe në mandatin fillestar të EULEX-it rastet e dhunës në familje nuk janë konsideruar si prioritet.⁹ “Dhuna në familje si e tillë nuk mbulohet me mandatin e prokurorëve të EULEX-it,” i ka shpjeguar RrGGK-së zyra e prokurorisë së EULEX-it. “Një prokurorë i EULEX-it do të kishte fuqi ekzekutive në rast të dhunës në familje vetëm nëse kjo çon në vrasje.”¹⁰ Ajo ka shtuar se problemi i zakonshëm lidhur me mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të viktimave “nuk do të shfaqej” në këto raste. Përfaqësues nga komponenti i drejtësisë së EULEX-it nuk ka raportuar për ndonjë përfshirje të EULEX-it në rastet e dhunës në familje.¹¹ Përgjithësisht, përqendrimi më i gjerë i misionit të EULEX-it në krimet e kryera mbi baza etnike dhe krimin e organizuar duket se ka vënë në hije krimet me bazë gjinore. Megjithatë, përgjegjësia primare në ndjekjen dhe vendosjen për rastet e dhunës në familje mbetet tek gjyqtarët dhe prokurorët kosovar.

Ndjekja e krimeve të lëndimeve të lehta trupore

Në pajtim me Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje dhe kodin e ri penal, vepra penale e lëndimit të lehtë trupor duhet ndjekur sipas detyrës zyrtare (*ex officio*).¹²

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, SMSL-ja e Misionit të OSBE-së në Kosovë ka monitoruar disa raste kur krysit për veprës së lëndimit të lehtë trupor të dhunës në familje nuk është ballafaquar me ndjekje.¹³ Edhe pas një përgjigje të shpejtë të policisë në hetimin dhe mbledhjen e dëshmive, prokuroria ka dështuar të ndërmerret hetime shtesë dhe të ndjekë krysin kur vepra penale e lëndimit të lehtë trupor është shkaktuar në lidhje familjare. Për shembull, në dy raste të raportuara nga SMSL-ja në Pejë dhe Gjilan, policia i ka ofruar prokurorisë dosjet lidhur me rastet e dhunës në familje ku lëndimet fizike ishin të dukshme. Edhe pse dëshmitë kanë qenë në dispozicion, prokurori publik nuk ka mundur të gjejë dosjet në regjistrat e tyre.¹⁴ Vënia gabim e dosjeve tregon apatinë në mesin e

⁸ Neni 5.6 i Ligjit për juridiksionin, përzgjedhjen e rasteve dhe ndarjen e rasteve të gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Ligji nr. 03/L-053.

⁹ Intervista të RrGGK me përfaqësues të EULEX-it, gusht 2009.

¹⁰ Komunikim me email me RrGGK, 4 shtator 2009.

¹¹ Në vitin 2009, EULEX-i kishte themeluar grupin punues për t'u marrë me çështjet e politikave lidhur me dhunën në familje dhe trafikimin, por ka qenë akoma në fazën fillestare në kohën e këtij hulumtimi. Sidoqoftë, Zyra për të drejta të njeriut dhe barazi gjinore e EULEX-it ka qenë e përfshirë në komentimin e draft ligjit për mbrojtje kundër dhunës në familje. Komponenti i policisë i EULEX-it po ashtu ka monitoruar punën e policisë në disa raste të cilat kanë qenë të ndërlidhura me dhunën në familje.

¹² Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje në mënyrë eksplicite përcakton në nenin 16(2) se krimi i lëndimit të lehtë trupor duhet të ndiqet penalisht sipas detyrës zyrtare dhe se nuk është e nevojshme që viktimat të kërkojnë apo pajtohet me akuzën penale. Më tej sipas KPPK-së, nenit 153, nuk nevojitet shkresë nga pala e lënduar

¹³ Misioni i OSBE në Kosovë, “Raport mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë.”

¹⁴ Ibid dhe RrGGK, *Siguria nis në shtëpi*.

disa prokurorëve për hetime të mëtutjeshme të rasteve të lëndimeve të lehta trupore në lidhje familjare.

Monitorimet përcjellëse të rasteve të dhunës në familje kanë treguar se akoma ekzistojnë probleme.¹⁵ RrGGK-ja po ashtu ka analizuar disa aktgjykime civile të nxjerra nga Gjykata Komunale në Pejë, e cila ka lëshuar UM duke treguar veprën penale të lëndimit të lehtë trupor të evidencuar me raporte mjekësore. Aktgjykimet po ashtu kanë përfshirë njoftimin për prokurorin publik. Sidoqoftë, duket se nuk ka pasur asnjë ndjekje të këtyre rasteve pasi që lëshim i UM-ve zakonisht shihet si një zëvendësim i ndjekjes.¹⁶ Në përgjithësi, duket se procedurat civile shpesh zëvendësojnë ato penale. Për shembull, një grua shqiptare përkujtoi, “shkova në polici për të raportuar dhunën dhe ata më fotografuan trupin ku mund të shihje pasojat e dhunës... akuza ka qenë prishja e martesës.”¹⁷ Pavarësisht dëshmime mjekësore për lëndime trupore, është konsideruar se një rast civil i shkurorëzimit është zgjidhje e mjaftueshme kështu që nuk ka pasur ndjekje penale.

Dështimi për të ndjekur veprat penale duket se rrjedh nga mungesa e njohurive në mesin e prokurorëve në lidhje me Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje dhe kërkesat e saj.¹⁸ Shumë përfaqësues institucionesh mendojnë se dhuna në familje ka të bëjë vetëm me Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje, pa marrë parasysh nëse veprat penale janë të përfshira.¹⁹ Për shembull, një prokurorë i ka thënë RrGGK-së “mungesa e ndjekjes efikase për veprat penale të dhunës në familje është si rezultat i ... mungesës së ligjit.”²⁰ Ka qenë një mendim i zakonshëm se aktet e dhunës në familje duhet të përfshihen në KPK, e jo vetëm në rregulloren ekzistuese.

Për më tepër, prokurorët duket se shohin një ndarje strikte në mes të kërkesave civile dhe penale lidhur me aktet e dhunës në familje dhe përgjigjes së duhur për ndjekjen e secilës prej tyre. Siç ceket në Kapitullin 1, aktet e definuara në Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje ballafaqohen me veprat penale të listuar në Kodin Penal të Kosovës, sikurse janë krimet me lëndime trupore, dëmtim të pasurisë, kidnapim i paligjshëm i fëmijës, kërcënim, ose shtrëngim. Kjo gjendje e ndërlikuar me dispozita ligjore të cilat mbulojnë vepra të njëjta brenda procedurave civile dhe penale, dhe mungesa e definimit të dhunës në familje në KPK, është vërtetuar nga ana e prokurorëve si problematike.²¹ Ata kanë rekomanduar përfshirjen e një kapitulli të veçantë për dhunën në familje si një ndryshim i KPK-së.

Megjithatë, kërkesat janë të qarta edhe me dispozitat aktuale në ligj; procedura civile për lëshimin e UM-së *nuk duhet* të konsiderohet si zëvendësim për nisjen e procedurës penale. Pasojat e dështimit për të ndjekur krimet mund të jetë e rëndë për familjen sikurse dhe shoqërinë. Një punëtor social ka përshtuar një rast:

¹⁵ Intervistë e RrGGK me personelin e SMSL, shtator 2009.

¹⁶ Supra Note në 13.

¹⁷ Intervistë e RrGGK me një grua shqiptare, moshë 26-35, gusht 2009

¹⁸ Gjatë intervistës me RrGGK, disa prokurorë publik të nivelit të qarkut nuk kanë ditur për ekzistencën e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje dhe kanë potencuar nevojën për një ligj për mbrojtje të viktimave.

¹⁹ Intervista të RrGGK, korrik-gusht 2009.

²⁰ Intervistë e RrGGK me prokuror të qarkut, gusht 2009.

²¹ Intervista të RrGGK me prokurorë, sikurse dhe kryetar të gjykatave dhe gjyqtarë, korrik-gusht 2009.

[P]policia ka zbuluar rastin: nëna nuk ka qenë duke jetuar me fëmijët e saj për gati një muaj; ajo ishte duke jetuar me familjen e saj. Ajo dukej shumë keq në çastin pas përjetimit të dhunës. Që nga ajo kohë, fëmijët kanë jetuar me krysin. Në kemi biseduar me nënën, dhe ajo nuk ka mundur të kujdeset për ta, kështu që i kanë lëna ata të jetojnë me krysin. Ne kemi paraparë se dhuna mund të ndodhë kundër fëmijëve, porse kemi menduar që për shkak të urdhëresës për mbrojtje ai nuk do të përdorte dhunë ndaj fëmijëve. Gjykata *vetëm ka lëshuar urdhëresë për mbrojtje; ata nuk kanë urdhëruar burgosje të krysit*. Fëmijët kanë jetuar me gjyshen e tyre në hapësirë të njëjtë banimi. Dje policia e ka dërguar atë në paraburgim prej 48 orëve. Pastaj e kanë dërguar tek psikiatri. Fëmijët akoma nuk janë regjistruar dhe nuk kanë dokumente. Krysi ka qenë anëtar i Policisë së Kosovës derisa ka përdorur dhunë ndaj gruas së tij dhe që nga atëherë ai është suspenduar. Tani fëmijët janë në vendstrehim me nënën e tyre.²²

Në këso rastesh të neglizhimit dhe abuzimit, përfshirë dhe të fëmijëve, lëshimi i një UM nuk duhet shikuar si e vetmja masë për mbrojtje të viktimave. Nëse ka dëshmi të qarta për vepra penale të kryera në lidhje familjare ndërmjet çiftit dhe kundër fëmijëve, ndjekja duhet të reagoj në pajtim me kërkesat e ligjit në fuqi.

Përfundimi i ndjekjes

Raportet e mëparshme kanë treguar se ka një ngurrim të përgjithshëm të prokurorëve për të ndjekur veprat penale të cilat ndodhin në lidhje familjare, nëse viktimat tërhiqet nga procesi për shkak të “pajtimin” në mes të çiftit, ose nëse viktimat nguron të vazhdoj për shkak të presionit nga familja ose krysi.²³ Intervistat e RrGGK-së me institucione dhe viktimat të dhunës në familje tregojnë se kjo praktikë akoma vazhdon.²⁴ Një qëndrim i bërë nga një avokat shërben si ilustrim:

Duhet të rregullohet me ligj që viktimat po ashtu ka të drejtën e tij/saj për të mos pranuar akuzimet e bëra kundër krysit ... edhe në rastet e [ndjekjes] *ex officio* për shkak se nganjëherë viktimat ia fal krysit, çifti pajtohet, dhe nuk është e mundshme për ta të ndalin procesin gjyqësor. Nëse viktimat ia fal atij, nuk ka arsye [që ai] të dënohet më. Lidhja e tyre duhet konsideruar si lidhje intime dhe ne nuk duhet t'i shqetësojmë ata më, nëse ata janë pajtuar.²⁵

Një prokuror tjetër ishte i mendimit se ligjet penale ishin tepër të rrepta dhe se duhet të mundësojnë ndërprerjen e ndjekjes penale, siç mund të jetë rasti me dhunën e cila ndodh “aksidentalisht”.²⁶ Sidoqoftë, legjislacioni penal i Kosovës (KPPK) *nuk i njeh* prokurorit

²² Intervistë e RrGGK, gusht 2009.

²³ Shih RrGGK, *Siguria nis në shtëpi* dhe Misioni i OSBE në Kosovë, “Raport mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë.” Tutje, zyrtarët e intervistuar të policisë nga SMSL, kanë sugjeruar se njëra prej arsyeve për dështim të ndjekjes, është se palët pajtohen dhe nuk ka akuza nga prokurori për shkak të tërheqjes së viktimës.

²⁴ Intervista të RrGGK me më shumë se 20 përfaqësues të institucioneve, korrik-gusht 2009.

²⁵ Intervistë e RrGGK me një avokat, gusht 2009.

²⁶ Intervistë e RrGGK me prokurorin publik. KPPK i lejon prokurorit të hedh poshtë kallëzimin penal apo të ndërpresë hetimet vetëm nëse janë manifestuar kushte specifike ligjore (shih nenet 208 dhe 224)

opsionin e pushimit të ndjekjes penale ose pezullimin e hetimit të ndjekjes së krimit, përfshirë lëndimin e lehtë trupor, përkundër kërkesës së viktimës. Krimi i lëndimit të lehtë trupor, nëse kryhet në lidhje familjare, është i dënueshëm nga gjashtë deri në tre vite burg dhe sipas Rregullores për mbrojtje kundër dhunës familjare, e cila nuk është zëvendësuar nga KPK-ja e re duhet të ndjeket *ex officio*. Për më tepër, sipas nenit 226, paragrafi 5, pezullimi, pushimi ose heqja dorë nga ndjekja për vepra më të lehta penale nuk lejohet për rastet e dhunës në familje dhe dhunës seksuale. Shkurt, as viktima dhe as prokurorët nuk kanë të drejtë të vendosin për t’u tërhequr nga ndjekja nëse ka indikacione të qarta se kanë ndodhur krime sikurse lëndime të lehta ose të rënda trupore.

Edhe me këtë, shumë prokurorë kanë pranuar haptas se nuk e ndjekin ligjin. “[N]uk ka shumë çfarë ne mund të bëjmë nëse viktima tërhiqet dhe kërkon që të mos vazhdojmë ndjekjen,” i ka thënë RrGGK-së një prokuror. “Viktimat ndryshojnë mendimin e tyre rreth kërkimit të dënimit të krysit” dhe kërkojnë që të ndalet procedura, ka thënë një prokuror tjetër. Në disa raste, viktimat janë pajtuar me krysin dhe kanë refuzuar të flasin. Dëshmitë e papërshtatshme, mbajtja e dëshmimeve sikurse kontrollet mjekësore, dhe mohimi i dëshmimeve i bëjnë hetimet dhe ndjekjen të vështira, kanë thënë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë.²⁷ Një prokuror ka thënë, “[P]asi që çifti pajtohet, të gjitha institucionet relevante janë të heshtura; ato më nuk janë aktive. [N]ganjëherë ka vështirësi në marrjen e dëshmimeve nga anëtarët e familjeve, dhe kjo e bën këtë gjendje të vështirë; ata kanë të drejtë të mos flasin.”

“Shumë shpesh ne jemi nën presion nga viktima për të pezulluar akuzat, edhe kur është ex officio dhe nuk mund të ndalim procesin.”
 - Prokurorë

Sikurse në rastet civile të shtjelluara më parë, pajtimi shpesh konsiderohet si më i preferueshëm për ndjekjen e krimeve, përkundër kërkesave ligjore. Për shembull, një prokurorë ka thënë:

Kam pasur një rast kur urdhëresa për mbrojtje emergjente është shkelur nga krysi. Banesa ka pasur vetëm një dhomë, e cila është dashtë të shfrytëzohet nga të dytë, krysi dhe viktima. Unë kam biseduar me ta, u kam ofruar shërbime psikologjike. [Nuk] parashihet [në ligjet ekzistuese] që psikologu të shkoj atje para raportimit të ankesës për recidivizëm në gjykatë. [N]ganjëherë nuk është e nevojshme të vihet aty [në gjykatë] sepse nganjëherë ata pajtohen në çastin kur vijnë të flasin me ne.²⁸

Siç u cek më herët, nëse viktima dhe krysi pajtohen, kjo është nuk është e rëndësishme sipas KPK-së; shkeljet e UM-ve dhe lëndimet trupore *duhet ndjekur ex officio*. Ndoshta konfuzioni në mesin e disa përfaqësuesve të institucioneve mund t’i vishen nenit 59 mbi prishjen e martesës të ligjit mbi Familjen, i cili thotë se “institucioni i martesës duhet të ruhet” dhe se “bashkëshortet në martesë të cilët janë të thyer, duhet të inkurajohen që të ndërmarrin të gjitha hapat praktik, përmes këshillimit martesor, procedurave të

²⁷ Intervistë e RrGGK me më shumë se 10 përfaqësues të sistemit të drejtësisë, korrik-gusht 2009.

²⁸ Intervistë e RrGGK me një prokuror, gusht 2009.

pajtimin të parapara me këtë ligj ose ndryshe. Për të shpëtuar martesën.” Duket se ligji mbi Familjen mund të zëvendësojë KPK-në për shkak të mendimit të përhapur gjerësisht se në mesin e përfaqësuesve të institucioneve se vartësia ekonomike e grave prej të pandehurve e bën pajtimin të vetmen zgjidhje të zbatueshme.²⁹ Një përfaqësues i vendstrehimit ka thënë:

Ka shumë raste kur gjyqtarët i thonë viktimës, “Ku donë të shkosh? Ti varesh nga të hyrat e krysit. Çfarë do të bësh me fëmijët? Nuk ke objekt banimi. A dëshiron ta dërgosh burrin në burg?” Kjo [deklarata e gjyqtarit] ka ndikim në viktima sepse ato zakonisht komunikojnë me njëra tjetrën rreth përvojave të tyre në gjykatë. [E] ndikon vendimin e tyre për të mos raportuar [dhunën] në gjykatë.³⁰

Institucionet duket se i inkurajojnë viktimat të ndjekin procedura civile dhe të marrin pjesë në këshillimin e parë të kërkuar për pajtim. Veprat penale minimizohen dhe shpesh injorohen. Ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme në intervistat e RrGGK me viktimat e dhunës në familje lidhur me këtë çështje. Derisa 54 viktima kanë raportuar se kanë përjetuar një krim siç definohet në KPK, vetëm shtatë raste janë dërguar për gjykim, përderisa 28 raste kanë shkuar në gjykatën civile, kryesisht për shkak të procedurave lidhur me “prishje të martesës” (19) dhe urdhrave për mbrojtje (13).

Si përfundim, ndjekja duket se tërhiqet shpejtë nga hetimi i mëtejshëm i rasteve dhe nga ndjekja e krysit. Sidoqoftë, ligjet penale janë të qarta në kërkesën për zhvillimin e procedurave penale, duke iu pamundësuar prokurorëve ndërprerjen e rasteve sipas vendimit të tyre, në këtë mënyrë duke kërkuar respektim të standardeve për të drejtat e njeriut. Në pajtim me kornizën ekzistuese ligjore, veprat penale të cilat shfaqen në lidhje familjare nuk duhet të tolerohen dhe të gjitha aktet duhet të hetohen dhe ndiqen në formën e duhur. Ndjekja në mënyrë automatike duhet të shërbejë si “qasje frontale” për të dhënë një mesazh të qartë se dhuna në familje nuk tolerohet nga shoqëria dhe se shoqëria dhe se duhet të kërkojë ndaljen e saj.³¹

Dënime të lehta për krysit e veprave penale të dhunës në familje

Ligjet penale të Kosovës kërkojnë dënime të ashpra për krimet që ndodhin në lidhje familjare krahasuar me krime të ngjashme që ndodhin në mes të personave që nuk janë në lidhje familjare. Për të treguar se nuk duhet të ketë tolerancë për dhunë në lidhjet familjare, KPK-ja parasheh gati dyfishin e dënimeve në krahasim me dënimet për aktet e ngjashme të parapara për vepra të ngjashme të kryera kundër personave që nuk janë në lidhje familjare. Për shembull, neni 153.1 i KPK-së parasheh që krimi i lëndimit të lehtë trupor duhet të dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit. Kur krimi kryhet në lidhje

²⁹ Intervista të RrGGK me përfaqësues të institucioneve, korrik-gusht, po ashtu shih kapitullin 2.

³⁰ Intervistë e RrGGK me një përfaqësues të vendstrehimit, gusht 2009.

³¹ Shih “Report mbi dhunën në familje dhe qasja në gjykata: Përgjigje e OJQ-ve ndaj raportit periodik të Shteteve të Bashkuara për Komitetin e KB-ve mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor,” i disponueshëm në: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cerd/docs/ngos/usa/USHRN25.doc>.

familjare, masa e burgimit mund të rritet deri në tre vite. Për vepër të lëndimit të rëndë trupor, dënimi i paraparë është një deri në dhjetë vite, dhe nëse vepra kryhet në lidhje familjare, krysi mund të dënohet nga dy deri në pesëmbëdhjetë vite burgim.³²

Në vitin 2007, OSBE-ja ka raportuar se gjatë monitorimit të dhunës gjinore se ka pasur një mungesë të përgjithshme të përvojës prokuroriale ose kuptimit të krimeve të tilla, dhe pozitës së viktimave në këto situata.³³ Ndjekja zakonisht i ka keq klasifikuar krimet ose ka dështuar të paraqes akuza të përshtatshme për krimet e bëra, që kanë çuar në dënime të buta për këto krime. Ngjashëm, nga disa raste të lëndimit të lehtë trupor të raportuara RrGGK-së nga gjyqtarët, prokurorët dhe mbrojtësit e viktimave pjesa më e madhe e kryesve janë dënuar me kusht apo gjobitur me nga 200 euro. Pak kryes janë burgosur, por kjo zakonisht për tre muaj apo më pak. Vetëm në dy raste të raportuara RrGGK-së ata janë burgosur për tre deri në shtatë vite.³⁴

Në rastet e vrojtuar të dhunës në familje nga RrGGK-ja, disa prokurorë dhe gjyqtarë kanë nguruar që të ndjekin ose sjellin aktgjykime në pajtim me KPK-në ekzistues. Si rezultat, dënimet shpesh kanë qenë nën minimum se ato që janë të parapara me ligjin e zbatueshëm. Ka “paragjykime institucionale ndaj rasteve të dhunës në familje, posaçërisht ndaj grave,” ka theksuar një përfaqësues i vendstrehimit. “[P]ër herë të parë, këtë vit ka pasur një rast të dënuar me tetë vite burg. Të gjitha rastet tjera janë dënuar me gjashtë muaj ose asgjë.”³⁵ Edhe pse ligji parasheh dënim deri në 15 vite burg, në më shumë se dhjetëra raste të lëndimeve të rënda trupore të raportuara tek RrGGK nga institucione dhe viktimat të dhunës në familje, vetëm një i pandehur është dënuar me më shumë se një vit burgim. Dy janë dënuar me kusht, përderisa katër të tjerë janë liruar pas një paraburgimi të shkurtë nga policia dhe nuk janë ndjekur tutje.³⁶ Gjyqtari i procedurës penale ka shpjeguar arsyetimin e tij për dënime të lehta:

Kam pasur një rast të një çifti i cili është pajtuar para meje në gjykatë ... pesë ose gjashtë vite më parë, por ata kanë ardhur prapë. Gruaja ka vuajtur dhunë fizike dhe burri i saj [dhe ajo] mu kanë lutur që të mos e burgos atë. Kam pyetur nëse ajo dëshiron të vazhdoj të jetoj me të, , [dhe] ajo ka thënë, “Po, unë varem nga të ardhurat e ofruara nga ai dhe babai i tij ... unë nuk kam ku të shkoj. I kam katër fëmijë.” Nuk kam mundur ta dënoj atë me arrest shtëpiak sepse ai duhet të shkoj të punoj; ata kanë katër fëmijë. Kështu që kam vendosur ta dënoj me kusht. Nëse e përsërit këtë [dhunë] prapë, ai do të dënohet më shumë. Herën tjetër, edhe nëse ajo kërkon q ai të mos burgoset, ne do ta bëjmë këtë *ex officio*. Ne do të ndjekim rastin ... edhe nëse ajo refuzon që ai të arrestohet, ai do të thirret në seancë dhe do të gjykohet.³⁷

³² Neni 153.1 i Kodit Penal të Kosovës.

³³ Shih OSBE, “Raport vlerësimi i vendosjes së mekanizmave referues për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore,” 2007, kapitulli. 3. Po ashtu RrGGK, *Siguria nis në shtëpi*, 2008.

³⁴ Intervistë e RrGGK-së me viktimat e dhunës në familje, gusht 2009

³⁵ Intervistë e RrGGK me një përfaqësues të vendstrehimit, korrik 2009.

³⁶ Intervista të RrGGK me viktimat të dhunës në familje dhe përfaqësues të institucioneve, korrik-gusht 2009.

³⁷ Intervistë e RrGGK me gjyqtarë, gusht 2009.

Prapë, duke marrë parasysh se ka qenë recidivist njëherë, në pajtim me ligjin, gjyqtari duhet të jep një dënim më të rëndë. Megjithatë, gjatë intervistave, prokurorët dhe gjyqtarët kanë përshkruar raste të ngjashme kur janë dhënë kushte kundrejt burgimit ose gjobës “sepse çifti është pajtuar për të ndrequr lidhjen e tyre.”³⁸ Kjo qasje mund t’i atribuohet tendencave për të preferuar pajtimin për çifte, shqetësimet për mungesën e opsioneve për viktimat, dhe/ose ngurrimin për të kuptuar madhësinë e krimit të kryer për shkak të “natyrës së tij private”. Sidoqoftë përderisa neni 228 i KPPK-së parashikon zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimit, ai përcakton që kjo të bëhet nga ana e një ndërmjetësuesi të pavarur dhe jo prokurori publik ose gjyqtari. Rastet e lartpërmendura janë në shkëlqje të drejtpërdrejtë e së drejtës së viktimës në mjete ligjore efikase dhe e drejtësisë për krimet e kryera kundër tyre.

Në përmbledhje regjistrat e rasteve nga viti 2005 deri 2009 të ofruara RrGGK nga një gjyqtar penal, ilustron të gjitha çështjet e mësipërme sa i përket dënimit, pushimit të ndjekjes, dhe shtyrjeve të gjykimeve (shih tabelat e mëposhtme). Gati gjysma e 263 rasteve të tij, përfshirë 191 raste të lëndimeve trupore, dhe 48 raste të kërcënimit, janë të papërfunduara. 50 raste janë në vazhdim që nga viti 2005. Në mesin e 132 rasteve të kompletuara, shumica prej të pandehurve (88) janë gjobitur me 200 Euro. Të tjerëve u janë paraqitur kushte (37), vërejtje e gjykatës (3) dhe njërit i është caktuar trajtim psikiatrik. Vetëm dy të pandehur janë burgosur. Është interesante që gjyqtari ka pranuar haptas se palët “kanë ndalë procedurën” në dy raste, dhe në katër raste viktimat e ka falur krysin. Siç u shtjellua më lartë, kjo është shkëlqje e drejtpërdrejtë e ligjit të zbatueshëm.

Shembuj të gjykimeve dhe vendimeve nga gjyqtarë penalist në Gjykatën Komunale

Viti	Raste totali	Përfunduar	Papërfunduar (në vijim)	Akuza		
				Lëndim trupor	Kërcënim	Totali
2005	72	22	50	61	11	72
2006	73	53	13	60	13	73
2007	47	28	19	32	15	47
2008	47	28	19	38	9	47
2009	24	1	22			
Totali	263	132	123	191	48	239

Rezultatet e gjykimeve të përfunduara

Viti	Gjoha (€200)	Kusht	Burgosje	Trajtim psikiatrik	Vërejtje e gjykatës	Palët kanë ndaluar procedurën	Krysi është falur	Ri-gjykim	Totali
2005	11	6			2	1	2		22
2006	35	17	2		1	1	1	2	59
2007	21	6		1					28
2008	21	7							28
2009		1					1		2
	88	37	2	1	3	2	4	2	139

Burimi: Gjyqtar penalist, Gjykata Komunale, 2009

³⁸ Intervistë e RrGGK, korrik-gusht 2009.

Në përgjithësi, sikurse dhe në tabelën e paraqitur më lartë, sistemi kosovar i drejtësisë duket se po dështon në ndjekjen e të pandehurve të akuzuar për vepra të lëndimit të lehtë trupor në rastet kur krysi dhe viktimja janë në lidhje familjare. Gjykatat komunale duket se i shtyjnë këto raste pasi që ato kanë bartur një numër enorm të rasteve penale (2,036) nga viti 2007 në 2008. Për më tepër, në vitin 2008 ata kanë pasur edhe më shumë raste të pazgjidhura penale të lëndimeve të lehta trupore (2,174). Në vitin 2008, Gjykata komunale ka zgjedhur 621 raste, por 19.6 për qind janë zgjidhur përmes metodave që nuk janë të paraqitura qartë në bazën e të dhënave të mirëmbajtur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Policia e Kosovës po ashtu ka identifikuar disa raste të cilat kanë qenë “mbyllur pa bazë”.³⁹ Në vetëm 8 për qind të këtyre rasteve të dokumentuara nga KGjK-ja kryesit kanë përfunduar me burgim, ndërsa kohëzgjatja e dënimit nuk është specifikuar.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës – Përmbledhje e rezultateve të rasteve penale në vitin 2008

Neni		Krime kundër jetës dhe trupit (Nenet 146–157) / Lëndim i lehtë trupor (krysi dhe viktimja janë në lidhje familjare) - 153 para. 4		
Llojet e rasteve				
RASTET PENALE TË BARTURA NGA VITI 2007			2,036	
RASTET PENALE TË INICUARA NË VITIN 2008			759	
NUMRI I PËRGJITHSHËM I RASTEVE NË VITIN 2008			2,795	
621 raste të zgjidhura, në këto mënyra:	Aktgjykime	482 raste të zgjidhura me aktgjykime, përfshirë:	Burgim	52
			Dënim me gjobë	237
			Dënim me kusht	182
			Vendime tjera të gjykatës	10
		Të falur	5	
	Aktgjykime refuzuese	12		
Të zgjidhura përmes metodave tjera			122	
NUMRI I RASTEVE TË PAZGJIDHURA NË VITIN 2008			2,174	

Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Pasi që ligji është i qartë në lidhje me dënimet që duhet zbatuar në rastet e lëndimeve trupore në lidhjet familjare, është esenciale që gjykatat të zbatojnë ligjin në mënyrë korrekte. As ndërmjetësimi dhe as pushimi i rasteve nuk duhet përdorur nga gjykatat si metoda për zgjidhjen e rasteve penale. Më parë, përmes zbatimit të duhur të ligjit, gjykatat kanë mundësinë të ofrojnë një “rrugëdalje” dhe kushte më të mira për gra (dhe burra) në situata të dhunshme. Ndjekja e përshtatshme dhe dënimi, të kombinuara me masa shtesë të lëshuara nga gjykatat komunale, sikurse alimentacioni, të drejtat pronësore, dhe pagesa e qirasë nga krysi (shih Kapitullin 2), do të adresojnë tutje disa nga shqetësimet e shfaqura nga gjyqtarët sa i përket alternativave në dispozicion për gra pas qasjes në drejtësi.

³⁹ Policia e Kosovës, Statistikat e ofruara RrGGK-së për periudhën 2005-2007

më shumë se vetëm ‘Fjalë’ në LETËR’?

KAPITULLI 4. POLICIA E KOSOVËS: HETIMET, ARRESTIMET, MONITORIMI

KAPITULLI 4. POLICIA E KOSOVËS: HETIMET, ARRESTIMET, MONITORIMI

Nën ligjin e policisë, veprimet e Policisë së Kosovës duhet të udhëhiqen nga respektimi i të drejtave të njeriut, barazia dhe trajtimi i drejtë për të gjithë dhe njohja e parimeve të barazisë gjinore të përfshira në Kushtetutë.¹ Një numër i reformave institucionale dhe ligjore janë ndërmarrë për të qartësuar rolet e policisë në hetime dhe përgjigjen e tyre në raste të dhunës në familje. Në vitin 2004 UNMIK-u dhe autoritetet e Kosovës themeluan njësitë policore për mbrojtje kundër dhunës në familje (NjPDhF).² Çdo stacion kërkohej që të kishte dy oficerë të aftësuar për mbrojtje kundër dhunës në familje kujdestar për t’iu përgjigjur të gjitha rasteve të dhunës në familje 24 orë në ditë. Në stacionet e policisë ku NjPDhF u themeluan, raportimet e rasteve zakonisht trajtohen nga ato njësi. Në stacionet e policisë ku nuk ekziston NjPDhF, rasti i referohet Njësisë së policisë së komunitetit.³

Pas reformave të sistemit të drejtësisë penale dhe shpalljes së Kodit penal të Kosovës dhe Kodit të procedurës penale (KPK dhe KPPK), policia gjyqësore⁴ është mandatar për të mbështetur prokurorin publik në ndërmarrjen e veprimeve hetimore ose për të udhëhequr hetimet nën autorizimin e prokurorit publik.⁵ Sidoqoftë, njësitë e policisë gjyqësore me trajnime të mjaftueshme profesionale për të hetuar raste të ndryshme ende nuk janë themeluar. Kjo ka kontribuar në përmbyllje të shpeshtë të hetimeve të pasuksesshme.⁶

Sipas Rregullores kundër dhunës në familje 2003/12 një numër i roleve dhe përgjegjësiive janë përkufizuar në marrëdhënie me përgjigjen e policisë në rastet e dhunës në familje.⁷ Në mënyrë përkatëse policia duhet të përdorë të gjitha mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar dhunën e mëtejme.⁸ Rolet dhe përgjegjësitë e para para përfshinë por nuk kufizohen në:

- Informon viktimën ose përfaqësuesin ligjor të tij/saj për të drejtat për të kërkuar mbrojtje emergjente të përkohshme në pajtim me nenin 13 të Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje;

¹ Neni 2 i Ligjit për policinë i Kuvendit të Kosovës, Nr. 03/L-035.

² I themeluar nën buletin operativ të policisë së UNMIK-ut 0073 të datës 29 janar 2004.

³ Shih Ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë, “Përgjigjja ndaj incidenteve të dhunës në familje: doracak për oficerët e shërbimeve sociale” (2006). Çdo stacion policie fut të dhënat në bazën e të dhënave të policisë që është i lidhur në rrjet me të gjitha regjionet. Sektori për kundër dhunës në familje në kuadër të Drejtorisë për krime serioze ka krijuar një bazë të veçantë të të dhënave për rastet e dhunës në familje në vitin 2005, që ndoshta ka sistemin më të organizuar të mbledhjes së të dhënave që lidhen me dhunën në familje në Kosovë. Për më shumë informata shih RrGGK, *Siguria fillon në shtëpi*.

⁴ Nën nenin 151 të KPPK policia gjyqësore janë oficerë policie të autorizuar që të kryejnë hetimin dhe funksionet tjera hetuese nën mbikëqyrje të prokurorit publik, përveç funksioneve tjera policore.

⁵ Neni 51 i KPPK të Kosovës.

⁶ Shih Zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian, Raport i progresit për Kosovën, 2008, dhe raporti i UNDP-së për “Qasjen në drejtësi,” 2008.

⁷ Shih nenin 14 të rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje për “Përgjegjësitë e autoriteteve të zbatimit të ligjit.” Tutje, nën nenin 1.7 të rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje, autoritetet për zbatim të ligjit nënkupton Policinë civile të UNMIK-ut dhe Policia e Kosovës.

⁸ Ibid.

- Informon viktimën për shërbimet e asistencës juridike, psikologjike, sociale dhe asistencë tjetër në dispozicion nga institucionet qeveritare dhe OJQ-të që ofrojnë shërbime për viktimat;
- Informon ofruesit përkatës të shërbimeve për incidentet e dhunës në familje dhe lehtëson kontaktin në mes të ofruesve të shërbimit dhe viktimës, në bazë të kërkesës nga viktimat;
- Ofron ose aranzhon transportin për viktimën gjër te agjencia tjetër për trajtim ose ekzaminim mjekësor dhe transport të viktimës dhe të varurve të tij/saj në vendstrehim;
- Asiston viktimën për të larguar pronën thelbësore personale kur viktimat zgjedh që të largohet nga ekonomia familjare e përbashkët;
- Kur të lëshohet UM largon të rrezikuarin nga rezidenca e përkohshme ose e përhershme
- Ofron viktimës kontakt zyrtar të një oficeri hetues brenda policisë;
- Policia duhet të plotësojë raportin e incidentit nëse është kryer krimi ose nëse kryesi është arrestuar dhe siguron raportin e incidentit viktimës ose përfaqësuesit të saj ligjor;
- Kur viktimat është person nën 18 vjeçar/e policia menjëherë do të raportojë incidentin në Qendrën për Punës Sociale ku banon personi; dhe
- Kur ka baza për dyshim se është kryer krim që përfshinë dhunën në familje, policia rregullisht do t'i sigurojë viktimës azhurnim të gjendjes së hetimit;⁹

Sipas nenit 13 të Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje, Komandantët regional kujdestar ose ushtrues të detyrës kundër dhunës në familje të Policisë së UNMIK-ut janë të manduar që të lëshojnë Urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente (UMPE) jashtë orarit të punës së gjykatës. Me transferimin e kompetencave nga Policia e UNMIK-ut dhe në pajtim em një memorandum të brendshëm të policisë, Policia e Kosovës tani lëshon UMPE-të, në pajtim me ligjin. UMPE-të mund të kërkojnë nga personat e njëjtë të manduar për të kërkuar Urdhra për mbrojtje emergjente (UME), por duhet t'i dorëzohen autoriteteve për zbatim të ligjit (policisë). Nuk ka afat të specifikuar të fundit për Komandantin kujdestar i ushtruesi i detyrës për dhunën në familje që të lëshojë UMPE-në. Sidoqoftë masat mendohet të jenë zgjidhje të menjëhershme të përkohshme jashtë orarit të punës së gjykatave prandaj pritet vendim i menjëhershëm.¹⁰ Urdhri skadon në fillim të ditës së ardhshme që gjykata punon. QPS dhe përfaqësuesit tjerë të autorizuar të viktimës duhet të pajisen me një kopje të UMPE-së nga policia.¹¹

Informimi i viktimave për të drejtat e siguruara me ligjin e zbatueshëm

Në përgjithësi reagimi i policisë ndaj raporteve të rasteve për dhunën në familje ishte i shpejtë.¹² Policia deklaroi se aftësia e tyre për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje ishte përmirësuar dukshëm me miratimin e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje. Para ekzistimit të Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje, policia vetëm intervenonte për të qetësuar gjendjen dhe për të mundësuar zgjidhjen e brendshme të problemit. Procedura specifike e paraparë nën Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje është përkufizuar dhe ka qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e policisë duke i dhënë atyre më shumë

⁹ Ibid.

¹⁰ Pillay, Navanethem.

¹¹ Ky nen ka qenë problematik sepse Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje përmend vetëm policinë e UNMIK-ut do të thotë policia ndërkombëtare është mandatar për të lëshuar UMPE (*Siguria fillon në shtëpi*).

¹² RrGGK, *Siguria fillon në shtëpi*.

autoritet për të reaguar në rastet e raportimit të dhunës në familje.¹³ Në të vërtetë përfaqësuesit e institucioneve dhe të viktimave të dhunës në familje duken të kënaqur në përgjithësi me punën e policisë duke i përshkruar ata së “të ndjeshëm” dhe “profesionistë”.¹⁴

Kur policia vjen në kontakt me viktimat e dhunës në familje, ata janë të obliguar nga Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje që të njoftojnë viktimat për të drejtat e tyre që sigurohen nga Rregullorja, përfshirë të drejtën për të kërkuar lëshimin e UM-ve dhe informatat për shërbimet në dispozicion për asistencë të viktimave. Nga 47 viktimat e intervistuar të dhunës në familje nga RrGGK që kanë raportuar dhunën në familje, 21 thanë se policia i ka njoftuar ata për të drejtat, 18 janë njoftuar nga institucionet tjera, dhe tetë nuk ishin njoftuar fare. Pesë viktima të dhunës në familje thanë qartë se policia nuk i ka njoftuar ata për UM-të. Qartazi policia po dështon të ofron informata për të gjitha viktimat e dhunës në familje sipas Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje.

**“Askush nuk ka përmendur se mund të kërkoj urdhër për mbrojtje.”
 – Një grua shqiptare, moshë 26-35**

Një problem tjetër më specifik është ngurrimi në mesin e qytetarëve për të raportuar dhunën në familje në polici (shih edhe kapitullin 6). Në anketën mbarë kosovare të RrGGK-së 2008 të ekonomive familjare, prej 1,256 të anketuarve, në mesin e këtyre arsyeve, 19 të anketuar nuk do të shfrytëzonin ligjin për të zgjidhur rastet e dhunës në familje për shkak të perceptimit se policia nuk do të ndërmerri kurrfarë veprimi ose ligji nuk funksionon.¹⁵

Me qëllim të tejkalimit të perceptimeve negative publike rreth punës së policisë në rastet e dhunës në familje, në veçanti në mesin e viktimave, zyrtarët policor duhet të udhëheqin më shumë fushata vetëdijësuese dhe qasje ndaj komuniteteve. Përveç kësaj Rregullorja i kërkon policisë të përgatis dhe shpërndajë fletëpalosje për të drejtat e viktimave, që do të përfshinte informatat e nevojshme për ekzistencën e Rregullores MKDhF,¹⁶ si dhe rolet dhe përgjegjësitë e parapara që do të ofrohen nga policia.

Lëshimi i urdhrave për mbrojtje dhe përcjellja e rasteve nga policia

Disa zyrtarë policorë vazhdojnë me lëshimin e UME-ve edhe pse ligji nuk u jep atë kompetencë.¹⁷ Për shembull në mesin e rasteve të Pejës që janë vështruar nga RrGGK, më shumë se gjysma e kërkesave për konfirmim dhe lëshim të UM-ve ishin kërkuar nga policia pasi që kishin lëshuar UME-të. Siç thuhet në Rregulloren MKDhF, policia mund të lëshoj vetëm UME. Nevojitet trajnim shtesë për policinë që të kuptojë si duhet

¹³ Hulumtimi i RrGGK me institucionet korrik – gusht 2009.

¹⁴ Intervistat e RrGGK, korrik – gusht 2009.

¹⁵ RrGGK, *Siguria fillon në shtëpi*, p. 62.

¹⁶ Në vitin 2008, më shumë se gjysma e të anketuarve në anketën mbarëkosovare nga RrGGK dinin se ekziston rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje, kurse 34.8 për qind nuk dinin (*Siguria fillon në shtëpi*, f. 2). Në vitin 2008, RrGGK gjithashtu theksoi nevojën për përpjekjet për ngritje të vetëdijës, përfshirë në emër të policisë.

¹⁷ RrGGK ka raportuar se edhe pse Policia e Kosovës nuk ka autoritetin për të lëshuar urdhrat për mbrojtje emergjente, megjithatë PK ka lëshuar urdhra të tillë në 0.2 për qind të rasteve (*Siguria fillon në shtëpi*, f. 84).

dispozitat e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje dhe të siguroj aplikim të procedurave siç duhet.

Vështirësitë që kanë të bëjnë me zbatimin e UM-ve tanimë janë diskutuar shkurtimisht (shih kapitullin 2). Ligji i parasheh detajisht masat për ekzekutim të aktvendimeve të gjykatës civile në veçanti në rastet që dalin nga mosmarrëveshjet në familje. Sidoqoftë dëshmitë sugjerojnë se disa policë dhe gjykatës janë duke dështuar në zbatimin e UM-ve dhe vendimeve tjera të gjykatës civile që mbrojnë viktimat e dhunës në familje. Një përfaqësues i vendstrehimit dha një shembull:

Me Urdhrat Mbrojtës të lëshuara nga gjykata është vendosur që viktima duhet të mbetet në shtëpi. Ne shkuam atje me viktimën, punëtorin social, policinë dhe prokurorin. Kur arritëm vjehri i viktimës dhe burri na kërcënuan me armë duke thënë “kush hyn në shtëpinë tonë do të mbetet aty përgjithmonë! Do t’ju vrasim!” Ne... dërguam viktimën te daja i saj sepse ajo nuk kishte familjar të afërt. Policia erdhi me ne duke mos marrë kurrfarë hapi kundër kryesve.¹⁸

RrGGK ka parë se policia shpeshherë ka dështuar në intervenimin e rasteve të shkeljes së UM-ve.¹⁹ Një polic i atribuoi mangësitë te ngarkesa e madhe e punës së oficerëve të NjDhF. Oficeri gjithashtu shprehu brengat se vizitat e përsëritura pasuese mund të zemërojnë kryesit dhe t’i bëjnë që të hakmerren mbi viktimat për raportim të shkeljes së UM-së. Megjithatë nëse ndodh shkelja, policia me ligj duhet të arrestojë dhe të burgos kryesin. Tutje, Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje kërkon që ndjekja automatike penale duhet të pasojë menjëherë pas shkeljes së UM-së, pa marrë parasysh a ka pasur dhunë ose jo.²⁰

Pa marrë parasysh sfidat që mund të përballen, policët kanë përgjegjësinë e përcjelljes së zbatimit të UM-ve si pjesë e mandatit të tyre për të siguruar, mbrojtur dhe *parandaluar paraqitjen e dhunës së mëtejme*.²¹ Aktualisht duket se nuk ekzistojnë procedurat për monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të UM-ve. Në aspekt procedural duhet të qartësohet dhe përkufizohet angazhimi i policisë në monitorim.

Arrestim, paraburgim dhe lirim të të dyshuarve për dhunë në familje

Siç u tha, Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje i jep policisë autoritetin për të arrestuar menjëherë kryesit e supozuar nëse ka baza për dyshim se është kryer krimi i dhunës në familje. Sidoqoftë nga viti 2005 gjer në vitin 2008, PK ka arrestuar të dyshuarit në vetëm 30 për qind të rasteve të raportuara të dhunës në familje.²² Prandaj, dëshmitë sugjerojnë se policia shpesh dështon në arrestimin e kryesve të dyshuar të

¹⁸ Intervistat e RrGGK, korrik 2009.

¹⁹ Intervistat e RrGGK me institucionet dhe viktimat, korrik – gusht 2009.

²⁰ Shih nenin 16 të rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje.

²¹ Neni 14 i rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje.

²² Statistikat e siguruar për RrGGK nga sektori për dhunë në familje, Drejtoria për krime serioze, Policia e Kosovës, 31 gusht 2009 dhe në vjeshtë 2008.

dhunës në familje, përfshirë në rastet kur mund të jetë shkelur Kodi Penal.²³ Tutje, 35 viktima të dhunës në familje përkrahur nga RrGGK-së rastet kur ishin raportuar në polici, përfshirë dëmtime trupore dhe dhunë seksuale, por policia nuk kishte arrestuar kryesin, në përgjithësi duke dështuar në sigurimin e dëshmitëve që do të mbështesnin ndjekjen penale *ex officio* nga prokurori publik, po të ishte njoftuar. Për shembull një grua kujtonte:

Dhuna është ushtruar mbi mua për kohë të gjatë. Një ditë vendosa se nuk mundem përgjithmonë dhe raportova në polici dhunën në familje. Policia më pyeti nëse dëshiroja të hapja rastin. Pasi që kisha katër fëmijë dhe pa mbështetje nga familja ime e gjerë, i thashë që të mos hapin rastin por t’ia tërheqin vërejtjen burrit tim. Ata (policia) kërkuan nga burri im që të vjen (në stacion) dhe ai nisi rastin duke thënë se dhuna ishte faji im.²⁴

Në pajtim me procedurat ekzistuese, policia duhet të arrestojë kryesin e dyshuar nëse ekziston dëshmi të dhunës në familje.²⁵ Sidoqoftë është raportuar tendenca që thjesht të njoftohet prokurori dhe të lirohet i dyshuari.²⁶ Përderisa në pajtim me procedurat e policisë prokurorët duhet të njoftohen ashtu që të vendosin për hetimin e mëtejme dhe të merren me rastin, kjo nuk çliron policët nga përgjegjësia e tyre që të mbledhin dëshmitë dhe të arrestojnë kryesit e dyshuar.

“Ishin dy raste ku qiftet kishin dhunë në familje. Të dy u liruan nga policia dhe iu tha që të kthehen për intervistë tjetër. Kurrë nuk u kthyen sepse ‘ishin puthur dhe pajtuar’, kështu mu tha për përcjellje të rastit.”
 – Hetuesi MMA i EULEX

Një numër i të anketuarve thanë se dështimi për zbatim të ligjit ishte pjesërisht rezultat i roleve tradicionale të gjinive dhe besimeve kulturore.²⁷ Megjithatë mosveprimi i policisë pas raportimit të dhunës në familje mund të vë viktimat në rrezik të madh për dhunë të mëtejme, duke shtuar dhe përsëritur dhunën, si një rast i ilustruar nga një përfaqësues i vendstrehimit:

Burri ishte i dhunshëm kundër gruas së tij gjersa ajo vdiq. Pas asaj ai ishte i dhunshëm kundër vajzave të saj dhe gruas së djalit të tij, bile edhe duke përdorur dhunë seksuale. Gruaja e djalit të tij doli nga shtëpia dhe shkoi në familjen e saj dhe ai shkoi dhe vrau atë dhe motrën e saj. As policia as askush nuk ndërhyrë në kohë kur ai ishte i dhunshëm kundër gruas së tij!²⁸

²³ Intervistat e RrGGK me përfaqësuesit e të gjitha institucioneve dhe anketa e hetuesit MMA EULEX, 2009.

²⁴ Intervista e RrGGK me grua shqiptare, mosha 26-35, gusht 2009.

²⁵ Kjo provohet tutje me nenin 211 dhe 212 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës që deklarohen se policia mund të arrestojë dhe ndalojë çdo person gjer në 72 orë nëse ka dyshim të bazuar se ka kryer shkelje penale që ndiqet *ex officio* dhe arrestimi dhe paraburgimi është i domosdoshëm për të “mbledhur informata dhe dëshmi për shkelje penale në fjalë”. Arsyet për paraburgim janë përcaktuar nën nenin 281 paragrafin 1, nënparagrafin 2, pikat (i) dhe (iii), në veçanti kur ka arsye të mirë për frikë se personi mund të shkatërrojë dëshmitë e shkeljes penale. Arrestimi do të autorizohet nga prokurori publik ose nëse autorizimi i tillë nuk merret, policia duhet menjëherë të njoftojë prokurorin publik pas arrestimit. Tutje neni 281 deklarohen se përveç bazave tjera për paraburgim, paraburgimi mund të urdhërohet nga gjykata kur “serioziteti i shkeljes penale... dhe kushtet tjera tregojnë rrezikun se ai ose ajo do të përsëris shkeljen penale, ka kryer shkelje penale me paramendim ose ka kryer shkelje penale që ai ose ajo ka kërcënuar që ta kryej”, Kodi i procedurës penale të Kosovës, neni 281.

²⁶ Hetuesin MMA i EULEX, korrespondencë me e-mail me RrGGK, shtator 2009.

²⁷ Intervistat e RrGGK me përfaqësuesit e institucioneve (gusht 2009) dhe korrespondencë me e-mail me Hetuesi MMA i EULEX që kishte vëzhguar intervistat e policisë (shtator 2009).

²⁸ Intervista e RrGGK, korrik 2009.

Një viktimë tjetër e dhunës në familje kujton: “Policia erdhi vetëm tridhjetë minuta pas dhe folën me të [kryesin, burrin tim]. Natyrisht se ai refuzoi të gjitha. Pas kohës që folën me të, ata ja tërhoqën vërejtjen se kjo nuk duhet të ndodhë, dhe shkuan. Sidoqoftë pas dy dite dhuna vazhdoi përsëri dhe tani më shumë se përpara”.²⁹

Viktima të dhunës në familje gjithashtu raportuan proces të çuditshëm të policisë që burgosën kryesit e supozuar dhe më pas i lëshuan të dyshimtit pas disa orësh ose pas disa ditësh në paraburgim pa hetim shtesë ose gjykim penal.³⁰ Një grua shqiptare e moshës 26-35, komentoi, “një ditë ai [burri im] erdhi në shtëpi pasi që nuk kishte mundur të gjejë punë dhe filloi të më rrahë aq shumë sa që thirra policinë... Ata morën burrin tim në stacion të policisë dhe e mbajtën në burg për 72 orë [dhe më pas e liruan]”. Në disa raste policia konsideron paraburgimin të mjaftueshëm për dënim të krimit të kryer dhe se nuk ka nevojë për hetime shtesë të rastit. Ishte e paqartë nëse ishte njoftuar prokuroria. Sidoqoftë, ka pasur ndikim në aftësinë e viktimave për qasje në drejtësi.

Gjithashtu ishte brengosëse mbrojtja e pamjaftueshme që i ofrohet viktimave pas raportimit të dhunës. Fillimisht mungojnë kushtet fillestare për viktimat në stacion policor, duke rrezikuar mirëqenien e viktimës dhe fëmijës. Një përfaqësues i vendstrehimit shprehu brengën:

Ata duhet të rrinin në njësinë policore për 12 orë... Policia nuk ka dhomë të veçantë për ta prandaj ata flinin në dysheme. Nuk kanë bile as ushqim për t'i dhënë. Kishim raste kur vinin nga stacioni policor në vendstrehim, [dhe] ne u desh që t'i dërgojmë në spital sepse gjendja e tyre ishte përkeqësuar pasi që kishin fjetur në dysheme në stacionin policor.

Të anketuarit shprehën nevojën për policinë që të ofrojë siguri më të madhe për viktimat menjëherë pas raportimit të dhunës në familje.³¹ “[Policia] duhet të ofrojë më shumë siguri për viktimat kur raportojnë rastet sepse janë në rrezik nga kryesi”, komentoi prokurori.

“Ndonjëherë pasi që kryesi qëndron në paraburgim për 48 orë ata janë të dhunshëm në momentin kur kthehen në shtëpi. Ekziston nevoja për të monitoruar kthimin e tyre në shtëpi”.³² Përcjellja e rasteve është gjithashtu kërkesë nga Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje (neni 14, paragrafi g), ku thuhet qartë se policia duhet të ofrojë “Nëse paraqitet nevoja, sigurimin e mbrojtjes për atë që ka lajmëruar dhunën në përputhje me obligimet përkatëse ligjore lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve.”

Në përgjithësi gjatë intervistave është ngritur nevoja që të gjithë oficerët të respektojnë ligjin dhe të përcjellin procedurat në të gjitha rastet e dhunës në familje të raportuara.³³

²⁹ Intervista e RrGGK me gratë shqiptare, moshë 36-45, gusht 2009.

³⁰ Intervistat e RrGGK. Punëtori social i intervistuar nga RrGGK gjithashtu ka shënuar këtë çështje (gusht 2009).

³¹ Intervistat e RrGGK me institucionet e ndryshme, korrik – gusht 2009.

³² Intervista e RrGGK, gusht 2009.

³³ Intervistat e RrGGK me përfaqësuesit e të gjitha institucioneve, korrik – gusht 2009.

Në lidhje me arrestimet dhe paraburgimet e të dyshuarve, kjo është në veçanti e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të viktimës në pajtim me legjislacionin ekzistues dhe standardet ndërkombëtare. Nëse viktimave iu refuzohet qasja e shpejtë dhe efektive në drejtësi, ata mund të ngurojnë të raportojnë rastet e dhunës në familje.

Mbledhja e dëshmime në hetimin e rasteve të dhunës në familje

Në pajtim me kërkesat për procedurat penale, prokurori publik ka autoritetin për të iniciuar hetimin. Nën autorizimin dhe mbikëqyrjen e prokurorit publik, edhe policia gjyqësore mund të ndërmerret hetimin në lidhje me mbledhjen e dëshmime.³⁴ Në mungesë të policisë së specializuar gjyqësore në Kosovë, hetuesit e emëruar në fushat e ndryshme ndërmarrin hetimet shtesë dhe mbledhin dëshmitë.

Kur thirret në skenë të krimit, policia është përgjegjësi i parë për mbledhje të dëshmime, përfshirë fotografimin e skenës dhe viktimave, mbledhjen e dëshmime mostër, intervistimin e dëshmitarëve dhe marrjen e viktimave për ekzaminim të mjekësisë ligjore, nëse kërkohet.³⁵ Gjithashtu në pajtim me Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje, policia duhet të mbushë raportin e incidentit pa marrë parasysh a është krimi kryer apo jo, dhe një kopje duhet t'i dërgohet viktimës ose përfaqësuesit ligjor të viktimës.

Gjatë intervistave me RrGGK, gjysma e të anketuarve shprehën brengën se hetimet e dobëta të policisë çojnë në dëshmi të pamjaftueshme për gjykime.³⁶ “Ne nuk kemi gjithmonë rastet e kompletuara me të gjitha informatat ose dëshmitë e nevojshme”, tha Kryetari i gjykatës për RrGGK-në. “Shpeshherë duhet të punojmë në hetim me qëllim të përfundimit të procesit gjyqësor”.³⁷ Prokurorët në veçanti thanë se policia shpeshherë dështon në mbledhjen e dëshmime të mjaftueshme në skenën e krimit. “Raporti vjen te unë pas një muaji”, kujton prokurori. “Viktima deklaroi se ajo ishte rrahur nga të gjithë familjarët e saj. Në fillim rezistoi duke vizituar mjekun, dhe policia nuk ndihmoi. Ata bile as nuk fotografuan lëndimet e saj. Kur erdhi te unë, nuk kisha kurrfarë dëshmie për lëndimet trupore të saj”.³⁸ Krejt së bashku 11 viktima të dhunës në familje të intervistuar nga RrGGK thanë se policia nuk kishte hetuar rastet e tyre. Posaçërisht, gjashtë viktima të dhunës në familje kanë thënë se policia ka bërë foto të lëndimeve të tyre.

“Kishin një rast ku babai dyshohej se dhunonte vajzën e tij. Hetimi i policisë ishte shumë i dobët. Ata nuk intervistuan të gjithë familjarët. Prokurorët nuk provuan se ai kishte dhunuar vajzën e tij. Ka mungesë profesionalizmi në mesin e tyre. ...Tani rasti është ende i hapur, por informatat dhe dëshmitë ende mungojnë pas gjashtë muajve.”
 - Gjykatës penal

³⁴ Neni 221 i Kodit të procedurës penale të Kosovës.

³⁵ Shih Kodi i procedurës penale të Kosovës.

³⁶ Intervistat e RrGGK, korrik – gusht 2009.

³⁷ Intervista e RrGGK-së me Kryetarin e gjykatës komunale, gusht 2009.

³⁸ Intervista e RrGGK, gusht 2009.

Përderisa dosjet jokomplete nga policia penguan punën e prokurorisë,³⁹ policia i tha RrGGK-së se gjyqtarët dhe prokurorët shpeshherë injoronin raportet e Policisë së Kosovës në rastet e dhunës në familje. Bashkëpunimi i dobët në mes të policisë dhe prokurorisë mund t'i bëjë viktimat ngurues që të raportojnë aktet e dhunës në familje ose të besojnë se sistemi gjyqësor do t'i ofrojë atyre mjete efektive ligjore. Gjersa masat të ndërmerren për të siguruar se prokuroria dhe policia të punojnë së bashku në hetime dhe të mbledhin dëshmi substanciale, gjyqtarët do të vazhdojnë shqiptimin e dënimeve të buta për kryesit dhunës në familje (shih kapitullin 3).

Është brengosëse se nëntë viktima gjithashtu i thanë RrGGK-së se policia i ofendoi ose i trajtoi dobët, që shpeshherë kontribuoi në dëshmi të pamjaftueshme për të ndjekur rastin:

“Një ditë ai përdori aq shumë dhunë sa që unë gjakosja dhe shkova në stacion policor. Raportova rastin por asgjë nuk ndodhi. Thirra këshilltarin tim [OJQ] dhe i thashë asaj çfarë ndodhi në stacion policor. Ajo më pyeti nëse policia më dërgoi në spital ose nëse fotografoi plagët. I thashë se asnjëra nuk ndodhi. Shkova përsëri në stacion policor dhe kërkova që të më dërgojnë në spital dhe të bëjnë fotografitë e plagëve në trupin tim. Më thanë se nuk kanë kohë që të merren me mua. Shkova vet në spital dhe mjeku më tha të dorëzoj një kërkesë zyrtare për rastin tim” – grua shqiptare, mosha 26-35

“Ata (policia) më thanë se prindërit duhet të përdorin dhunë fizike për të edukuar fëmijët e tyre.” – Grua shqiptare, mosha 18-25

“Një natë burri im erdhi në shtëpi i dehur dhe më rrahu shumë. Unë isha e përgjakur dhe menjëherë thirra policinë. Policia më tha në telefon se me siguri e kam zemëruar dhe kjo është arsyeja pse më rrahu. Policia nuk u përgjigj kërkesës sime për të ardhur” – grua RAE, mosha 26-35

“Pasi që raportova rastin në polici, policia më kërkoi që të kthehem në shtëpi te personi i njëjtë që përdori dhunë. Më thanë: “një burrë mund të kujdeset për shtatë gra”. I bëra të qartë se unë nuk kthehem në atë shtëpi, dhe më dërguan në Qendrën për Punës Sociale... Ata konsideronin dhunën si pjesë të jetës dhe u munduan që të zvogëlojnë rëndësinë e problemeve të mia. Sipas tyre burri ka më shumë privilegje se gruaja dhe burri mund të ketë më shumë se një grua”. – Grua shqiptare, mosha 26-35

“Kur shkova herën e parë në polici për të raportuar dhunën në familje, më trajtuan shumë dobët dhe më thanë se burrat duhet t'i rrahin gratë e tij sepse është puna e tyre. ... Nuk shkuan direkt në kafe bar për të marrë kryesin por e paralajmëruan që të fshihej sepse ‘po e kërkonin’” – Grua shqiptare, mosha 26-35

“Polici më tha, ‘nëse gruaja ime do e thërriste policinë, unë do e kisha vrarë.’” – Grua shqiptare, mosha 36-45

³⁹ Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Raporti për rastet e dhunës në familje në Kosovën,” 2007.

“Nga dhuna e tmerrshme që kam përjetuar, u detyrova që të shkoj në polici. Gjatë deklaratës sime, punëtorët e Policisë së Kosovës nuk kushtonin vëmendje fjalëve ose brengave të mia. Isha shumë e stresuar dhe i thashë se nuk po më dëgjonin. Ata u përgjigjën, ‘është më mirë që të shkosh në shtëpi e të kujdesesh për fëmijët tua sesa të rrih këtu e të bësh deklaratë me orë të tëra’. U zemërova shumë dhe dola pa nënshkruar deklaratën. – Grua shqiptare, mosha 26-35

Është e qartë se trajtimi i dobët në emër të policisë mund të kontribuojë në atë që viktimat të tërheqin raportet e tyre ose të vendosin që mos të raportojnë në të ardhmen, dhunë recidiviste. Brengat për korrupsion, përfshirë ryshfetin dhe nepotizmin në mesin e policisë gjithashtu u shprehën nga shumë viktima të dhunës në familje. Një grua shpjegoi:

Pas rrahjeve brutale që përjetova, bile edhe kur isha gjashtë muaj shtatzënë, vendosa që të thërras policinë. Dëshmovava se kishte dhunë mbi mua dhe policia më premti se do të dërgonte rastin tim në gjykatë. Më pas shkova në spital për të parë gjendjen shëndetësore time dhe të foshnjës sime sepse isha duke gjakosur. Qëndrova dy ditë në spital nën kujdes intensiv të mjekëve. Pas dy javësh shkova në Qendrën për Punë Sociale ku deklarova rastin tim. ... Më pas dëgjova se burri im kishte dhënë ryshfet policisë për të mos dërguar rastin tim në gjykatë.⁴⁰

Nuk duhet toleruar as trajtimin diskriminues të viktimave as korrupsionin në emër të policisë. Duhet të vendosen sistemet përmes së cilave mund të raportohen, hetohen dhe dënohen shkeljet e tilla të përgjegjësive. Dështimet e tilla janë në shkelje direkte të dispozitave të ligjit të aplikueshëm dhe obligimin e shtetit për të hetuar dhe ndjekur aktet e dhunës në familje si dhe për të parandaluar shfaqjen e mëtejme të akteve të tilla.⁴¹ Brengat për besueshmërinë gjithashtu janë shfaqur nga një gjykatës që tha se policia çdo ditë raporton në media rastet që lidhen me dhunën në familje, duke dhënë përshkrime të mjaftueshme që viktimat të identifikohen me lehtësi, në veçanti në komunitetet e vogla. Kjo ka potencial të ndikimit mbi rezultatet e rastit, mund të çojë në presion për pajtim nga familja dhe shoqëria, dhe mund të parandalojë të tjerët që mos të raportojnë dhunën në të ardhmen.

“Policia jep raporte të shkurtra për ngjarjet e ditës. Edhe pse përmes tyre nuk përmendin emrat e viktimave ose të kryesve në rastet e dhunës në familje, shoqëria din gjithçka sepse ata i tregojnë fqinjëve, etj.” - Gjykatësi

Monitorimi dhe inspektimet e rregullta të cilësisë së punës së policisë mund të ndihmojnë në identifikimin e çështjeve me oficerët e policisë dhe/ose regionet e veçanta ashtu që puna e dobët të qortohet.⁴² Punësimi i oficerëve shtesë profesional që do të punojnë vetëm me rastet e dhunës në familje mund të zgjerojë aftësitë e tyre për hetime si dhe ndjeshmërinë kah viktimat, thanë të intervistuarit. Një monitorues nga EULEX-i

⁴⁰ Intervista e RrGGK me gratë RAE, mosha 26-35, gusht 2009.

⁴¹ Shih Hyrjen në Kornizën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që lidhet me shkeljet e dhunës në familje dhe deklarimet obligimet.

⁴² Viktimat e dhunës në familje kërkuan monitorim të rregullt të punës së oficerëve të policisë (Intervistat e RrGGK, gusht 2009).

gjithashtu shprehu nevojën për dosje më të detajuara të skemave të krimit, përfshirë fotografitë e skenës, viktimën, fëmijët dhe të dyshuarit, si dhe regjistrimin telefonik ose digjital.⁴³ Më përgjithësisht, u kërkuan edhe kushtet e përmirësuara teknikem, automjete shtesë, linjë buxhetore për ushqim dhe barna emergjente, dhe sallat për intervistim të viktimave në stacionet ku ato nuk ekzistojnë.⁴⁴ Në përmbyllje, përmirësimi i cilësisë së reagimit të policisë ndaj rasteve të dhunës në familje mund të sigurojë mbrojtje më të madhe për viktimat që kërkojnë drejtësi, parandalon recidivizmin, dhe siguron që krimi i kryesve ndiqet penalisht në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

⁴³ Korrespondencë me e-mail me RrGGK, shtator 2009.

⁴⁴ Intervistat e RrGGK me policinë si dhe prokurorët dhe përfaqësuesit e vendstrehimeve, korrik-gusht 2009.

më shumë se vetëm
**'Fjalë
në LETËR'?**

KAPITULLI 5. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE DHE QASJA NË DREJTËSI

KAPITULLI 5. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE DHE QASJA NË DREJTËSI

Me qëllim të sigurimit se të drejtat e viktimave mbrohen përgjatë tërë procesit të qasjes në drejtësi në pajtim me obligimet e qarta të detajuara në deklaratën e OKB-së për viktimat e krimit, korniza ligjore në Kosovë ngarkon një numër të institucioneve me përgjegjësinë e mbështetjes së viktimave të krimit, përfshirë ata të dhunës në familje. Këto përfshinë Divizionin për këshillim dhe ndihmë viktimave në kuadër të Ministrisë së drejtësisë, Sistemin e ndihmës juridike në Kosovë, Qendrat për punës sociale me përgjegjësinë e tyre specifike që të mbrojnë të drejtat e fëmijëve, dhe shtëpitë e sigurta joqeveritare, të financuara pjesërisht nga Departamenti i mirëqenies sociale, që ofron vendstrehim si dhe forma tjera të mbështetjes për viktimat para, gjatë dhe pas procedurës gjyqësore. Ky kapitull vlerëson cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe identifikon fushat për përmirësim.

Tabela e poshtme ilustron numrin e rasteve të dhunës në familje të asistuar nga institucionet e mësipërme për nga viti dhe gjithsej. Pasi që institucionet e ndryshme mund të kenë asistuar klientët e njëjtë, këto shifra nuk duhet të mblidhen.

Numri i rasteve të dhunës në familje të asistuar nga institucionet përgjegjëse, 2002- 2009

Burimi	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	Total
Policia e Kosovës	1273	1251	1318	1370	1371	1077	1032	470 ¹	9,162
Divizioni për këshillim dhe ndihmë viktimave		314	414	592	703	645	610	397 ²	3,675
Departamenti për mirëqenie sociale - QPS-të			223	380	438	170	247	92 ³	1,550
Komisionet për ndihmë juridike							36	20 ⁴	56

Divizioni për këshillim dhe ndihmë viktimave

Deklarata e OKB-së për viktimat e krimit përcakton një numër të standardeve për asistencë dhe mbrojtje të viktimave të krimit, në mes tyre: a) qasja në drejtësi dhe trajtimi i drejtë përgjatë mekanizmave gjyqësor dhe administrativ dhe ligjet që duhet të përforcohen ose krijohen; b) informimi për viktimat mbi të drejtat e tyre kur kërkojnë ndihmë; c) shërbimet dhe restaurimi i të drejtave të shkelura, përfshirë dëmshpërblimin si opsion i shqiptimit të mundën në rastet penale; d) krijimi ose përforcimi dhe zgjerimi i fondeve kombëtare për kompensim të viktimave me qëllim që të mundësohen mjete efektive ligjore; e) asistencë në formë të asistencës së nevojshme materiale, mjekësore, psikologjike dhe sociale përmes mjeteve qeveritare; f) shërbimet policore, të drejtësisë, shëndetësore dhe sociale duhet të jenë lehtë të qasshme dhe të përshtatshme për nevojat e viktimave.⁵

¹ Të dhënat nga qershori 2009.

² Të dhënat nga 2 shtatori 2009

³ Të dhënat nga qershori 2009.

⁴ Të dhënat nga korriku 2009

⁵ Shih Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimi i autoritetit (Deklarata e OKB-së për viktimat e krimit) e miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i OKB-së më 29 nëntor 1985, në dispozicion në <http://www.un.org>

Me qëllim të ofrimit të mjeteve ligjore efektive viktimave të krimit, autoritetet e Kosovës gjatë administrimit nga UNMIK-u kanë zhvilluar konceptin “avokatët e viktimave”. Rolet dhe përgjegjësitë e tyre janë qartësuar mirë në Kodin Penal të Kosovës (KPK) dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Në atë kohë përkufizimi i “viktimës” mungonte nga ligjet paraprake dhe vetëm përkufizimi i “palës së dëmtuar” ekzistonte. Prandaj rishikimi ligjor i legjislacionit penal dhe civil përfshiu përkufizimin e avokatit të viktimës në disa ligje që adresojnë të drejtat e viktimave të krimit. Në veçanti Nenet 81 dhe 82 të KPPK pozicionojnë Avokatët e Viktimave (AV-të) si persona përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, në veçanti viktimat e akteve të kryera në marrëdhënie familjare. Funkzioni i AV-ve si përfaqësues të autorizuar dhe mbrojtja nga ta e të drejtave të viktimave duke mbrojtur integritetin e tyre gjatë “ekzaminimit para autoritetit që kryen procedurën gjyqësore dhe për të bërë ankesë dhe për të kërkuar pronë”. Tutje, ata janë të mandatuar që të asistojnë viktimën duke mbrojtur të drejtat e tij/saj përfshirë, kur kërkohet, si përfaqësues i autorizuar i viktimës. Në thelb, AV-të duhet të përfaqësojnë interesat e viktimave dhe të këshillojnë viktimat për të drejtat e tyre.

Përgjegjësia e AV-ve për mbrojtje të të drejtave të viktimave filloi në prill të vitit 2004. Që atëherë AV-të duhet të jenë prezent dhe të përfaqësojnë viktimat nga fillimi i procedurës gjyqësore dhe faza përgatitore gjer në fund të procedurës gjyqësore dhe pasimin e saj. Koncepti bazohet në asistencë kuazi juridike, pasi që AV-të jo doemos duhet të jenë juristë, por duhet të njohin legjislacionin ekzistues dhe të drejtat që i jepen viktimave me ligjin e aplikueshëm. Në praktikë sidoqoftë shumica e AV-ve në kuadër të Ministrisë së drejtësisë kanë kryer juridikun.⁶ Nën KPPK, AV-të duhet të veprojnë si përfaqësues të autorizuar të viktimës. Përkufizimi i “përfaqësuesit të autorizuar” është personi që vepron në emër dhe interes të viktimës nga fillimi i procedurës penale (Neni 151 i KPPK-së). Në rastet kur përfaqësuesi legal i viktimës ose viktima nuk kërkon përfaqësues të autorizuar, është detyrë e kryetarit të gjykatës që të emëroj një, *ex officio*, me shpenzime publike.⁷ Kjo dispozitë siguron prezencën e AV-ve dhe i mundëson ata që të përmbushin rolin e mbrojtjes së të drejtave të viktimave.

Përveç ligjeve të sipërpërmendura penale, rolet dhe përgjegjësitë e AV-ve në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës në familje përkufizohen qartë në Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje. AV-të janë përmendur si një nga palët që mund të kërkojnë UM. Së bashku me qendrat komunale për punë sociale (QPS-të), AV-të luajnë një rol thelbësor në përkufizimin e të drejtave të viktimave të dhunës në familje. Në veçanti përderisa QPS-të mund të kërkojnë UM në rastet e dhunës në familje kur janë të përfshirë fëmijët dhe për të përfaqësuar interesin më të mirë të fëmijës në procedurat e gjyqit (bile edhe pa pajtim të fëmijës nëse ata mendojnë se ai fëmijë është i rrezikuar nga prindërit ose personat tjerë me të cilët fëmija ndaj marrëdhënie familjare) dhe AV-të duhet të reagojnë shpejtë në të gjitha rastet e dhunës në familje dhe me pajtim të viktimës mund të kërkojnë UM si dhe të përfaqësojnë interesat më të mira të viktimës në të gjitha procedurat e gjyqit.⁸

⁶ Raport i Misionit të OSBE-së në Kosovë për themelimin e mekanizmave referues për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë, kapitulli për avokatët e viktimave.

⁷ Neni 82, paragrafi 5 i KPPK-së.

⁸ Neni 6 (2) i rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje.

Janë raportuar mangësi në punën e AV-ve si përgjegjës për përfaqësimin e interesave të viktimave të dhunës së bazuar në gjini, përfshirë rastet e dhunës në familje. AV-të rrallëherë ishin ftuar ose paraqitur gjatë sesioneve gjyqësore për rastet e të rinjve, ose kur kanë qenë prezent, ata kanë luajtur rol shumë pasiv.⁹ Siç i tha një mbrojtës i viktimës RrGGK-së, “kur marrim pjesë në gjykim, ne vetëm dëgjojmë.” Ngjashëm tha edhe përfaqësuesi i vendstrehimit “mbrojtësi i viktimës që i jepet viktimës është shumë i keq. Për shembull, në tri sesione gjyqësore ku një avokat shoqëronte viktimën, ai avokat kurrë nuk tha asgjë për të mbrojtur viktimën. Viktima ishte rast incesti.”¹⁰ Siç ka raportuar RrGGK më herët, disa mbrojtës të viktimës kanë mungesë të njohurisë dhe ndjeshmërisë në kuptimin e viktimave të dhunës së bazuar në gjini.¹¹ Disa të anketuar janë ankuar se AV-të nuk këshillojnë viktimat në mënyrë adekuate rreth të drejtave të tyre ligjore dhe se AV-ve iu duhet aftësim shtesë në çështjet e dhunës në familje¹². Një gjykatës komentoi se AV-të gjithashtu duhet të jenë më të kujdesshëm në lidhje me sigurimin e konfidencialitetit.¹³

Sidoqoftë puna e AV-ve duket e përzier, dhe varet kryesisht nga individi. Përfaqësuesit e vendstrehimit që punojnë në regjionet tjera nga ato të sipërpërmendura përshkruan AV-të në këtë zonë si “profesional” dhe “bashkëpunues.” Prej 23 viktimave të dhunës në familje të intervistuar nga RrGGK që kishin marrë asistencë nga AV, shumica thanë se ishin trajtuar mirë. Tre përmendën në veçanti “mbështetjen” dhe “këshillat e mira” nga AV. Të tjerët thanë se AV-të e tyre nuk përfshiheshin aktivisht në rastin e tyre ose nuk kishin mbrojtës të viktimës fare. Vetëm dy të anketuar ndien se ishin trajtuar dobët: mbrojtësi i viktimës nuk kishte besuar se çfarë dhune kishte përjetuar ajo, dhe “mbështeste kryesin”.

Në çdo rast, AV-të nëpër Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida operative. Një përfaqësues i vendstrehimit komentoi “kishim një rast kur Avokati i Viktimës nuk mundi të shoqëroj policinë që të dërgojë viktimën në gjykatë, ashtu që viktimës i iku sesi gjyqësor”. Edhe pse PV shpjegoi se mungesa rezultoi nga mosdisponueshmëria e automjetit të AV-së, viktima megjithatë humbi sesionin e gjyqit. AV-të thanë se kishin resurse të pamjaftueshme për transportim, ushqim dhe rrobe për të asistuar viktimat. Ata ishtë dashur të shpenzojnë para nga “xhepi i vet” për të mbuluar nevojat themelore të viktimës.¹⁴

⁹ Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Raporti vlerësues për themelimin e mekanizmave referues për viktimat e trafikimit me genie njerëzore,” 2007.

¹⁰ Intervista e RrGGK me përfaqësuesit e vendstrehimeve, korrik 2009.

¹¹ Shih RrGGK, “Siguria fillon në shtëpi”; f. 87-88. Një mbrojtës i viktimës i tha RrGGK-së se ata kishin pasur një rast ku një vajzë 13 vjeçare kishte raportuar abuzim seksual nga një burrë i moshës rreth 60 vjeçare. Sidoqoftë mbrojtësi i viktimës hezitoi të reagojë sepse nuk ishin të sigurt nëse vajza kishte marrëdhënie seksuale me vet dëshirë. Është e qartë se mbrojtësi i viktimës kishte mungesë të njohurisë se abuzimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare është i dënueshëm me dënim nga një gjer në dhjetë vjet, sipas KPK, neni 198.

¹² Dy mbrojtës të viktimës qartë kërkuar njohuri shtesë të përmbajtjes së rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje, dhe një mbrojtës i viktimës tjetër tha se pengesa e tyre kryesore në adresimin e të drejtave të njeriut është përkufizimi i paqartë i rolit të mbrojtësve të viktimës në ligjin e aplikueshëm që ilustron qartë mungesën e njohurisë mbi mandatin e mbrojtësve të viktimës (Intervistat e RrGGK, gusht 2009).

¹³ Intervista e RrGGK me gjyqtarin penal, gusht 2009.

¹⁴ Ibid.

Përfaqësimi ligjor i viktimave: Sistemi i ndihmës juridike në Kosovë

Para vitit 2006, kur u shpall rregullorja e UNMIK-ut 2006/36 për ndihmën juridike (rregullorja për ndihmë juridike), sistemi i ndihmës juridike në Kosovë funksionoi si projekt i Odës së Avokatëve të Kosovës me mbështetje nga Agjencia Evropiane për Rindërtim UNMIK. Projekti filloi në vitin 2001 dhe u zgjat në baza vjetore gjer në vitin 2005.¹⁵ Më pas në vitin 2006, u shpall rregullorja për ndihmë juridike, duke themeluar një sistem të ndihmës juridike për rastet penale dhe civile. Personat me të drejtë për të pranuar ndihmë juridike falas janë persona që përndryshe nuk do të kishin qasje efektive në drejtësi sepse kanë mungesë të resurseve të mjaftueshme. Ai në veçanti shënjestron grupet e rrezikuara duke kërkuar ofrim efektiv të ndihmës juridike dhe duke siguruar përfaqësim të nevojave të tyre. Grupet e cenushme definoohen si: ‘të varfër, pastrehë, pleq, gra, fëmijë, persona me paaftësi dhe persona nga komunitetet jo-shqiptare.’¹⁶

Komisioni për ndihmë juridike përcakton rregullat dhe procedurat për punë të Zyrës koordinuese të ndihmës juridike, që shërben si sekretariat i Komisionit (Neni 1.2 i rregullores për ndihmë juridike). Zyra koordinuese për ndihmë juridike ka pesë Zyra për ndihmë juridike dhe bashkëpunon me Odën e Avokatëve të Kosovës për të emëruar avokatët që ofrojnë ndihmë juridike falas. Zyra gjithashtu siguron përfaqësim falas për rastet dhe siguron përfaqësim të drejtë për grupet e rrezikshme si shfrytëzues të shërbimeve të ndihmës juridike (neni 7.1). Tutje, rregullorja për ndihmë juridike kërkon ofrimin e informatave dhe këshillat në lidhje me procedurat gjyqësore në të cilën aplikuesi qëndron si viktimë si dhe çështjet që dalin nga Ligji për familje ku përfshihen kujdesi ndaj fëmijëve dhe mirëmbajtja e tyre (neni 9).

Sipas nenit 11 të Rregullores për ndihmë juridike, ata që janë të pranueshëm për ndihmën primare juridike përfshijnë të gjithë personat e “kualifikuar” që pranojnë ose kanë të drejtën për të pranuar asistencë sociale ose kush ka gjendje ekuivalente financiare. Zyra për ndihmë juridike pranon dhe vendosë për pranueshmërinë e aplikacioneve për ndihmë juridike. Kur të miratohen rastet, aplikuesi referohet te një avokat nga lista e vendosur për atë qëllim.

Sistemi i Kosovës për ndihmë juridike ende pritet të bëhet plotësisht funksionale, dhe organizatat joqeveritare (OJQ) vazhdojnë të ofrojnë ndihmë juridike grupeve me të ardhura të ulëta.¹⁷ Me zyra në çdo regjion, sistemi nuk mbulon plotësisht Kosovën. Kjo është kritikuar si shkelje e të drejtave të njeriut duke shkelur të drejtën e palës për këshillim nën Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut sepse qasja në drejtësi refuzohet për shkak të të ardhurave të ulëta, në veçanti në viset rurale.¹⁸ Tutje, është vëzhguar edhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga juristët e kontraktuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Juristët janë kritikuar për përfaqësim të dobët të të drejtave të klientëve, vijim të parregullt të sesioneve të gjyqit, dhe shtyrje të panevojshme të sesioneve.¹⁹

¹⁵ Shih Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Përfaqësimi ligjor në rastet civile,” qershor 2007.

¹⁶ Neni 3

¹⁷ Shënimi Supra në 16.

¹⁸ Ibid.

¹⁹ Ibid.

Mangësitë e Sistemit të Ndhmës Juridike në Kosovë

RrGGK ka ekzaminuar përfaqësimin ligjor të viktimave në procedurat gjyqësore penale dhe civile me qëllim që të analizojë qasjen në ndihmën juridike falas dhe në drejtësi nga grupet e rrezikuara dhe në pajtim me ligjin e aplikueshëm. Prej 17 viktimave të dhunës në familje të intervistuar nga RrGGK që pranuan asistencë nga Zyrtarët e Ndhmës Juridike (ZNJ), 14 thanë se ishin trajtuar mirë. Viktimat thanë se ZNJ kanë siguruar informata të dobishme, kanë shpjeguar të drejtat e tyre, i kanë asistuar përgjatë procesit ligjor, dhe i kanë përfaqësuar mirë në gjykatë. Vetëm një viktimë ka raportuar se ZNJ ka dështuar në sigurimin e informatave rreth gjykimit dhe ka injoruar telefonatat e saj.

Janë vërejtur brenga të caktuara strukturore dhe mangësi të kapacitetit gjatë intervistave të RrGGK-së me ZNJ dhe juristë. Për shembull ZNJ thanë se një nga sfidat më kryesore që ata përballen me rastet e dhunës në familje është puna e avokatëve të kontraktuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës.²⁰ Klientët e tyre shpeshherë ankohen se avokatët janë pasiv gjatë përfaqësimit të interesave të viktimës në gjykatë dhe ndihen se kanë dështuar në përfaqësimin e duhur të interesave të viktimës. Avokatët thanë se për shkak të tarifave të ulëta që ofrohen nga kontratat e Sistemit të ndihmës juridike, avokatët zakonisht refuzojnë rastet ose ofrojnë përfaqësim të dobët të rasteve të tilla para gjykatës.

Në përgjithësi, RrGGK ka parë se ZNJ dhe avokatët kanë nivel të ulët të kuptimit dhe njohurive të legjislacionit të aplikueshëm që lidhet me shkeljet gjatë dhunës në familje. Disa ZNJ nuk dinin për ekzistencën e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje dhe si përkufizohen aktet e dhunës në familje. Për shembull, në pyetjen e RrGGK-së, a është “natyrale që dhuna fizike të ndodhë ndonjëherë në mes të qifteve,” një avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës u përgjigj, “Po, është natyrale që dhuna fizike të ndodhë ndonjëherë kur qifitet fjalosen. Në rastet specifike, pse jo? Si për shembull kur gratë keqpërdorin lirinë e tyre, dalin me të tjerët dhe mashtrojnë burrat e tyre.”²¹ Disa avokatë dhe ZNJ kanë parë ndarjen strikte në mes të roleve të grave dhe burrave në shoqëri ose mungesën e njohurisë për aktet e dhunës në familje, përveç rasteve që përfshijnë dhunën më lehtë të detektueshme fizike, siç ilustron rasti në vijim:

Kishim një rast kur burri vdiq dhe kunati i gruas e nxori atë jashtë shtëpisë. U munduam të ndërmjetësojmë për të arritur marrëveshje sepse nuk kishte dhunë fizike. Ai vetëm e largoi atë nga shtëpia dhe mbajti fëmijët duke mos i lejuar që të shkojnë me nënën e tyre. Policia nuk mundi ta vërtetojë këtë. Më pas referuam rastin te avokatët e viktimës. U munduam që t’i pajtojmë sepse nuk kishte dhunë fizike. [RrGGK: a mendoni se edhe pse nuk kishte dhunë fizike, kunati kishte të drejtë t’ia marr fëmijët dhe pronën?] Është më mirë për ta që të jetojnë bashkë, nëse përmirësojnë marrëdhëniet e tyre, pasi që ai nuk tha se kishte dhunë fizike. [RrGGK: a mendoni se ajo ka të drejtën për kujdestari të fëmijëve dhe pronës?] Po, me ligj... Po.

²⁰ Intervista e RrGGK, gusht 2009.

²¹ Intervista e RrGGK me një avokat të kontraktuar të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Vetëm pas shqyrtimit të shumtë nga RrGGK në lidhje me të drejtat e gruas për kujdestari dhe pronë, ZNJ pranoi se ajo kishte të drejtën ligjore. Ai gjithashtu supozoi se dhuna në familje shfaqet vetëm nëse ekziston dhunë fizike në mes të bashkëshortëve. Në pajtim me Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje aktet e dhunës në familje nuk janë vetëm fizike dhe mund të paraqiten në mes të personave të ndryshëm në lidhje familjare që ndajnë ekonominë e njëjtë familjare.²² Edhe pse ato definoohen si të tilla, ZNJ nuk i ka konsideruar detyrimin e viktimës të largohet nga shtëpia ose marrjen e fëmijëve të saj si akte të dhunës në familje. Ngjashëm, një avokat ka përshkruar një rast tjetër:

Burri rrahu gruan e vet. Ajo raportoi rastin dhe gjykata lëshoi Urdhrin Mbrojtës dhe gjithashtu i dha mundësi që të takojë fëmijët e saj. Shtëpia ishte pronë e vjehrrit. Ajo nuk kishte strehim, ashtu që u kthye prapa të babai i vet. E drejta prindërore... ishte dhënë burri të saj sepse ajo nuk kishte pronë. Tani ajo nuk ndihet rehat në shtëpinë e babait të saj dhe nuk mund të kthehet te burri. *Mendoj se nuk duhet raportuar në polici çdo akt dhune [vë theksin]. Ndonjëherë është më mirë të kërkohen zgjidhje alternative sepse kur raportohen kryesit ose burrat dhe paraburgosen, ata zemërohen më shumë dhe vendosin që të shkurorëzohen, kështu që viktimat nuk përfitojnë nga raportimi i dhunës.*²³

Siç duket tradita patriarkale e përcjellë me njohuri të pamjaftueshme rreth dhunës në familje dhe se si ndikon ajo në viktimat, mund të ketë ndikim në cilësinë e përfaqësimit të cilën e kanë viktimat gjatë gjykimit.

Kriteri me të cilën i caktohet prioritet rasteve nevojtare për ndihmë juridike mund të jetë diskriminues. Përfaqësimi prioritar bazohet në parimin “i pari me kohë, i pari me të drejtë”, shpjegoi një ZNJ, që do të thotë se kur të dyja palët, viktimat dhe krysi drejtohen tek Zyra për Ndihmë Ligjore për përfaqësim, ata i sigurojnë asistencë vetëm njërit prej tyre: atij që ka kërkuar i pari asistencën. Faza e dytë mund të jetë diskriminuese nëse të dy rastet përmbushin kriteret themelore për mbështetje. ZNJ nuk pa ndonjë problem me këtë “kriter përzgjedhës”. Sidoqoftë, një arsytim i tillë është në kundërshtim të qartë me qëllimin e Rregullores për ndihmë juridike. Siç u cek, Rregullorja kërkon që grupet e rrezikuara siç janë gratë dhe pleqtë, në mes tjerash, duhet të kenë prioritet për ndihmë juridike në krahasim me rastet tjera që plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë për asistencë.²⁴

Brengë tjetër e raportuar te RrGGK nga katër ZNJ ishte dyfishimi i dukshëm në punën e ZNJ dhe AV. Një ZNJ ka kritikuar zgjedhjen e AV-ve që të marrin pjesë në disa sesione gjyqësore ose të angazhojnë avokatë tjerë nga lista e AV-ve për të përfaqësuar viktimat e krimit. Megjithatë Rregullorja për ndihmë juridike është e qartë për rolin e ZNJ në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e AV-ve. Ajo kërkon që me shpalljen e Rregullores për ndihmë juridike, asnjë dispozitë e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të mos shfuqizohet kur përcaktohen rolet e AV-ve. Siç u tha më sipër, detyra e AV-ve është mbrojtja e të drejtave

²² Neni 1 i rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje.

²³ Intervista e RrGGK, gusht 2009.

²⁴ Neni 3 dhe 7 i Rregullores për ndihmë juridike.

të viktimave dhe të veprojnë si përfaqësues të autorizuar në rastet kur të jetë e mundur. Për shembull, në rastet kur ata shohin dështime në përfaqësimin ligjor të rasteve, ata duhet të reagojnë dhe të kërkojnë mbrojtjen e interesave më të mira të viktimës. Nevojitet aftësim shtesë për AV-të, avokatët dhe ZNJ për të qartësuar përgjegjësitë dhe rolet e secilit prej tyre dhe për t'i qartësuar të gjitha palët për specifikat e mandatit të tyre. Tutje, këmbimi i përvojave mund të zgjerojë sensitivitetin e avokatëve dhe ZNJ, ashtu që ata të kenë ndërhyrje në bazë të informatave dhe njohurive gjatë mbështetjes së grupeve të rrezikuara siç janë viktimat e dhunës në familje.

*“Qendra për Punë Sociale injoron përgjegjësitë e saj: ata presin për të shkuar dhe për [të marrë viktimat]; nuk vijnë këtu në stacion policor për orë të tëra, etj. Duhet të jenë më serioz në trajtimin e këtyre rasteve, duhet të veprojnë më shpejt.
 –Pjesëtar i Policisë së Kosovës*

Në përmbyllje, rastet e sipërpërmendura ilustrojnë disa shkaqe për brengë në lidhje me cilësinë e përfaqësimit ligjor që u ofrohet viktimave të dhunës në familje, si dhe nivelit gjer në të cilin këto institucione janë të ndjeshme për interesat e tyre më të mira. Legjislacioni aktual që ka të bëjë me aktet e dhunës në familje si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duhet të jenë pjesë e aftësimin të ardhshëm që ofrohet nga Zyra koordinuese për ndihmë juridike dhe Divizioni për këshillim dhe ndihmë për viktimat në kuadër të Ministrisë së drejtësisë në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës. Trajnimi duhet të përfshijë mënyrën e ofrimit të përfaqësimit të ndjeshëm ligjor për viktimat dhe si të mbrohen më së miri nevojat e tyre dhe të përfaqësohen interesat e tyre.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijës dhe ndihmimi i viktimave: Qendrat për Punë Sociale

Përderisa Qendrat për punës sociale (QPS-të) kanë përgjegjësi të ndryshme, puna e tyre në veçanti sa i përket viktimave të dhunës në familje që i qasen drejtësisë përfshinë aftësinë për të kërkuar Urdhrin Mbrojtës në rastet e dhunës në familje kur janë të përfshirë fëmijët.²⁵ QPS-të kanë përgjegjësi ligjore që të përfaqësojnë interesat më të mira të fëmijës në procedurat gjyqësore. Në rastet civile, QPS-të ofrojnë mendimin e tyre në lidhje me kujdestarinë e fëmijës. Indirekt, QPS-të mundën gjithashtu të ndikojnë në qasjen në drejtësi.²⁶ Sigurimi i asistencës sociale dhe/ose mbështetja e QPS-së në rastet e kujdestarisë së fëmijëve mund të bëjë ndryshim për gratë që kërkojnë lirim nga lidhjet familjare të dhunshme dhe/ose të sigurojnë kujdestarinë e fëmijëve të tyre.

²⁵ Neni 6 (2) i rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje.

²⁶ Një numër i ligjeve udhëheqin shërbimet sociale në ofrimin e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje (do të thotë Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, Ligji për familje, rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje, etj.). Ligji nr. 2005/02- L17 i Kuvendit të Kosovës për shërbimet sociale dhe familjare nën rregullimin e shërbimeve për personat dhe familjet në nevojë duke përkufizuar personat në nevojë si viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit me genie njerëzore. Prandaj viktimat e dhunës në familje kanë të drejtën e mbrojtjes sociale përfshirë asistencën sociale, këshillimin dhe asistencën materiale në rastet kur ka fonde (neni 1.4 dhe 2.10). Tutje, ligji i Kosovës për familje përcakton Qendrat për Punës Sociale si autoritet kujdestar për fëmijët nevojtar të mbrojtjes sociale (rregullorja e UNMIK-ut 2006/07 që shpall Ligjin për familje të Kuvendit të Kosovës 2004/32, neni 6, paragrafi 2. Për përshkrimin më detal të mandatit të QPS-ve në përfaqësimin e interesave të fëmijëve, shih RrGGK, *Hulumtimi kërkimor* (2008), aneksi për kornizën ligjore.

“[K]ur thërrasim QPS-në, ata thonë, “Nuk kemi veturë për ta dërguar viktimën në spital”, por kur viktimë shkon në cilindo institucion atëherë është e domosdoshme të jetë e shoqëruar nga ata. Ose kur kërkojmë të na dërgojnë ndonjë gjë, thonë, “Nuk mundemi sepse nuk kemi telefaks apo qasje në email”.
– Drejtori i strehimores

Prej 60 viktimave të dhunës në familje që kanë pranuar asistencë nga QPS-ja, 77 për qind ndihen se ishin trajtuar mirë nga punëtori social. Ata thanë se punëtorët social dëgjonin me kujdes, i këshillonin për të drejtat e tyre, ofruan këshillim, i ndihmuan për të gjetur vendstrehim dhe i mbështetën për të përmirësuar gjendjen e tyre financiare duke i ndihmuar kompletimin e dokumentacionit për asistencë sociale ose për banim në shtëpi për të vjetrit. Disa klientë gjithashtu përmendën asistencën që kanë pranuar nga QPS në sigurimin e kujdestarisë së fëmijëve.

Si pjesë e përgjegjësive të tyre për pajtim nën nenin 59 të Ligjit për familjen, QPS-të kanë inkurajuar disa viktimë të dhunës në familje të intervistuar nga RrGGK që të pajtohen dhe bashkohen me kryesin. Përderisa disa të anketuar ishin të kënaqur me këshillat e pranuar, gjysma thanë se nuk ndiheshin rehat me presionin e aplikuar nga QPS-të për pajtim. Siç komentoi një grua, “ata kurrë nuk kanë qenë në këpucët e mia.”²⁷ Tutje, synimet e QPS-së që të pajtojë qiftet në mosmarrëveshjet familjare që prekin fëmijët, në pajtim me mandatin e tyre, ka kontribuar në vonesë të gjykimeve.²⁸

Trembëdhjetë për qind e të anketuarve që kanë pranuar asistencë nga QPS-të kanë ndjerë se nuk ishin trajtuar mirë nga punëtorët social. Ata thanë se punëtorët social nuk i besonin se çfarë i ka ndodhur atyre dhe nuk doni që t’i ndihmonin. “Ndihesha shumë keq”, tha një grua.²⁹ “I tregova për përvojën time të dhunshme por nuk më besuan... Askush nuk mund të gënjejë në rrëfimet sikurse i imi.” Të anketuarit tjerë thanë se QPS i ka ofenduar: “Një grua atje më tha se ishin lodhur nga ne sepse ne fjalosemi me burrat tanë e më pas QPS duhet të na ndihmojë. Nuk shkova më atje dhe ata nuk më ndihmuan me asgjë.”³⁰ Mungesa e mëtejme e profesionalizmit ishte treguar në raste tjera kur punëtori social bëri viktimën që të tregojnë rastin e saj personal me potencial ri-traumatizimi në një sallë me plot njerëz.

Rekomandimet e dobëta të bëra nga QPS-të në rastet e gjykatës civile mund po ashtu të kenë ndikim negativ mbi viktimat. Një rast i shpjeguar nga një përfaqësues i vendstrehimit illustroi këtë pikë:

Ekziston një rast i gruas që është 80 vjeçare. Ajo u martua para 50 viteve dhe nuk kishte fëmijë, por jetoi dhe u kujdes për fëmijët e burrit që i kishte me gruan tjetër. Burri i kishte vdekur para katër viteve dhe ata nuk kishin certifikatë kurorëzimi. Tani djali i burrit dhe fëmijët e larguan nga shtëpia dhe dëshirojnë që ta dërgojnë

²⁷ Intervista e RrGGK me gra multietnike, moshë 36-45, gusht 2009.

²⁸ Intervistat e RrGGK me një gjykatës civil dhe viktimë të dhunës në familje, gusht 2009.

²⁹ Intervista e RrGGK me një grua shqiptare, moshë 36-45, gusht 2009.

³⁰ Intervista e RrGGK me një grua shqiptare, moshë 36-45, gusht 2009.

në shtëpinë e pleqve pa i dhënë të drejtën e pronës ku kishte kontribuar për 50 vite. QPS është duke mbështetur [fëmijët] duke thënë se ajo nuk ka dokumente për të dëshmuar se ishte e martuar dhe kishte kontribuar për 50 vite. ... Rasti shkoi në polici por ata varen nga raporti nga QPS. Rasti është ende... nën hetim. Ne [në vendstrehim] ndjejmë se QPS ndikohet nga tradita dhe është e afërt me kryesin. Mund të gjejmë dëshmitarë që të dëshmojnë për martesën e saj.³¹

Përfaqësuesit e institucioneve tjera publike shprehin brengë se QPS-të nuk trajtojnë gjithmonë klientët “seriozisht dhe me respekt”;³² nuk vinë në gjykatë për rastet me të miturit;³³ janë të ngadalshëm në përgjigje dhe në asistim;³⁴ nuk vlerësojnë me saktësi të ardhurat e familjes me qëllim të njoftimit të gjykatës;³⁵ nuk sigurojnë të drejtën e grave për të vizituar fëmijët përkundër aktvendimit të gjykatës;³⁶ janë pasiv në monitorim të situatës së klientit;³⁷ dhe tregojnë nepotizëm.

Këto mangësi nuk janë plotësisht gabim i punëtorëve social, që përballën me vështirësi operative dhe teknike që ndikojnë në aftësinë e tyre për të përmbushur si duhet përgjegjësitë e tyre. Të anketuar të shumtë thanë se QPS-të kanë kushte të vështira pune dhe buxhet të pamjaftueshëm.³⁸ Si rezultat, QPS-të përballen me mungesë të automjeteve, telefonave, përfshirë telefonat celularë emergjent për punëtorët social në detyrë, karburantit, lidhjes në internet, dhomave private për intervistim të viktimave të dhunës në familje, dhe personel dhe të gjitha këto ndikojnë në aftësinë e tyre që të ofrojnë asistencë cilësore dhe me kohë. Të anketuarit theksuan nevojën për QPS-të që të kenë më shumë punëtorë profesional social që kanë specializuar në punën vetëm me rastet e dhunës në familje.

Siguria dhe mbështetja gjatë qasjes në drejtësi: vendstrehimet dhe organizatat tjera

Në pajtim me Ligjin për shërbimet sociale dhe familjare (nr. 02/l-17), organizatat joqeveritare (OJQ-të) mund të kontraktohen nga Departamenti i mirëqenies sociale (DMS) për të ofruar shërbime sociale dhe familjare për personal nevojtar, përfshirë viktimat e dhunës në familje.³⁹ Shtatë vendstrehime të OJQ-ve janë licencuar nga DMS për të ofruar shërbime dhe janë duke operuar në gjashtë regjione të Kosovës. Që nga viti 2005, DMS ka financuar gjysmën e kostove të çdo vendstrehimore operacionale, përderisa dona-

³¹ Intervista e RrGGK me përfaqësues të vendstrehimit, gusht 2009.

³² Intervista e RrGGK me një gjykatës, gusht 2009.

³³ Intervista e RrGGK me avokat të viktimës, gusht 2009.

³⁴ Intervistat e RrGGK me një oficer të Policisë së Kosovës, prokuror dhe përfaqësues të vendstrehimit, korrik-gusht 2009.

³⁵ Intervista e RrGGK me përfaqësues të vendstrehimit, gusht 2009.

³⁶ Intervista e RrGGK me përfaqësues të vendstrehimit, korrik 2009.

³⁷ Intervistat e RrGGK me oficerë të Policisë së Kosovës dhe avokat të viktimës, gusht 2009.

³⁸ Intervistat e RrGGK me përfaqësues të institucioneve të ndryshme.

³⁹ Kjo pjesë nxirret nga shkrimi i mëhershëm i RrGGK-së për strehimoret dhe institucionet tjera përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve viktimave të dhunës në familje. Për më shumë informata, ju lutem shihni *Siguria fillon në shtëpi*, f. 88-90 dhe hulumtimin shpjegues f 60-64.

torët kryesor ndërkombëtar kanë mbuluar kostot tjera. Vendstrehimet vazhdojnë që të përpiqen të sigurojnë fonde të mjaftueshme për të përmbushur nevojat themelore të viktimave, dhe kanë mungesë të fondeve për monitorim afatgjatë ose programe më të avancuara për reintegrim.

Të gjitha vendstrehimet ofrojnë strehim të sigurt, veshmbathje, artikuj tualeti, kujdes primar shëndetësor, këshillim individual/grupor, këshillim martesor, këshilla ligjore, trajnim për aftësi, vetëdijesim për çështje të ndryshme, dhe mundësi arsimimi. Në mungesë të çfarëdo forme të programit për mbrojtje të dëshmitarëve,⁴⁰ vendstrehimet ofrojnë shërbime thelbësore për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre. Vendstrehimet kanë të strehuar qindra gra e fëmijë secila (shih tabelën më poshtë). Viktimat e të dhunës në familje që qëndruan në vendstrehime thanë se ishin trajtuar mirë nga personeli i vendstrehimit dhe ndiheshin të sigurt dhe të mbështetur emocionalisht.⁴¹

Numri i viktimave të dhunës në familje të strehuara nga shtëpitë e sigurta në Kosovë, 2000 – 2009 (gusht)

Vendstrehimi	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	Total
Qendra për mbrojtje të grave dhe fëmijëve (Prishtinë dhe Mitrovicë)	15	13	10	27	24	23	26	105	142		385
Qendra e mirëqenies së gruas (Pejë)			3	68	110	91	90	89	106	35	592
Shtëpia e sigurt (Gjakovë)	28	82	61	55	66	50	54	58	70	45	569
Qendra për strehim të grave dhe fëmijëve në Prizren			10	52	60	47	46	30	41	31	317
Shpresë dhe shtëpi për fëmijët (Prishtinë) ⁴²			55	189	194	180	220	171	86		1095
Liria (Gjilan)				53	69	87	91	97	101	95	593

Në kuptim të qasjes në drejtësi, roli kryesor i vendstrehimeve është ofrimi i sigurisë së viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre, sipas nevojës, para gjatë dhe pas procedurës gjyqësore. Përmes këshillimit individual dhe grupor, ato gjithashtu ofrojnë mbështetje psikologjike për gratë pasi që përjetojnë vështirësi dhe periudha traumatizuese në jetën e tyre. Vendstrehimet kanë ofruar këshilla ligjore dhe përfaqësim ligjor për klientët, por ishin më aktive në ofrimin e shërbimeve të tilla para themelimit të Sistemit për ndihmë juridike dhe instalimin e AV-ve. Tani vendstrehimet koordinojnë me këto institucione me qëllim që të sigurojnë se klientët e tyre kanë qasje në përfaqësim ligjor.

⁴⁰ Ministria e drejtësisë financon një Objekt qeveritar të përkohshëm të sigurisë për viktimat e “rrezikut të lartë” të trafikimit. Sidoqoftë viktimat e dhunës në familje nuk kanë të drejtën që të qëndrojnë atje dhe nuk duhet të banojnë me viktimat e trafikimit për shkak të specifikacioneve të ndryshme të nevojave.

⁴¹ Intervistat e RrGGK me viktimat e dhunës në familje që kanë qëndruar në vendstrehime, gusht 2009. Tre klientë kanë vërejtur nevojën për vendstrehime që të ofrojnë kushte më të mira për fëmijët si për shembull më shumë aktivitete. Përfaqësuesit e institucioneve kanë kërkuar kushte më të mira të përgjithshme të jetesës në vendstrehime (Intervistat e RrGGK, korrik-gusht 2009).

⁴² Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijët, që është vendstrehimi i vetëm për fëmijët, ka pasur vendstrehim edhe në Prizren por që u mbyll në dhjetor 2007 për shkak të fondeve të pamjaftueshme. Tabela është gjithëpërfshirëse.

Numri i klientëve që pranojnë shërbime juridike nga vendstrehimet / OJQ-të

Vendstrehimet/OJQ	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	Total
Qendra për strehim të grave dhe fëmijëve	1	4	10	4	1	4	4	13	14	10	65
Qendra e mirëqenies së gruas				13	17	53	40	56	89	28	296
Shtëpia e sigurt Gjakovë	46	69	66	73	69	66	69	60	60	46	624
Qendra për strehim të grave dhe fëmijëve						18	13	15	18	20	84
Liria				113	121	130	140	103	175	150	932
Medica Kosova		6	6	10	4	6	5	5	4		46

Siç u përmend, vendstrehimet gjithashtu koordinojnë ngushtë me institucionet tjera që asistojnë viktimat e dhunës në familje siç janë QPS-të dhe Policia e Kosovës, që kanë sistemet e referimit dhe procedurat e vendosura për bashkëpunim. Sidoqoftë sistemet dhe procedurat mund të përfitojnë nga qartësimi i mëtejshëm, përfshirë vendosjen e procedurave mbarë kosovare të përdorura nga të gjitha vendstrehimet dhe institucionet. Për shembull, Procedurat Standarde Operative të ngjashme me ato të vendosura për Viktimat e Trafikimit mund të përcaktojnë procedura të qarta për monitorimin e rasteve të transferuara nga një vendstrehim në tjetrin si dhe për bashkëpunim në mes të vendstrehimeve dhe organizatave dhe institucioneve tjera në Kosovë dhe gjetiu.⁴³

Përfaqësues të shumtë të institucioneve kanë identifikuar nevojën për një ligj për vendstrehimet për të rregulluar strehimin e viktimave.⁴⁴ Duke marrë në konsideratë se shumica e vendstrehimeve janë kanë probleme financiare, kjo do të kërkojë qartësimin e financimit afatgjatë për vendstrehimet. Megjithatë zbatimi i plotë i ligji ekzistues për shërbimet familjare dhe sociale⁴⁵ që parasheh nën kontraktimin qeveritar të shërbimeve të ofruara nga vendstrehimet nga qeveria, duhet të zbatohet plotësisht.

“Viktimat janë fitimtar të ligjit, por njëkohësisht janë humbës. Ata iniciojnë [procedurat e] shkurorëzimit dhe e fitojnë, por çka më pas? Kanë mungesë të strehimit, punësimit dhe varet nga të afërmit. Atyre duhet siguruar asistencë sociale, arsim, punësim dhe shërbime falas me qëllim që të jenë me të vërtetë fitimtar”. – Jurist

Disa të anketuar gjithashtu kanë kërkuar themelimin e vendstrehimeve qeveritare, në veçanti për viktimat që refuzonin të respektonin rregullat e vendstrehimeve të OJQ-ve. Gjithashtu është identifikuar nevoja për më shumë vendstrehime të hapura, e jo vendstrehime kryesisht të mbyllura, ashtu që viktimat mund të vinë dhe të integrohen lirshëm në shoqëri. Një numër i madh i të anketuarve shprehën nevojën për zgjidhje më afatgjata të banimit për viktimat e dhunës në familje, që do të mundësonte gratë të

⁴³ Intervistat e RrGGK me përfaqësues të vendstrehimit, gusht 2009.

⁴⁴ Intervistat e RrGGK me 19 të anketuar nga të gjitha institucionet, korrik-gusht 2009.

⁴⁵ Shih Ligjin e Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-17 për shërbimet familjare dhe sociale e shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2005/46,

ndjekin drejtësinë duke ofruar mundësi atyre që të jetojnë si të pavarura.⁴⁶ Disa të anketuar shprehën nevojën për asistencë të përmirësuar sociale; aftësim profesional; arsimim; fuqizim; këshillim për viktimat, kryerësit, çiftet dhe familjet; dhe asistencë në sigurimin e punësimit për viktimat si pjesë e programit multidimensional të reintegrimit. Disa përfaqësues të institucioneve kanë rekomanduar themelimin e vendstrehimeve për kryesit, ashtu që ligji të zbatohet më mirë dhe viktimat të mos largohen nga shtëpitë e tyre.⁴⁷

Përveç vendstrehimeve, OJQ-ve tjera që udhëhiqen nga gratë kanë ofruar këshillim juridik, përfaqësim dhe mbështetje për viktimat e dhunës në familje që të kenë qasje në drejtësi. Shoqata e Juristeve Norma ka ofruar ndihmë juridike për rreth 550 klientë që merren me rastet e dhunës në familje në mes viteve 1998 dhe 2009.⁴⁸ Përmes vizitave në viset rurale për të ofruar kujdes shëndetësor psikologjik dhe fizik për gratë dhe vajzat, Medica Kosova gjithashtu ka luajtur rol të rëndësishëm në inkurajimin e grave për të folur rreth dhunës që ato përjetojnë dhe kërkojnë drejtësi. Përderisa juristët e Medica Kosova kanë ndihmuar 46 gratë në ndjekjen e drejtësisë që nga viti 2001, numri i klientëve që kërkojnë asistencë juridike ka rënë gjatë viteve pasi që viktimat kanë humbur besimin në sistemin e gjyqësisë, kanë thënë përfaqësuesit e Medica Kosova.⁴⁹

Sa i përket bashkëpunimit të përgjithshëm në mes të institucioneve dhe organizatave të përshkruara në këtë kapitull, referimi i rasteve në mes të punëtorëve social, AV-ve, policisë dhe vendstrehimeve duket se funksionon më mirë sesa gjykatat. Disa mbrojtës të viktimës janë ankuar se duke marrë parasysh punën e tyre direkt me viktimat, ata duhet të kenë qasje më të mirë të gjyqtarët dhe prokurorët të cilët duket se injorojnë rolin e AV-ve. Tutje, AV-të dhe punëtorët social u ankuan se policia ndonjëherë nuk i kontakton ata në kapacitetin e mbrojtësit të të drejtave të viktimave. Një punëtor social tha:

Kishte raste kur vjehrra bënte presion mbi nusen kurse djali i saj jetonte jashtë vendit [në diasporë]. Policia shkoi dhe dërgoi nusen te babai i saj. Ne u njoftuam për këtë rast pas dy javësh kur ajo erdhi te ne në zyrë për të kërkuar asistencë ekonomike. Ne i shpjeguam se ajo kishte të drejtën të na kontaktojë përmes policisë. Policia e raportoi këtë rast si shkurorëzim e jo si rast i dhunës në familje. Pasi që ne njoftuam nusen për të drejtat e saj, ajo përsëri kontaktoi policinë. Pas kësaj morëm raportin prej tyre.⁵⁰

Ende kërkohet koordinim më i mirë nga mekanizmat referues në mes të të gjitha agjencive që asistojnë në mbrojtjen e të drejtave të viktimave me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të viktimave të dhunës në familje. Mekanizmat e tillë duhet të përkufizojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e çdo pale në pajtim me ligjin e aplikueshëm, si dhe të përcaktojnë procedurat operative për reagim të përmirësuar dhe të koordinuar në nivel regional dhe mbarë kosovar. Trajnimet multidisiplinore gjithashtu përmirësojnë komunikimin në mes të të gjitha institucioneve të përfshira.

⁴⁶ Intervistat e RrGGK me mbi 15 përfaqësues të të gjitha institucioneve, korrik-gusht 2009.

⁴⁷ Intervistat e RrGGK me oficer të Policisë së Kosovës, gjykatës dhe AV, korrik-gusht 2009.

⁴⁸ RrGGK intervistë telefonike me përfaqësuesin e Shoqatës së Juristeve Norma, gusht 2009.

⁴⁹ RrGGK intervistë telefonike me një përfaqësues të Medica Kosova, gusht 2009.

⁵⁰ Intervista e RrGGK, gusht 2009.

më shumë se vetëm ‘Fjalë’ në LETËR’?

KAPITULLI 6. PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI QASJEN NË DREJTËSI

KAPITULLI 6. PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI QASJEN NË DREJTËSI

Mundësia e viktimave të dhunës në familje që të qasen në drejtësi varet shumë nga vendimi për të raportuar dhunën që janë duke përjetuar. Pa këtë hap të parë kyç, ato shpesh mbesin viktimë duke vuajtur pambarim në heshtje. Prandaj është thelbësore që të identifikohet dhe të fitohet kuptim më i qartë i arsyeve pse qytetarët munden ose nuk munden të raportojnë dhunën. Perceptimi i qytetarëve për sistemin e gjyqësisë dhe qasja në drejtësi mund të ndikojë në vendimin e tyre për të raportuar dhunën ose jo. Ky kapitull ekzaminon arsyetimin e tyre ashtu që vendimmarrësit dhe aktivistët të mund të identifikojnë mënyrat për të shtrirë asistencën gjer te viktimat e dhunës në familje në të ardhmen.

Në përgjithësi qytetarët duket se janë të vullnetit të përdorin ligjin për qasje në drejtësi në rastet e dhunës në familje. Në anketën e ekonomive familjare mbarë kosovare të vitit 2008, RrGGK gjeti se 80 për qind e të anketuarve do të përdornin ligjin nëse përjetojnë dhunë në familje; 15 për qind nuk do ta përdornin, përderisa pesë për qind ishin të pasigurt.¹ Sidoqoftë kur ndodh dhuna në familje, në praktikë viktimat mund të ketë më pak gjasa të raportimit. Afro gjysma e viktimave të dhunës në familje të intervistuar nga RrGGK në vitin 2009 nuk i kanë treguar askujt kur kanë përjetuar dhunën herën e parë. Katërdhjetë për qind kanë përjetuar dhunën më shumë se pesë herë para se t'i tregojnë përfaqësuesve të institucionit publik, dhe afro 30 për qind kanë përjetuar dhunë 16 herë ose më shumë para se ta raportojnë. Gjysma e të anketuarve *kurrë* nuk kanë raportuar dhunën në polici.

Në mesin e arsyeve më të zakonshme që dhanë viktimat për mosraportim të dhunës ose për tërheqje nga rasti ishin tradita dhe dënimi social.² Ato ishin të turpëruara që të raportojnë dhunën në familje duke u frikuar fjalëve të fqinjëve, sepse ishte çështje private dhe/ose ishin të turpëruara. Turpi në veçanti mbizotëronte në mesin e burrave që nuk mund të imagjinojnë se çfarë mund të thonë njerëzit nëse kuptojnë se një burrë dhunohet nga gruaja e tij. “Nuk doja që askush afër meje të kuptojë se gruaja ime përdorë forcën kundër meje”, tha një burrë.³ Natyra e kuptuar private e dhunës në familje dhe turpi ishin dy arsye më të zakonshme të të intervistuarve në anketën mbarë kosovare të RrGGK-së për mos raportim të dhunës. Perceptimet e tilla janë faktorët kryesor që parandalojnë shumë viktimë nga raportimi i dhunës.

Një çështje tjetër e rëndësishme që parandalon viktimat nga kërkimi i drejtësisë ishte frika e pasojave.⁴ Natyrisht se kam pasur frikë, kryesi do të hakmerret për raportim dhe dhuna do të përkeqësohet. “Kunati im përdorte më shumë dhunë sepse policia erdhi të

¹ RrGGK, *Siguria fillon në shtëpi*, p. 60.

² Kjo është theksuar nga më shumë përfaqësues të institucioneve (Intervistat e RrGGK, korrik-gusht 2009).

³ Intervista e RrGGK me një turk, mosha 26-35, gusht 2009.

⁴ Përfaqësuesit e institucioneve gjithashtu kanë vërejtur këtë çështje gjatë intervistave (korrik-gusht 2009).

na vizitohet”, tha një grua. “Vetëm mund të imagjinojë se çfarë do të ndodhë nëse fillon rasti në gjykatë”. Raportimi i dhunës do të përkeqësojë gjendjen, thonë ato.

Faktorët tjerë që në një mënyrë ose tjetër ndikojnë në vendimin e viktimave që të mbesin të heshtur ose të ndalojnë procedurat kush varësia nga kryesit, fakti se nuk kishin vend tjetër ku të shkonin, kuptimi se familjet e tyre nuk do t’i mbështesin, dhe frika se mund t’i humbin fëmijët. Brengat e ngjashme janë vërejtur nga të intervistuarit e anketës mbarë kosovare. Disa përfaqësues të shumtë të institucioneve të intervistuar nga RrGGK në vitin 2009 po ashtu shprehën se varësia ekonomike nga kryesi dhe mungesa e alternativave të qëndrueshme parandalojnë viktimat, në veçanti gratë, nga qasja në drejtësi. Një zyrtar i ndihmës juridike përmbledhi gjendjen që shumë gra viktimat të dhunës në familje përjetojnë:

Kushtet ekonomike vështirësojnë për gra pasi që nuk kanë alternativë të banimit dhe vendstrehimet i mbajnë ato të izoluar... Nuk ka asistencë ekonomike institucionale për viktimat. Kur i kuptojnë këto pengesa, ato gjejnë se zgjidhja gjyqësore nuk do të përmirësojë gjendjen. Nëse ajo shkurorëzohet, ajo nuk do të ketë ku të shkojë. Ajo nuk ka mundësi që të mbulojë kostot e veta ose të jetë e pavarur, dhe për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, ajo shpesh nuk mund të fitojë të drejtat prindërore. Në këto raste ato nuk insistojnë në çfarëdo procesi gjyqësor sepse e dinë se nuk mund të fitojnë. ... Për shkak të traditës ka diskriminim, në veçanti nëse ajo intervistohet ose gjykohet nga gjyqtari mashkull.

Gratë në Kosovë në përgjithësi kanë shkallë më të lartë të papunësisë⁵ dhe të analfabetizimit sesa burrat.⁶ Në pajtim me rolet tradicionale gjinore, gratë duket se janë kujdesësit kryesor të fëmijëve dhe të pleqve,⁷ që ndikon në pjesëmarrje të ulët të tyre në tregun e punës.⁸ Tutje, edhe pse gratë dhe burrat me ligj kanë të drejtat e barabarta për trashëgimi

*“Shumë burra martohen me grua tjetër në këtë lloj situate [kur gruaja nuk lind djem]. Për momentin nuk fitoj asgjë [nëse shkoj].”
- grua shqiptare, moshë 36-45*

të tokës dhe pronës tjetër, sipas praktikave të zakoneve, prona e familjes mbetet te burrat (do të thotë burri, vëllai ose vjehri).⁹ Këta faktorë në veçanti kur të kombinohen mund të ndikojnë në pozitën e gruas brenda familjes së saj. Pozita e tyre në familje ndikon

⁵ Shkalla e papunësisë për gratë e moshës 15-64 është rreth 60 për qind dhe 33 për qind në mesin e meshkujve (raport nga Enti Statistikor i Kosovës, “Gratë dhe burrat në Kosovë, 2008” në dispozicion në http://www.ks.gov.net/esk/esk/pdf/english/general/Pub_grate_burra.pdf (e vizituar në korrik 2009).

⁶ Rreth 44.3 për qind e grave rurale kanë kryer vetëm shkollën fillore, 32 për qind kanë kryer shkollën e mesme, dhe vetëm 2.2 për qind kanë vijuar arsimin e lartë, përderisa rreth 50 për qind e burrave kanë kryer arsimin e mesëm. Tutje, përqindja e burrave pa arsimim (3.1 për qind) është gjysma e përqindjes së grave (6.6 për qind). Shkalla e analfabetizimit është tri herë më e lartë në mesin e grave, edhe pse duket se kjo është duke rënë. Shih “Anketën e ekonomive familjare bujqësore” të Entit Statistikor të Kosovës në dispozicion në <http://www.ks.gov.net/ESK/esk/pdf/english/agriculture/Agricultural%20Household%20Survey.pdf>, (e vizituar në korrik 2009).

⁷ Gati gjysma e familjeve të Kosovës përbëhen nga dy gjenerata në ekonominë familjare të njëjtë dhe afro 49 për qind të grave të martuara jetojnë me familjen e burrit. Shih UNFPA, “Profili demografik i Kosovës,” në dispozicion në <http://www.unfpa.org/demographicProfile.htm>.

⁸ RrGGK, *Siguria fillon në shtëpi*, p. 72.

⁹ RrGGK, *Siguria fillon në shtëpi*.

në mundësinë që të raportojë dhunën në familje dhe opsionet që kanë në dispozicion pasi që të kërkojnë drejtësi.

Arsyet tjera që kanë dhënë viktimat e dhunës në familje për mos raportim të dhunës ose për ndalim të procedurave gjyqësore përfshinë arsyen se nuk janë zyrtarisht të martuara (duke keqkuptuar qartë përkufizimin e lidhjes familjare dhe të drejtat e tyre), nuk donë të raportojnë ndonjë familjar, dëshirojnë të adresojnë dhunën në mënyrë tradicionale ku meshkujt në komunitet ndërmjetësojnë, ende shpresojnë se mund të zgjidhin çështjet vet, kanë burrat jashtë Kosovës dhe nuk mund të arrestohen, nuk dinë si të fillojnë procedurat gjyqësore, dinë se nuk mund të sigurojnë pronën, trashëgiminë ose pasurinë nëse raportojnë dhunën, dhe mendojnë se merr shumë kohë në sistemin aktual të drejtësisë për të zgjidhur situatën.

“Është më mirë të vdesësh sesa të shkosh prej derës në derë [për të kërkuar drejtësi].”

- Grua shqiptare, moshë 36-45

Çfarë është brengosëse se pas tentimit të parë për të ndjekur drejtësinë, afro një e treta e të anketuarve thanë se nuk do ta përdorin sistemin e gjyqësisë përsëri, dhe 21 për qind ishin të pasigurt. Shumica shpjeguan se ishin të zhgënjyer në sistemin e gjyqësisë që nuk i ka siguruar drejtësi herën e parë. Siç komentoi një grua, “nuk ka drejtësi për viktimat e dhunës në familje.”¹⁰ Arsyet tjera për mos ndjekje të drejtësisë në të ardhme përfshinë: mentalitetin ose thashethemet nga të tjerët, në veçanti kur institucionet nuk mbajnë informatat konfidenciale, ato nuk kanë ku të shkojnë pas gjykimit, do t’ia dalin jetesës me dhunë, dhe procedurat e përzgjatura vështirësojnë ndjekjen e drejtësisë. Për shembull një grua tjetër tha se me zgjatjen e procedurës gjyqësore ajo ju përball me presion në rritje nga familjarët për të tërhequr rastin.¹¹

Viktimat e dhunës në familje kanë pasur ankesa të shumta lidhur me vet sistemin e drejtësisë. Përderisa disa nga brengat e tyre rrjedhin nga thashethemet ose perceptimet e gjëra shoqërore, të tjerët bazoheshin në përvojën e mëhershme. Një e treta e viktimave thanë se gjykatat ishin të korruptuara, marrin para për të përpunuar rastet (më shpejtë), ryshfeti është i domosdoshëm për të fituar rastet, dhe nepotizmi është mbizotërues (“duhet të dini dikë për ta kryer rastin me kohë ose që të keni gjykim të drejtë”). “Nëse dikush nuk ka miq ose të afërm që punojnë në gjykatë, ata kurrë nuk do të iniciojnë rastin, ka thënë një grua. Jam i bindur sepse jam duke pritur më shumë se një vit për të marr ftesën nga gjykata për rastin time” tha një grua.¹² Arsyet e dytë pse viktimat janë nguruese që të ndjekin drejtësi është se procedurat zgjasin shumë, vonohen ose kurrë nuk kryhen. Arsyet tjera ishin se pagesat e gjykatës ishin shumë të shtrenjta, raportimi i rastit nuk do të përmirësojë gjë sepse asnjë veprim nuk do të ndërmerret, dhe institucionet nuk do ta mbajnë informatën konfidenciale.

“Kush ka më shumë para ka më shumë mbështetje.” – Grua shqiptare, moshë 36-45

¹⁰ Intervista e RrGGK me grua shqiptare, moshë 26-35, gusht 2009.

¹¹ Intervista e RrGGK me grua shqiptare, moshë 26-35, gusht 2009.


¹² Intervista e RrGGK me grua shqiptare, moshë 26-35, gusht 2009.

Për të ardhmen, çfarë veprimesh mund të ndërmerren nga vendimmarrësit dhe aktivistët për të inkurajuar viktimat e zhgënjyera që të përtërijnë tentimet e veta në qasje në drejtësi ose që të kërkojnë drejtësi për herë të parë? Një hap i rëndësishëm i parë është sigurimi që qytetarët të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre ligjore si dhe shërbimet që i kanë në dispozicion. Gati gjysma e të anketuarve në anketën mbarë kosovare të RrGGK-së në vitin 2008 nuk dinin se ekzistonte Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje, gjë që ilustron qartë nevojën për të edukuar qytetarët rreth mekanizmave ekzistues të dizajnuar për mbrojtje të tyre, siç janë urdhrat për mbrojtje.¹³ Duhet qartësuar faktin se dhuna është krim dhe nuk duhet toleruar as në sferën publike as në private të shtëpisë. Mediat, shtrirja nëpër shkolla dhe përdorimi i iniciativave tanimë ekzistuese në bazuara në komunitet janë mënyra potencialisht efektive për të shpërndarë informatat e tilla te publiku.

Duke marrë parasysh perceptimet mbizotëruese se dhuna në familje është e turpshme dhe/ose private, dëshmitë tregojnë se viktimat e dhunës në familje shpeshherë i afrohen miqve, familjes ose organizatave joqeveritare (OJQ) për kërkim të asistencës për herë të parë. Në mesin e viktimave të intervistuar, 82 për qind së pari i kanë treguar shokut ose një anëtar të familjes për dhunën që ato kanë përjetuar. Prandaj, ka nevojë për të informuar publikun e përgjithshëm lidhur me të drejtën e tyre për të raportuar dhunën kundër njerëzve tjerë; shërbimet që janë në dispozicion për viktimat e dhunës në familje; dhe numrat kontaktues për raportim të dhunës si dhe qasje në forma tjera të asistencës.

Siç ilustron grafiku i poshtëm, kur viktimat e dhunës në familje raportuan dhunën te një institucionin publik ose organizatë, një e treta i treguan OJQ-së së grave, vendstrehimit ose aktivistit.¹⁴ Një e treta tjetër i tregoi policisë. 18 për qind raportuan dhunën te Qendra

Institucionet ku viktimat kanë raportuar për herë të parë dhunën në familje




¹³ RrGGK, *Siguria fillon në shtëpi*, f. 60.

¹⁴ OJQ-të e grave mund të jenë paksa të mbipërfaqësuar në këtë shembull duke marrë parasysh se viktimat e intervistuar të dhunës në familje janë identifikuar përmes organizatave të grave.

për punës sociale, kurse nëntë për qind i treguan mjekut. Të tjerët i treguan psikologëve, psikiatrit, avokatëve të viktimave, zyrtarëve për ndihmë juridike ose shokëve të klasës. Me qëllim të lehtësimit të raportimit të dhunës në familje, është me rëndësi për çdo institucion që të ketë profesionistë të aftësuar për të këshilluar viktimat për të drejtat e tyre dhe t’i mbështesë ata në kërkimin e asistencës së mëtejme, nëse nevojitet. Të gjithë shërbyesit civil duhet të informohen lidhur me detyrimin e tyre ligjor për të raportuar rastet e dhunës në familje si dhe t’iu ofrohen udhëzime të qarta procedurale prë të bërë këtë. Trajtime të detyrueshme për të dalluar shenjat e dhunës na familje, legjislacionin kundër dhunës në familje, dhe ndjeshmëria ndaj nevojës që kanë viktimat e dhunës në familje, e në veçanti fëmijët, janë thelbësore për mësuesit dhe praktikuesit mjekësor të cilët mund të jenë pika e parë e kontaktit me viktimat e dhunës në familje.

Në përgjithësi, performanca e institucioneve të ndryshme në ofrimin e mbrojtjes dhe qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në familje ka qenë disi e përzier. Siç ilustron grafiku në faqen e ardhshme, viktimat e dhunës në familje ishin më së shumti të kënaqura me punën e personelit të vendstrehimeve. Shumica (91 për qind e të anketuarve) thanë se janë trajtuar “mirë” ose “shumë mirë” nga personeli i vendstrehimeve dhe asnjëri nuk ndjeu se ishin trajtuar dobët. Në përgjithësi ndjenin se kanë pasur përkujdesje të mirë nga Zyrtarët për Ndihmë Juridike (87 për qind e të anketuarve), punëtorët social (80 për qind), Avokatët e Viktimës (76 për qind), dhe juristët (72 për qind). Vetëm 66 për qind e të anketuarve ishin të kënaqur me gjyqtarin dhe vetëm 51 për qind me policinë.

Si u ndien viktimat e dhunës familjare kur u trajtuan nga institucionet



Anasjelltas, 23 për qind e të anketuarve ndjenë se ishin trajtuar “keq” ose “shumë keq” nga policia (17 për qind), gjyqtarët (16 për qind), punëtorët social (14 për qind), avokatët e tyre (8 për qind), Avokatët e Viktimës (8 për qind), ose Zyrtarët e tyre për ndihmë juridike (6 për qind). Është e qartë se ka vend për institucionet që të përmirësojnë punën e tyre. Është thelbësore që të gjitha institucionet e përfshira në ofrimin e asistencës për viktimat e dhunës në familje t’i trajtojnë ata me respekt dhe mirëkuptim, jo vetëm për të siguruar qasje të duhur në drejtësi, por edhe të inkurajojnë raportimin e dhunës së përsëritur ose të re.

Në përmbyllje, nëse policia dhe gjykatat zbatojnë masat dhe dënimet e parapara nga procedurat penale dhe civile, viktimave do t’i ofroreshin zgjidhje të menjëhershme dhe afatmesme për çështjet që kanë të bëjnë me stabilitetin ekonomik gjer te kujdestaria e fëmijëve dhe prona. Çfarë është më e rëndësishmja është se ata do të mbrohen nga dhuna e përsëritur. Pastaj, pas 12 muajve fillestar të Urdhrit për Mbrojtje, institucionet mund të kontribuojnë në zgjidhjet afatmesme për viktimat duke përmirësuar cilësinë dhe llojet e shërbimeve të ofruara përmes përgjigjes multidimensionale të ndër-agjencive. Asistenca e ngritur sociale, këshilldhënia psikologjike, zgjidhjet e qëndrueshme të banimit, arsimimi shtesë, aftësimi profesional dhe mbështetja direkte në gjetjen e punësimit mund t’i sigurojë viktimave mbështetjen e domosdoshme për reintegrim në jetën pa dhunë. Në të kundërtën pa përgjigje qeveritare ndaj dhunës në familje që është zemërgjerë, e ndjeshme dhe e shpejtë, viktimat do të vazhdojnë që të kenë disa opsione pasi që të kenë kërkuar drejtësinë dhe me siguri se do të mbesin të heshtura. Duke siguruar mbështetje para, gjatë dhe pas procesit të qasjes në drejtësi, institucionet mund të dërgojnë porosi të qartë se kryesit do të dënohen për veprimet e tyre dhe çfarë është më e rëndësishmja, të rifitojnë besimin e viktimave të dhunës në familje në kërkimin e tyre të drejtësisë.

REKOMANDIME

Për gjykatës dhe prokurorë:

- Gjykatësit duhet të përgjigjen me kohë me lëshimin e urdhrave mbrojtës (UM) siç kërkohet me ligj. Vonesat rrezikojnë sigurinë dhe mirëqenien e viktimave, duke qenë në kundërshtim me qëllimin e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje. Caktimi i një gjyqtari për të lëshuar UM në gjykatat komunale në Gjilan dhe Pejë ka kontribuar në zvogëlimin e vonesave. Caktime të ngjashme në gjykata tjera do të përshpejtonin lëshimin e UM-ve dhe do t’iu mundësonte gjykatësve që të fitojnë përvojën e nevojshme. Pas një rekomandimi të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Kryetari i çdo Gjykate Komunale duhet të caktoj një gjykatës që të mirret ekskluzivisht me rastet që kanë të bëjnë me lëshimin e UM-ve. Një vendim i tillë duhet të marrë parasysh që gjyqtarët do të vazhdojnë të merren me rastet tjera civile, por kjo do ta përshpejtonte specializimin e disa gjykatësve në nivel komunal ashtu që ata do të mund të mbronin viktimat më me efikasitet dhe më shpejtë.
- Kur kryesit e dhunës në familje shkelin masat e lëshuara nga UM, gjyqtarët shqiptojnë gjoba të buta siç janë gjoba prej 200 Euro ose kurrfarë dënimi. Dënimet e ulëta kanë kontribuar në rastet e recidivizmit dhe hezitimit për të raportuar dhunën. Shkeljet e UM-ve duhet të kuptohen me seriozitet se si aktet e dhunës në familje ndikojnë te viktimat. Prandaj gjyqtarët duhet të shqiptojnë dënimet në pajtim me kërkesat e ligjit të aplikueshëm, varësisht nga rëndësia e aktit të kryer. Në rastet e recidivizmit, bduhet zbatuar dënimin me burg, aty ku e parasheh ligji.
- Varësisht nga aktet e veçanta që shfaqen në rastin e dhunës në familje, gjyqtarët duhet të shqiptojnë masat për të akomoduar nevojat e viktimës. Pasi që gjyqtarët janë të kufizuar nga masat e kërkuara nga viktimat, juristët e AV-ve mund të luajnë një rol thelbësor në këshillimin e viktimave mbi masat e ofruara me Rregulloren kundër dhunës në familje. Zbatimi i plotë i këtyre masave mund të mbështetë mirëqenien afatgjate socio – ekonomike të viktimës dhe siguron zbatimin përkatës të ligjit në pajtim me kërkesat e ligjit të zbatueshëm.
- Lëshimi i UM-së me aktvendime të arsyetuara jo mjaft shkelë garancitë themelore procedurale të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare. Me qëllim të garantimit të të drejtave të shkelësit në gjykim të drejtë dhe për të zvogëluar mundësinë e shfuqizimit të aktvendimit kundër viktimës kur ekziston dëshmia e dhunës në familje, gjyqtarët duhet të shohin garancitë procedurale duke shpallur aktvendime mjaft të detajuara dhe të informuara në pajtim me kërkesat e ligjit të aplikueshëm.
- Ndjekja penale *ex officio* duhet të ndërmerret për shkeljet penale që paraqiten në lidhjet familjare. Me qëllim që të tregohet se shoqëria nuk toleron aktet e tilla dhe do të mbrojë familjen në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, prokurorët duhet të respektojnë kërkesat e ligjit. Njëjtë, ata duhet të ndjekin penalisht rastet e dëmtimeve të lehta trupore dhe të hetojnë tutje rastet e dhunës në familje bile edhe pas lëshimit të UM nëse ka indikacione se ka shkelje penale. KGJK-ja dhe Komisioni Prokurorial i Kosovës duhet të vëzhgojnë nga afër dështimet e ndjekjes dhe aktgjykimet e shqiptuara për të ndërmarrë veprime disiplinore kur ato janë relevante.

- Disa prokurorë duket se tërhiqen shpejtë nga hetimi i mëtejshëm i rastit dhe ndjekja penale e kryesve edhe nëse ligjet penale janë eksplicite në kërkesat e tyre. Neni 226 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës parasheh që ndërprerja ose përmbajtja nga ndjekja penale në shkeljet më pak serioze penale nuk lejohet për rastet që lidhen me dhunën në familje dhe dhunën seksuale. Ligjet penale të Kosovës kërkojnë dënime më të rënda për krimet që paraqiten në lidhjet familjare sesa për krimet e ngjashme që paraqiten në mes të personave jashtë lidhjes familjare. Ligjet janë eksplicite në kërkimin e garancive përmes procedurave penale që kërkojnë respektimin e mbrojtjes së standardeve të të drejtave të njeriut. Prokurorët prandaj duhet të hetojnë tutje shkeljet penale që paraqiten në lidhje familjare dhe të ndjekin penalisht *ex officio* kryesit e akteve të tilla në pajtim me ligjet e aplikueshme. Ata do të japin porosi të qartë se dhuna në familje nuk tolerohet nga shoqëria dhe shoqëria synon që të ndalojë dhunën në familje.
- Në rastet e dhunës në familje, disa prokurorë dhe gjykatës duket se janë ngurues që të ndjekin penalisht ose të vendosin, dhe prandaj rezulton në shqiptime të dënimeve nën dënimet e parapara me ligjin e aplikueshëm. Në shumë raste të krimit me lëndime të rënda trupore, gjykata ka dënuar kryesin me më pak se një vit burgim edhe pse ligji parasheh dënimin gjer në pesëmbëdhjetë vite burgim. Hetimi, ndjekja penale dhe vendimi për kryesit e akteve të dhunës në familje duhet të jetë në pajtim me rëndesën e krimeve të kryera.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës i mandatar për të ngritur kapacitetet e gjykatësve dhe prokurorëve, duhet të vazhdojë me ofrimin e trajnimeve të rregullta mbi legjislacionin kundër dhunës në familje. KGJK-ja duhet të ndërmerret trajnime mbi ligjin e zbatueshëm dhe standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut që ato të jenë të detyrueshme për gjykatës dhe prokurorë në rastet e viktimave të dhunës në familje. Trajnimi duhet të përfshijë metoda senzitive të komunikimit dhe marrjes në pyetje të viktimave, e në veçanti fëmijëve. Tutje, institucionet publike dhe organizatat të cilat punojnë në çështjet e dhunës në familje duhet të mbështesin hartimin e një manuali për trajtimin e rasteve të dhunës në familje i cili i shpjegon si legjislacionin vendor ashtu dhe atë ndërkombëtar dhe obligimet sipas standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.
- Me qëllim që institucionet gjyqësore të Kosovës të jenë në gjendje të gjenerojnë statistika në lidhje me rastet e dhunës në familje, si dhe çështjet tjera, Sistemi i ri informativ i menaxhimit të rasteve i instaluar përgjatë gjithë Kosovës duhet të bëhet operacional menjëherë. Mbledhja e të dhënave demografike dhe të tjera duhet të përcaktohet me ligj në aso mënyre që të dhënat të mbledhen, të ruhen elektronikisht dhe të publikohen në mënyrë efikase, me kohë dhe me saktësi. Sistemi duhet të përfshinë regjistrimin e rasteve të dhunës në familje .

Për mbrojtësit e viktimave:

- Mekanizmat për koordinim dhe referim të agjencive të përfshira në asistim, mbrojtje dhe ruajtje të drejtave të viktimave të dhunës në familje mbesin të dobëta. Prandaj nën udhëheqjen e Divizionit për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministri të Punës dhe Mirëqenies Sociale (për të miturit që janë viktimë të dhunës

në familje) politikat duhet të përkufizojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e çdo pale, përfshirë procedurat operative për përgjigje të përmirësuar dhe të koordinuar në nivel rajonal dhe kombëtar për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

- Mbrojtësit e viktimave kanë për detyrë të ruajnë të drejtat e viktimave dhe në pajtim me nevojat të këshillojnë viktimat për masat e ndryshme të cilat parashikohen me Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje. Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave duhet të hartojë një formular për kërkimin e urdhrit për mbrojtje në të cilin do të radhiten të gjitha masat e parashikuara nga Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje. Ky formular duhet t’u vihet në dispozicion viktimave nga ana e mbrojtësve të viktimave menjëherë pas shprehjes së dëshirës nga ana e tyre për urdhër për mbrojtje.
- Mbrojtësit e viktimave duhet të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në pajtim me ligjin e aplikueshëm. Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave duhet të ofrojë trajnim të vazhdueshëm për ligjin e aplikueshëm (d.m.th. Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje, ligjet penale të Kosovës dhe standardet tjera përkatëse për të drejtat e njeriut). Trajnimi multidisiplinor i mbrojtësve të viktimave dhe agjencive tjera të përfshira, përfshirë Qendrat për Punë Sociale, gjyqtarët, prokurorët dhe policinë, duhet të jetë i vazhdueshëm me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të komunikimit si dhe këmbimit të përvojave në ruajtjen e të drejtave të njeriut.

Për avokatët dhe zyrtarët për ndihmë juridike:

- Avokatët dhe zyrtarët për ndihmë juridike kanë mungesë të kuptimit dhe njohurive për legjislacionin e aplikueshëm që ka të bëjë me dhunën në familje. Trajnime shtesë që për mbrojtësit e viktimave, avokatët dhe zyrtarët për ndihmë juridike duhet të qartësojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre ashtu që të kuptojnë specifikat e mandatit të tyre. Më tej, këmbimi i përvojave mund të ngritë ndjeshmërinë e avokatëve dhe zyrtarëve për ndihmë juridike, ashtu që ata të bëjnë ndërhyrje më të informuara dhe të bazuara në njohuri gjatë mbështetjes së grupeve të rrezikuara siç janë viktimat e dhunës në familje.
- Rreziqet me të cilat përballen viktimat e dhunës në familje si pasojë e akteve të dhunës duhet t’i bëjë ata automatikisht të kualifikohen për ndihmë juridike falas. Më tej, legjislacioni për ndihmë juridike duhet të zbatohet duke u bazuar në kategorinë e grupeve të rrezikuara e jo në bazën “i pari në kohë, i pari me të drejtë”, siç i është shpjeguar RrGGK-së nga disa zyrtarë të ndihmës juridike.
- Ligji i aplikueshëm për aktet e dhunës në familje dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duhet të jenë pjesë specifike e trajnimit të ardhshëm që ofrohet nga Zyra Koordinuese për Ndihmë Juridike dhe Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës. Trajnimi duhet të përfshijë komponentët e përfaqësimit ligjor që është i ndjeshëm ndaj nevojave të viktimave, mbrojtjen e viktimave dhe përfaqësimit të interesave më të mira të viktimës.
- Në rastet kur avokatët shkelin Kodin e Etikës duke përfaqësuar vazhdimisht dobët viktimat, përmes konfliktit të interesit, korrupsionit ose punës së dobët, Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të ndërmerri veprime disiplinore. Monitorimi mund të ndihmojë në sigurimin e punës më të mirë.

Për Policinë e Kosovës:

- Policia është e obliguar me ligj që të njoftojë viktimat për të drejtat e tyre që garantohen nga Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje, përfshirë të drejtën për të kërkuar dhënien e urdhrit për mbrojtje, opsionet e ofruara nga urdhri për mbrojtje dhe shërbimet tjera në dispozicion të viktimave. Njësitë e Policisë së Kosovës Kundër Dhunës në Familje duhet të zhvillojnë fushata vetëdijesimi për të njoftuar opinionin e gjerë dhe viktimat në veçanti për të drejtat e siguruara me ligj. Më tej, në pajtim me Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje, policia duhet të përgatisë dhe të shpërndajë fletëpalosje për të drejtat e viktimave që përfshijnë informata për legjislacionin për mbrojtje kundër dhunës në familje si dhe rolet dhe përgjegjësitë e policisë në pajtim me ligjin e aplikueshëm. Fletëpalosjet duhet të përmbajnë gjuhë të thjeshtë dhe ilustrime të kuptueshme për të gjithë qytetarët, si dhe informatat kontaktuese për agjencitë që mund t’u ndihmojnë atyre. Video spotet, aktivitete nëpër shkolla dhe përpjekje shtesë përmes programeve të policisë në komunitet do të inkurajonin raportimin e dhunës në familje dhe njoftonin qytetarët për të drejtat e tyre.
- Policia shpesh ka dështuar në intervenimin e rasteve të shkeljes së urdhrave për mbrojtje. Nën Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje, policia duhet të monitorojë dhe të përcjellë rastet si pjesë e mandatit të tyre të përgjithshëm për të siguruar, mbrojtur dhe *parandaluar dhunë të mëtejme*. Gjithashtu policia ka vazhduar që të lëshojë UME edhe pse ligji nuk i jep atyre këtë kompetencë. Nevojitet trajnim shtesë për policinë që të kuptojë saktë dispozitat e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje dhe të sigurojë aplikim korrekt të procedurave të saj. Përcaktimi i procedurave të qarta dhe konsistente për përcjellje dhe monitorim të rasteve është themelor.
- Mangësitë në performancën individuale të dhe bashkëpunimi në mes të policisë dhe prokurorëve gjatë hetimeve kanë kontribuar në ngurrim në mesin e viktimave që të raportojnë aktet e dhunës në familje ose të besojnë se sistemit gjyqësor do t’i ofrojë atyre mjete efektive. Rastet e dhunës në familje duhet të prioritizohen; prokuroria dhe policia duhet të bashkëpunojë në mënyrë më efektive në hetime dhe mbledhje të dëshmimeve thelbësore. Policia duhet gjithashtu të përmirësojë teknikat e tyre hetimore, në veçanti në përgjigje ndaj dhunës në familje. Emërimi i policisë gjyqësore, siç kërkohet nga legjislacioni e aplikueshëm penal, duhet të bëhet menjëherë dhe në mënyrë efikase.
- Policia e Kosovës më parë është përballur me probleme në aplikimin e nenit 13 të Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje, që parasheh se policia e UNMIK-ut lëshon urdhra për mbrojtje emergjente të përkohshme. Përderisa kjo kompetencë tani i është bartur Policisë së Kosovës, ligji i kundër dhunës në familje duhet t’i jap Policisë së Kosovës autoritetin për të lëshuar urdhra për mbrojtje emergjente të përkohshme.
- Ndonjëherë reagimi i policisë ndaj thirrjeve emergjente ishte i ngadalshëm. Me qëllim të garantimit të asistencës së shpejtë për viktimat e dhunës në familje, Policia e Kosovës duhet të vendosë një linjë ndihme konfidenciale, e cila funksionon falas dhe 24 orë në ditë për viktimat e dhunës në familje.

Për misionin e EULEX-it dhe organizatat tjera ndërkombëtare:

- Në mandatin fillestar të EULEX-it nuk janë përmendura fare çështjet gjinore dhe çështjet e dhunës në familje nuk janë konsideruar prioritet brenda misionit. Tani për tani, as gjyqtarët e as prokurorët nuk i kanë konsideruar rastet e dhunës në familje si mjaft “serioze” sa për ti monitoruar apo përcjellë ato. Rastet e dhunës së bazuar në aspektin gjinor, si shkelje të drejtave të njeriut duhet të adresohen me seriozitetin e njëjtë, brenda mandatit të EULEX-it, si krimet ndëretnike. Më tej, gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar, preferohet me ekspertizë dhe përvojë në dhunën e bazuar në aspektin gjinor duhet të vëzhgojnë për së afërmi gjyqësorin në këtë drejtim.
- Organizatat të cilat monitorojnë sistemin gjyqësor në Kosovë, siç janë Misioni i OS-BE-së në Kosovë, duhet të vazhdojnë të monitorojnë gjykatat bë baza të rregullta me rastin e trajtimit të rasteve të dhunës në familje për të siguruar përmbushjen e standardeve të drejtave të njeriut. Duke u bazuar në këto aktivitete duhet të hartohen dhe të bëhen publike raporte të rregullta.

Përmirësimi i kornizës së tanishme ligjore

- Në vitin 2008, në raportin *Siguria fillon në shtëpi* RrGGK-ja ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme lëmit për përmirësimin e kornizës ligjore. Në këtë raport, RrGGK-ja ka regjistruar disa mangësi të vërejtura sa i përket ligjit të aplikueshëm dhe ofrimit të mbrojtjes efektive viktimave të dhunës në familje dhe ndjekjes penale të kryesve të atyre veprave. Situata para dhe pas rekomandimeve duhet të shqyrtohet nga Grupi punues në zyrën e Kryeministrit i ngarkuar me detyrën e hartimit të ligjit të ri të Kosovës për mbrojtjen kundër dhunës në familje si dhe në rishikimin e legjislacionit tjetër i cili është i ndërlidhur me dhunën në familje.
- Afro 38% e të anketuarve nga institucionet direkt të përfshira në asistimin e viktimave të dhunës në familje nuk dinin se Qeveria e Kosovës ishte duke hartuar Ligjin e ri kundër dhunës në familje për të zëvendësuar rregulloren e UNMIK-ut kundër dhunës në familje. Prej atyre që kishin njohuri, shumica kishin mësuar për këtë draft nga mediat. Vetëm disa ishin ftuar që marrin pjesë në proces. Të anketuarit, në veçanti gjyqtarët, shprehën brengën se nuk ishin ftuar për të marrë pjesë në proces. Duhet bërë përpjekje për të siguruar se të gjitha palët e interesuara marrin pjesë në proces, gjë që mund të përmirësojë zbatimin e ligjit në të ardhmen.
- Një nga çështjet kryesore të ngritura nga përfaqësuesit e institucioneve ishte se akti i dhunës në familje nuk është përkufizuar *per se* në Kodin Penal të Kosovës (KPK). Më tej, jo të gjitha aktet e dhunës në familje të përcaktuara në Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje janë përkufizuar si akte penale në Kodin Penal të Kosovës. Policët kanë thënë se është vështirë të aplikohet në praktikë një rregullore që nuk dënon të gjitha aktet e dhunës në familje. Gjykatësit dhe prokurorët kërkuan që ligjet penale të Kosovës të ndryshohen dhe plotësohen për të përfshirë dhe përkufizuar aktet *per se* të dhunës në familje në legjislacionin penal të Kosovës duke hartuar një Kapitull të ndarë që lidhet me shkeljet penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Grupi punues i mandatuar me hartimin e ligjit të ri për mbrojtje kundër dhunës në

- familje duhet të analizojë këtë mundësi në konsultim të ngushtë me gjyqtarët dhe prokurorët. Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit penal për të inkorporuar përkufizimin e krimin *per se* të dhunës në familje, duke përdorur përkufizimet e akteve të parapara në Rregulloren për mbrojtje kundër dhunës në familje, duhet gjithashtu të merret parasysh gjatë rishikimit legjislativ të legjislacionit penal të Kosovës.
- Gjyqtarët dhe prokurorët gjithashtu thanë se përballen me vështirësi në zbatimin e Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje pasi që procedura e paraparë me rregullore është e re dhe jo mjaft e detajuar. Ligji i ri për mbrojtje kundër dhunës në familje duhet të sigurojë se procedurat për kërkim dhe lëshim të urdhrin për mbrojtje janë të detajuara. Për këtë qëllim mund të hartohet një udhëzim administrativ (UA) për të zbatuar plotësisht ligjin e ri për mbrojtje kundër dhunës në familje. Ligjvënësit duhet të miratojnë ligjin dhe UA-në njëkohësisht për t'i mos lënë viktimat pa mjete efektive ligjore gjer në miratimin e UA-së.
 - Ligji i ri për mbrojtje kundër dhunës në familje duhet të përmbajë masa të shumta të cilat mund të lëshohen me urdhrat për mbrojtje në pajtim me Rregulloren e tanishme për mbrojtje kundër dhunës në familje dhe që u mundësojë gjyqtarët, në bazë të analizës së çdo rasti, të lëshojë më shumë masa. Ata nuk duhet të kufizohen në masat e kërkuara për lëshim të urdhrave për mbrojtje.
 - Rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje parasheh se UM mund të lëshohet pasi që kryesi i dyshuar të jetë ftuar në gjykatë në pajtim me ligjin e aplikueshëm, edhe nëse ai/ajo nuk paraqiten në seancën dëgjimore. Në praktikë vonesat paraqiten pasi që gjyqtarët hezitojnë që të lëshojnë UM-të kur kryesi i dyshuar nuk paraqitet, edhe kur ekzistojnë dëshmitë e aktit të dhunës në familje. Ligji i ri kundër dhunës në familje duhet të qartësojë që seanca dëgjimore dhe lëshimi i UM-së mund të bëhen në rrethanat kur kryesi i dyshuar është ftuar në gjykatë në mënyrë të rregullt dhe nuk merr pjesë në seancën dëgjimore.
 - Ligji i ri për mbrojtje kundër dhunës në familje gjithashtu i referohet ekzekutimit të vendimeve në pajtim me Ligjin e Kosovës për Procedurën Përmbarimore dhe kërkon që përcjellja dhe ekzekutimi i UM-së të vëzhgohet nga Policia e Kosovës dhe gjykatat. Duhet të përkufizohen qartë informatat e obligueshme që policia duhet t'i sigurojë prokurorëve kur shkelet UM-ja si krim i ndjekur *ex officio*. Ligji i ri për mbrojtje kundër dhunës në familje duhet të sigurojë përkufizimin e mirë të procedurave me të cilat policia duhet të monitorojë dhe përcjellë UM-të aktive.
 - Legjislacioni aktual për ndihmë juridike në Kosovë nuk parasheh në mënyrë të veçantë viktimat e dhunës në familje si kategori të pranueshme për këshillim juridik dhe përfaqësim falas. Ndihma juridike tani për tani është në dispozicion vetëm për grupet e rrezikuara që plotësojnë kushtet e veçanta sociale (për shembull janë të pranueshme për asistencë sociale). Rreziqet me të cilat viktimat përballen si pasojë e akteve të dhunës në familje duhet t'i bëjnë ata automatikisht të pranueshëm për të marrë ndihmë juridike falas.
 - Draft ligji për mbrojtje kundër dhunës në familje parasheh se Ministria e punës dhe mirëqenies sociale dhe Ministria e shëndetësisë do të hartojnë një UA për të përkufizuar se si trajtimi i detyrueshëm psiko-social do t'i ofrohet kryesve të dhunës në familje si masë shtesë. Ligji për mbrojtje kundër dhunës në familje parasheh se si kjo do të funksionojë në praktikë, përfshirë financimin e këshillimit profesional

psikologjik për kryesit e dhunës në familje përmes shërbimeve të nënkontraktuara në pajtim me ligjin për shërbimet familjare dhe sociale. Përndryshe hartimi i dispozitave pa resurse dhe financim të mjaftueshëm do të shkaktojë vonesa në zbatim të duhur të ligjeve.

- Shumë institucione kanë përshkruar buxhetet aktuale si të pamjaftueshme për adresimin e nevojave të viktimave, në veçanti nevojat e tyre emergjente për ushqim dhe trajtim mjekësor. Të gjitha institucionet duhet të sigurojnë ndarje të mjaftueshme buxhetore për institucionet për të përmbushur si duhet përgjegjësitë në lidhje me mbrojtjen kundër dhunës në familje.
- Zgjidhjet afatgjata për viktimat janë të kufizuara me varësinë ekonomike nga kryesit, papunësia e lartë, niveli i ulët i arsimit, asistenca e dobët sociale dhe mungesa e pronës. Megjithatë zbatimi i plotë i dispozitave të ofruara nga ligji i aplikueshëm mund të ofrojë mbështetje substanciale afatshkurtër për viktimat pas raportimit të dhunës, si dhe të fuqizojë viktimat për të marrë parasysh aranzhimet alternative të jetesës. Ligji i ri për mbrojtje kundër dhunës në familje duhet të parasheh themelimin e fondit për asistencë, riparim dhe kompensim të viktimave për të mbështetur viktimat me strategji fuqizuese përmes së cilave qeveria mund të mbrojë të drejtat e viktimave dhe mund të ofrojë mjete efektive ligjore dhe institucionale. Kjo mund të mbështetet me përgjegjësitë e qarta për institucionet individuale si pjesë e programit mbështetës për reintegrim të koordinuar nga shumë agjenci.
- Grupi punues që harton Ligjin e ri për mbrojtje nga dhuna në familje duhet të shqyrtojë me kujdes mirëqenien e fëmijëve në familjet ku është ushtruar dhuna në familje. Interesi më i mirë i fëmijës duhet të prioritetizohet në pajtim me konventën për të drejtat e fëmijës. Në të njëjtën kohë, duhet të gjinden zgjidhje në mënyrë që të mos paragjykohet e drajta afatgjate për kujdestarinë mbi fëmijën.
- Me qëllim të ngritjes së kapacitetit të gjykatësve dhe prokurorëve, Ligji i ri për mbrojtje kundër dhunës në familje duhet gjithashtu të inkorporojë trajnimin e detyrueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët për legjislacionin që ka të bëjë me dhunën në familje nën udhëheqje të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

PUNIMET E CITUARA

- Kuvendi i Kosovës. Kushtetuta. Në dispozicion në: <http://www.kushtetutaekosoves.info>.
_____. Ligji i Kosovës për ndryshim dhe plotësim të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, Ligji nr. 03/L-02. nëntor 2008.
_____. Ligji i Kosovës për ndryshim dhe plotësim të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, Ligji nr. 03/L-03. nëntor 2008.
_____. Ligji për procedurën kontestimore. nëntor 2008
_____. Ligji për procedurën përmbartimore nr. 03/L-008. qershor 2008.
_____. Ligji për juridiksionin, përzgjedhjen e rasteve dhe ndarjen e rasteve të gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Ligji nr. 03/L-053.
_____. Ligji për policinë nr. 03/L-035.

Cook, Rebecca, “Përgjegjësia shtetërore nën Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas në Ligjin për të drejtat e njeriut”. 1994.

Këshilli i Evropës. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. 1950.

Komisioni Evropian. Raport progresi për Kosovën. 2007.
_____. Raport i progresit për Kosovën. 2008.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti A. kundër Mbretërisë së Bashkuar. 23 shtator 1998.
_____. Rasti Z. kundër Mbretërisë së Bashkuar. 10 maj 2001.

Heise, Lori. “Abuzimi i bazuar në gjini: epidemia globale.” *Cad. Saude Publica*. Vol. 10 suppl. 1. Rio de Janeiro, 1994.

Policia e Kosovës. Raporti vjetor i sektorit kundër dhunës në familje dhe raporti gjashtëmujor. 2005, 2006, 2007, 2008 dhe qershor 2009.

Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RrGGK). Nga Nicole Farnsworth dhe Ariana Qosaj-Mustafa. Siguria fillon në shtëpi: Hulumto për të informuar strategjinë e parë kombëtare dhe planin e veprimit kundër dhunës në familje në Kosovë. Prishtinë, Kosovë: RrGGK, 2008.
_____. Nga Nicole Farnsworth. Hulumtim kërkimor për nivelin e dhunës së bazuar në gjini në Kosovë dhe ndikimi i tij në shëndetin riprodhues të gruas. Prishtinë, Kosovë: RrGGK, 2008.

Institucioni i Ombudspersonit. “Raport nga Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë për zbatimin e nenit 7 dhe 9 të rregullores së UNMIK-ut 2003/12 për mbrojtje kundër dhunës në familje, *ex officio*” numri i regjistrimit 1/06 (nëntor 2006).
_____. “Raporti vjetor i u.d. Ombudspersonit për Kuvendin e Kosovës, (2006-2007).”

Misioni i OSBE-së në Kosovë. “Raport për rastet e dhunës në familje në Kosovë.” korrik 2007.
_____. “Rishikimi i parë në Kosovë i sistemit të drejtësisë civile” qershor 2006.

- _____. Departamenti të drejtave të njeriut, decentralizimit dhe komunitetet: Seksioni për monitorim të sistemit ligjor. Raporti mujor maj 2007 dhe mars 2008.
- _____. "Raport vlerësues për themelimin e mekanizmave referues për viktimat e trafikut me genie njerëzore." 2007.
- _____. dhe Ministria e punës dhe mirëqenies sociale. "Përgjigjja ndaj incidenteve të dhunës në familje: Doracak për zyrtarët e shërbimeve sociale". 2006.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe USAID. "Doracaku gjyqësor shqiptar për urdhrat për mbrojtje." Tiranë, Shqipëri: 2008.

Pillay, Navanethem për Kombet e Bashkuara. "Dhuna kundër grave: dhuna e sponsorizuar nga shteti në sjelljen e në shtëpi të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut – Ligjëratë gjyqësore për aplikimin vendor të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas dhe KDF." 2000.

Rubotham, G.N., et. al. "Sistemi gjyqësor në Kosovë: vlerësim dhe opsione të propozuara 2003-2004". 2004

Sadiku, Halide për KIJAC. Pjesëmarrja e ulët e grave në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Mars 2009. Në dispozicion në: <http://www.kijacnews.net/vnews/display.v/ART/2009/03/19/49c11b3027ee0>

Terdevci, F., dhe Fuller, T. Për Rrjetin ballkanik të raportimit hetues (BIRN). "BIRN zbulon dobësitë kryesore të gjykatave të Kosovës". 4 qershor 2009.

Kombet e Bashkuara. Konventa për eliminimin e diskriminimit kundër grave (CEDAW). Rekomandimi i përgjithshëm 19 i miratuar për zbatimin e Konventës së OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave. 1992.

_____. Komisioni për eliminimin e diskriminimit kundër grave. A.T. kundër Hungarisë, komunikatë nr. 2/2003. 26 janar 2005.

_____. Deklaratë për parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit.

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Korniza Kushtetuese e Kosovës. Në dispozicion në: <http://www.unmikonline.org/constframework.htm>.

_____. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë.

_____. Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26 mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës

_____. Rregullorja e UNMIK-ut 2003/01 për ndryshimin e ligjit të aplikueshëm mbi krimet e ndërlidhura me dhunën seksuale

_____. Rregullorja e UNMIK-ut 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje

_____. Rregullorja e UNMIK-ut 2004/32 mbi Ligjin për familjen në Kosovë

Misioni i UNDP-së në Kosovë. "Ftesë për aplikime". 2009.

_____. "Qasja në drejtësi." 2008.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

316.485.26-055.2(048)

Më tepër se vetëm “Fjalë në Letër” ? : përgjigjia e organeve të drejtësisë ndaj dhunës në familje në Kosovë / Përgatiti Ariana Qosaj-Mustafa and Nicole Farnsworth. - Prishtina : UNDP, 2009. - 86 f. : ilustr ; 28 cm.

1. Mustafa Qosaj, Ariana 2 . Farnsworth, Nicole

ISBN 978-9951-498-07-4

MË SHUMË SE VETËM “FJALË NË LETËR”? PËRGGJIGJA E ORGANEVE TË DREJTËSISË NDAJ DHUNËS NË FAMILJE NË KOSOVË

“Kemi ligje shumë të mira në letër, por ato nuk janë duke u zbatuar” i tha Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës një grua e cila kishte pësuar nga dhuna në familje dhe kishte kërkuar drejtësi. Mendimet e tilla janë bërë gjë e zakonshme në mesin e aktivistëve të drejtave të grave si dhe përfaqësuesve të institucioneve, duke ilustruar vështirësitë e ndërlidhura me zbatimin e legjislacionit ekzistues. Megjithatë, hulumtimet e pakta analizojnë përse ekzistojnë problemet e tilla, veçanërisht në lidhje me dhunën në familje. Identifikimi i sfidave specifike ndaj zbatimit të legjislacionit mund të shërbejë për ofrimin e këshillave gjatë procesit të krijimit të politikave.

Duke u bazuar në intervista me më shumë se 60 përfaqësues të institucioneve, 96 viktima të dhunës në familje dhe hulumtimet e mëhershme, ky raport identifikon çështjet që kanë të bëjnë me legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e tij. Të gjeturat dhe rekomandimet të cilat rezultojnë nga to kanë për qëllim t’i kontribuojnë hartimit të Ligjit të ri për mbrojtje kundër dhunës në familje, Strategjisë kombëtare dhe Planit të veprimit kundër dhunës në familje edhe legjislacionit tjetër i cili qeverisë ndjekjen penale të krimeve të kryera në marrëdhëniet familjare, procedurat operative dhe punën e institucioneve përgjegjëse për sigurimin e qasjes në drejtësi.

Raporti vlerëson performancën e gjyqtarëve në ofrimin e mbrojtjes kundër dhunës në familje përmes mekanizmave siç janë urdhrat për mbrojtje; ndjekja penale e akteve të dhunës në familje; hetimin e akteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës, si dhe veprimeve për të mbrojtur viktimat nga dhuna e mëtejshme; puna e institucioneve dhe organizatave të ndryshme përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të viktimave gjatë qasjes së tyre në drejtësi; dhe perceptimet e qytetarëve për sistemin gjyqësor, që mund të ndikojnë në vendimet e tyre për të kërkuar drejtësi apo për të heshtur. Raporti përfundon me rekomandime për hartuesit e politikave dhe institucionet individuale drejt rritjes së qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në familje.



Kosovë

United Nations
Qyteza Pejton 14,
10000 Pristinë, Kosovë
Tel: ++381 38 249 066
Fax: ++381 38 249 065

www.ks.undp.org

ISBN 978-9951-498-07-4